





2024 RAPORTI VJETOR

Autoriteti i Mediave Audiovizive

AAA



AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE



MESAZHI I KRYETARIT TË AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE



ARMELA KRASNIQI
Kryetare e AMA-s

**E nderuar znj. Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë,
Të nderuar anëtarë të Komisionit Parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Shqipërisë,**

Viti 2024 ka qenë një vit angazhimesh në procese të ndryshme pune, me qëllim efektivitetin e mëtejshëm të rolit mbikëqyrës dhe rrregulator të AMA-s në tregun audio dhe audioviziv shqiptar. Përveç përmirësimit të kapaciteteve në drejtim të mirëfunksionimit të brendshëm institucional, përparësia e angazhimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, ka qenë afrimi edhe më shumë me standardet e një rrregulatori, vend anëtar i BE-së, në favor të garantimit të një tregu audio/audioviziv me tipare edhe më plurale, duke ofruar për ndjekësit produkte të shumëlojshme dhe cilësore.

Në kuadër të zbatimit të detyrimeve periodike të përafrimit të legislacionit të brendshëm me Acquis e BE-së në fushën e medias audiovizive dhe detyrimeve që rrjedhin nga PKIE 2024-2026, Autoriteti ka hartuar dhe miratuar dy akte të rëndësishme nënligjore që përmirësojnë akoma më shumë punën në drejtim të transparencës së strukturës pronësore të medias audio/audiovizive dhe rrregullimin e Platformave të Shpërndarjes së Videove (PSV). Në këtë kuadër, në Prill të këtij viti raportues, AMA miratoi rrugolloren, "Për kriteret dhe procedurat e shqyrtimit të ndryshimeve në strukturën e pronësisë dhe transparencën e të dhënave të lidhura me pronësinë e OSHMA-ve", e cila trajton në mënyrë të posaçme Transparencën në Strukturën Pronësore dhe Deklarimin e të Dhënave të tjera të lidhura me licencën/autorizimin prej OSHMA-ve, duke bërë përafrim fillestar të Rregullores me dispozitat e Aktit European për Lirinë e Medias (EMFA) si dhe transpozimin e Direktivës 2018/1808 të BE-së. Aktualisht, përtej rrugollimit ligjor, AMA ka përgatitur dhe paraqitur grafikisht në faqen web, (<https://ama.gov.al/baza-e-te-dhenave-struktura-pronesore-e-oshma/>), deklaratën dhe transparencën e strukturës së pronësisë së shoqërive/individëve të pajisur me licencë/autorizim nga AMA dhe deklaratën e pronarit përfitues të këtyre subjekteve që ushtrojnë aktivitetet audio dhe audioviziv në Republikën e Shqipërisë, duke përbushur kështu një prej detyrimeve kryesore të procesit të Integrimit.

Gjithashtu është miratuar rrugollorja, "Për kërkeshat e posaçme që ofruesit e Platformave të Shpërndarjes së Videove duhet të përbushin për krijimin e ofrimin e sistemeve transparente, efektive e miqësore në përdorim", e cila vjen si një akt i rëndësishëm nënligjor që trajton në mënyrë të posaçme rrugollimin ligjor të Platformave të Shpërndarjes së Videove (PSV). Rrugollorja synon gjithashtu të rregullojë kushtet e përgjithshme të ofrimit të përbajtjeve audiovizive nga përdoruesit në PSV dhe nuk prek shërbimet mbështetëse të transmetimeve audiovizive, me qëllim kryesor ofrimin e programeve për informim, argëtim ose edukim.

Në zbatim të detyrimeve të dala, pas amendimeve të fundit të Ligjit 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të cilat kishin për qëllim përbushjen e detyrimit për transpozimin e Direktivës 2018/1808 të Parlamentit dhe Këshillit Europian, që ngarkojnë Autoritetin me rregullimin e Platformave të Shpërndarjes së Videove, prej muajit Qershor 2024, midis AMA-s dhe platformës TikTok, filloj komunikimi zyrtar, me synim mundësimin e një kanali të dedikuar raportimi për përbajtjet e dëmshme dhe komunikimet tregtare, me qëllim piratimin e produktit audioviziv shqiptar. Bisedimet u finalizuan në muajin Gusht me lidhjen e një bashkëpunimi, bazuar në funksionet rregullatore të AMA-s dhe vullnetin e platformës TikTok, në mbrojtje të përdoruesve shqiptarë të kësaj platforme. U arrit hapja e një kanali të dedikuar raportimi, ku Autoriteti ndërmjetësonte reflektimin e ankesave të përdoruesve shqiptarë, për përbajtje të dëmshme, me arsyetimet respektive ligjore mbi shkeljet që përbajtjet kryen. Në funksion të kësaj, AMA hapi paraprakisht një dritare të posaçme në faqen e saj web, e cila mundësonse dërgimin e ankesave nga publiku, referuar përbajtjeve të dëmshme të publikuara në TikTok. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, për periudhën Gusht-Dhjetor 2024, bazuar në raportimet e përdoruesve janë shqyrtaar në total nga ekipet e AMA-s, 743 video për përbajtje të dëmshme dhe 1,513 për Pirateri dhe në bashkëpunim me Platformën u arrit të hiqeshin 286 video me përbajtje të dëmshme, 1,505 video dhe 193 profile të raportuara për Pirateri.

Jemi angazhuar me sukses gjatë vitit 2024 edhe për realizimin e një tjetër detyre të dalë nga Udhërrëfyesi për Shtetin e së Drejtës, që është adresimi i çështjes së përqendrimit të tregut mediatik, rritjes së transparencës dhe shtrirjes së audiencës. Angazhimi i AMA-s, si autoritet rregulator në këtë drejtim, është asistëncë dhe mbështetja e OSHMA-ve në tregun audioviziv shqiptar, në sigurimin e një procesi transparent. Pikërisht për të mundësuar Matjen e Shikueshmërisë, në nivel institucional, AMA ka ndërmarrë iniciativën e nxitjes së këtij procesi, duke organizuar 3 tryesa pune me të gjithë aktorët në fushën e medias dhe duke dhënë kontributin e vet, sa i përket sigurimit të modeleve mbi metodologjinë e përdorur nga vendet e Rajonit dhe BE-së, për të orientuar drejt dhe lehtësuar sa më shumë procesin. Këto iniciativa të AMA-s rezultuan me krijimin e Komitetit të Përbashkët të Industrisë (KPI), i përbërë nga 9 anëtarë, i cili ka vazhduar me fazat e tjera, atë të regjistrimi në gjykatë, si një hap tjetër drejt fillimin praktikisht të procesit të Matjes së Shikueshmërisë, një instrument i rëndësishëm, ndër të tjera edhe për identifikimin e ndikimit të mediave në publikun e gjërë.

Vlen të evidentohen partneritetet dhe nënshkrimi i Memorandumeve të Bashkëpunimit, me rregulatorët e Turqisë, Polonisë dhe Portugalisë, të cilët kanë lidhur ura të reja bashkëpunimi mes vendeve, në shtylla të rëndësishme të rregullimit të tregut audioviziv. Gjatë vitit 2024, AMA ka zhvilluar një sërë takimesh dhe pjesëmarresh në konferanca jashtë vendit, me institucionë të BE-së dhe autoritete homologe në Rajon dhe Europë. Veçohet pjesëmarra në muajin Qershor, në mbledhjen e 59-të të Platformës Europiane e Autoriteteve Rregulatorë (EPRA), që është rrjeti më i vjetër dhe më i madh i rregulatorëve audioviziv në Europë, në të cilin Kryetarja e AMA-s, u zgjodh me shumicë votash Zv/Kryetare e këtij Rrjeti. Kjo është hera e parë që Shqipëria zgjidhet dhe përfaqësohet në nivele të tilla të larta, në një platformë mbarëeuropiane.

Gjatë vitit 2024 është punuar me rigorozitet për Edukimin Mediatik të Publikut. Këshilli i Ankesave zhvilloi një fushatë për Edukimin Mediatik me fokus moshën parashkollore, me prindër dhe edukatorë në 21 kopshte të Tiranës, në 11 njësi administrative. AMA organizoi takime me prindër dhe edukatore, ku u diskutua konkretisht mbi Prindërimin Dijital, mbrojtjen e fëmijëve nga rreziqet kibernetike dhe orientimin e tyre për të marrë më të mirën nga teknologjia. Në këto tryesa morën pjesë 425 vetë, prej të cilëve: 12% edukatorë, 14% gjyshër, 16% baballarë. Procesin e Edukimit Mediatik të Publikut, AMA e ka vazhduar me prioritet gjatë gjithë vitit 2024 me publikimin në faqen online dhe rrjetet sociale, të videove dhe materialeve të tjera sensibilizuese mbi përdorimin e duhur të internetit, mbrojtjen nga lajmet e rreme



Në këtë vit raportues, ka vijuar në mënyrë sistematike monitorimi dhe vlerësimi i përbajtjeve të transmetuara, ku në fokus kanë qenë shkeljet etike në përgjithësi; mbrojtja e fëmijëve, gjuha e urrejtjes dhe diskriminimit, reklamat dhe komunikimet tregtare; respektimi i sinjalistikës paralajmëruese në fasha kohore të caktuara; buketa programore të RTSH-së, në zbatim të kërkesave të Kontratës së Shërbimit etj.

Janë kryer inspekte të subjekteve kabllore/IPTV/OTT, në lidhje me respektimin e të drejtave të transmetimit dhe janë identifikuar një sërë rastesh të shitjeve të produkteve audiovizive online, në mënyre abuzive. Rezultat i kësaj lufte të shpallur kundër Piraterisë, kanë qenë bllokimi i shumë subjekteve të paautorizuara nga AMA për ofrimin e shërbimit audioviziv, kryesisht subjekte ISP (Internet Service Provider), të cilët nëpërmjet internetit kryejnë pirateri televizive. Pas këtyre konstatimeve, AMA në bashkëpunim me AKEP, mori masa për mbylljen e më shumë se 20 serverave që transmeton kontent audioviziv pa të drejta si dhe bëri të mundur sanksionimin e 3 subjekteve ISP që operonin në kundërshtim me ligjin 97/2013, të ndryshuar. Për vitin 2024 AMA, ka përcjellë pranë AKEP-it 37 praktika zyrtare, me qëllim marrjen e masave, për mbylljen e 346 faqeve online, të cilat kryenin shkelje të ligjit.

Një ndihmë e jashtëzakonshme për punën e Autoritetit mbeten dhe ankesat nga individë apo subjekte të ndryshme, të cilat janë trajtuar një për një dhe me shumë kujdes nga Këshilli i Ankesave, bazuar në kërkesat e legjisacionit në fuqi. Për vitin që raportohet, gjithsej, KA ka shqyrtau 349 ankesa. Nga shkeljet e konstatuara, Këshilli i Ankesave i ka tërhequr vëmendjen OSHMA-ve në 36 raste dhe ka vendosur 2 sanksione me gjobë.

Në total, gjatë gjatë punës për mbikqyrjen dhe rregullimin e tregut audio/audioviziv, gjatë vitit 2024, pas shkeljeve të konstatuara nga OSHMA-të, AMA ka vendosur 48 masa administrative me Gjobë dhe 107 “Tërheqje Vëmendje”.

Në raportin që paraqitet mbi veprimtarinë 1-vjeçare të AMA-s jepen në mënyrë të detajuar të gjitha aspektet e angazhimit institucional, sipas njësive përbërëse, por dhe sipas realiteteve dhe sfidave që përballet tregu audio/audioviziv në vendin tonë. Kjo pasqyrë konkrete e dinamikës së punës në AMA shikohet në çdo rast në raport me kërkesat dhe nevojat konkrete të publikut, si dhe në përputhshmëri me standartet që respekton një vend që aspiron anëtarësimin, me të drejta të plota, në BE.

Ju faleminderit për vëmendjen!



PËRMBAJTJA

MESAZHI I KRYETARIT TË AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE	4
HYRJE	10
1. STRATEGJIA E AUTORITETIT	13
2. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË DHËNA NË REZOLUTËN E KUVENDIT PËR RAPORTIN VJETOR TË AUTORITETIT, PËR VITIN 2024	26
3. REKOMANDIMET E LËSHUARA NË PROGRES - RAPORTIN E BE-së DHE DETYRIME TË TJERA NDËRKOMBËTARE NDAJ AUTORITETIT	40
4. TË DHËNA LIDHUR ME AKTIVITETIN E AUTORITETIT PËR KRYERJE INSPEKTIMESH OSE HETIMESH ADMINISTRATIVE, VENDIME TË SANKSIONEVE ME GJOBË NË RAPORT ME VITET E FUNDIT	44
5. QEVERISJA E AUTORITETIT	48
5.1 Vendimmarra mbi licencat/autorizimet	48
5.2 Ecuria e proceseve gjyqësore	50
6. AUTORITETI SI RREGULLATOR PËR NJË TREG AUDIOVIZIV TË PËRGJEGJSHËM	52
6.1 Shqyrtimi tematik i përbajtjeve	52
6.2 Monitorimet e përbajtjeve	60
7. KËSHILLI I ANKESAVE	63
8. AUTORITETI NË PËRMBUSHJE TË ZBATUESHMÉRISË LIGJORE	74
8.1 Referencat ligjore mbi të cilat mbështetet veprimtaria e institucionit	74
8.2 Plotësimi i akteve nënligjore të domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit të OSHMA-ve	74
8.3 Nevoja për ndryshime të kuadrit ligor që rregullon veprimtarinë e institucionit	76
8.4 Mbikëqyrja e shfrytëzimit të spektrit të frekuencave	77
9. TRANSMETIMET NUMERIKE	84
9.1 Lirimi i brezit të Dividendit Digital Dy (DD2)	84
9.2 Kontrata AMA - RTSH	85
9.3 Planifikimi dhe administrimi i spektrit të frekuencave	86
9.3.1 Planifikimi i frekuencave për shërbimet audiovizive	87
9.3.2 Planifikimi i frekuencave për shërbimet audio	87
9.3.3 Koordinimi i frekuencave të brezit audio dhe audioviziv	87
9.4 Adresimi i interferencave të shkaktuara nga operatorët audio/audiovizivë	88
9.5 Sektori TIK	89
10. AUTORITETI NË PËRMBUSHJE TË REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KONTROLII I LARTË I SHTETIT	91



11 AUTORITETI NË PËRMBUSHJE TË TRANSPARENÇËS DHE RRITJES SË IMAZHIT INSTITUCIONAL	93
11.1 Organizimi i brendshëm i institucionit	93
11.2 Programi i transparencës	94
11.3 Aktivitete të Autoritetit	96
11.4 AMA në bashkëpunim me partnerët	105
11.5 Marrëveshjet e bashkëpunimit	107
11.6 Propozime për Akte Nënligjore	108
11.7 Publikimi i Buletinit Periodik të AMA - s	110
11.8 Menaxhimi i performancës së burimeve njerëzore	111
12 TREGUESIT FINANCIARË DHE MENAXHIMI I BURIMEVE	113
12.1 Menaxhimi i burimeve financiare	113
12.2 Realizimi i burimeve të financimit në vitin 2024	113
12.3 Detyrimet financiare të OSHMA - ve	117
12.4 Përdorimi i burimeve financiare në vitin 2024	119
12.5 Pasqyrat financiare	121
Pasqyra e aktiveve dhe pasiveve për vitet 2023 - 2024	122
ANEKS 1 Çështjet gjyqësore ku është palë Autoriteti i Mediave Audiovizive	129



HYJRE

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në përbushje të detyrave dhe funksioneve që rrjedhin nga ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, si dhe nga Strategja dhe Plani i Veprimit 2024-2026, ka vijuar punën duke përbushur kështu detyrën e mbikqyrjes dhe rregullimit të mëtejshëm të tregut mediatik audio dhe audioviziv shqiptar.

Objektivat e vendosura nga AMA në Strategjinë 2024-2026, të miratuar me vendimin Nr.18, datë 26.02.2024, të detajuara me një plan të mirëorganizuar veprimi, synojnë:

- Nxitjen dhe mbështetjen e standardeve profesionale në rritje të transmetimeve audiovizive, nëpërmjet praktikave më të mira ndërkombëtare;
- Sigurimin dhe nxitjen e diversitetit dhe pluralizmit në transmetimet audiovizive;
- Qasjen proaktive për transmetime audiovizive të përgjegjshme, motivuar nga interesit publik;
- Përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe efektivitetit të rolit mbikëqyrës dhe rregulator të autoritetit.

Gjatë vitit 2024, puna dhe veprimtaria e AMA-s është përqendruar në disa procese të rëndësishme, ndër të cilat veçojmë si më parësore:

Përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit tonë me atë të Bashkimit European. Në kuadër të zbatimit të detyrimeve periodike të përafrimit të legjislacionit të brendshëm me Acquis e BE-së në fushën e medias audiovizive dhe detyrimeve të ndërmarra nga AMA në kuadër të Planit Kombëtar për Integrinë European (PKIE) 2024-2026, Autoriteti miratoi me vendim nr. 40, datë 26.04.2024, rregulloren "Për kriteret dhe procedurat e shqyrtimit të ndryshimeve në strukturën e pronësisë dhe transparencën e të dhënavë të lidhura me pronësinë e OSHMA-ve". Ky akt i rëndësishëm nënligjor trajton në mënyrë të posaçme, Transparencën në Strukturën Pronësore dhe Deklarimin e të Dhënavë të tjera të lidhura me licencën/autorizimin prej OSHMA-ve, duke bërë përafrim fillestar të Rregullores me dispozitat e Aktit European për Lirinë e Medias (EMFA) si dhe transpozimin e Direktivës 2018/1808 të BE-së. Rregullorja, e cila zbatohet në mënyrë rigorozë nga strukturat e AMA-s, ka risi sa i përket: Shqyrtimit nga AMA të ndryshimeve në strukturën pronësore, brenda të njëjtë person juridik OSHMA, mbajtës i licencës/autorizimit nga AMA, të cilat nuk passjellin cedimin ose kalimin e të drejtave që burojnë nga licenca/autorizimi; Shqyrtimin e ndryshimeve në strukturën pronësore mes personave juridikë privat OSHMA, në rastet e hyrjes në marrëdhënie juridike civile, të cilat passjellin cedimin ose kalimin e të drejtave që burojnë nga licenca/autorizimi; Deklarimin e informacionit mbi përbërjen e strukturës së pronësisë së personit juridik OSHMA, mbajtës i licencës/autorizimit nga AMA, duke përfshirë pronarin përfitues; Transparencë të shtuar mbi originën e burimeve të financimit për kryerjen e transaksioneve tregtare të kapitalit të shoqërisë mediatike prej ortakut/aksionerit; Deklarim të çdo lloj konflikti/interesi të mundshëm që ndikon në veprimtarinë e OSHMA-së prej pronarëve; Deklarim mbi të ardhura nga reklama, donacione, sponsorizimeve etj., të pronarit përfitues nga persona juridikë publik, kryer me qëllim promovimi mediatik etj.

Aktualisht, përtej rregullimit ligjor, AMA ka përgatitur dhe paraqitur grafikisht në faqen web, (<https://ama.gov.al/baza-e-te-dhenave-struktura-pronesore-e-oshma/>), deklaratën dhe transparencën e strukturës së pronësisë së shoqërive/individëve të pajisur me licence/autorizim nga AMA dhe deklaratën e pronarit përfitues të këtyre subjekteve që ushtronjë aktivitetet audio dhe audioviziv në Republikën e Shqipërisë, duke përbushur kështu një prej detyrimeve kryesore të procesit të Integrimit. Baza e të dhënavë e paraqitur në grafik, është një model i përzgjedhur mes rregulatorëve europian dhe konkretisht atij portugez.



Gjithashtu në kuadër të zbatimit të detyrimeve periodike të përafrimit të legjislacionit të brendshëm me Acquis e BE-së në fushën e medias audiovizive dhe detyrimeve që rrjedhin nga PKIE 2024-2026, AMA miratoi me vendimin nr. 128, datë 23.12.2024, rregulloren: "Për kërkosat e posaçme që ofruesit e Platformave të Shpërndarjes së Videove duhet të përbushin për krijimin e ofrimin e sistemeve transparente, efektive e miqësore në përdorim". Kjo Rregullore vjen si një akt i rëndësishëm nënligjor që trajton në mënyrë të posaçme rregullimin ligjor të Platformave të Shpërndarjes së Videove (PSV). Ajo synon gjithashtu të rregullojë kushtet e përgjithshme të ofrimit të përbajtjeve audiovizive nga përdoruesit në PSV dhe nuk prek shërbimet mbështetëse të transmetimeve audiovizive, me qëllim kryesor ofrimin e programeve për informim, argëtim ose edukim.

Transpozimi i Direktivës 2018/1808 të Parlamentit dhe Këshillit European, në ligjin 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, shtroi domosdoshmërinë e plotësimit edhe të Kodit të Transmetimit me dispozita specifike, që prekin veprimtarinë e Platformave të Shpërndarjes së Videove (PSV). Kjo u reflektua me miratimin e shtesave dhe ndryshimeve të Kodit të Transmetimit, me Vendimin nr. 128, datë 23.12.2024. Ky rregullim, jo vetëm që përbushi një detyrim ligjor, por hodhi edhe një hap tjetër drej qartësimit të kompetencave dhe përgjegjësive të Autoritetit kundrejt Platformave të Shpërndarjes së Videove, por dhe strukturimit të procedurave të trajtimit të ankesave dhe raportimeve lidhur me shkeljet e konstataura në to.

Pas amendimeve të fundit të Ligjit 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të cilat kishin për qëllim përbushjen e detyrimit për transpozimin e Direktivës 2018/1808 të Parlamentit dhe Këshillit European, kompetencave të Autoritetit të Mediave Audiovizive, iu shtuan edhe Platformat e Shpërndarjes së Videove. Përtej mungesës së juridiksimit të drejtpërdrejtë, për shkak të mosregjistrimit të asnjë Platforme të tillë në Republikën e Shqipërisë, duke pasur parasysh interesat e përdoruesve shqiptarë, prej muajit Qershor 2024, midis AMA-s dhe platformës TikTok, filloj komunikimi zyrtar, me synim mundësimin e një kanali të dedikuar raportimi për përbajtjet e dëmshme dhe komunikimet tregtare, me qëllim piratimin e produktit audioviziv shqiptar. Bisedimet u finalizuan në muajin Gusht me lidhjen e një bashkëpunimi, bazuar në funksionet rregullatore të AMA-s dhe vullnetin e platformës TikTok, në mbrojtje të përdoruesve shqiptarë të kësaj platforme. U arrit hapja një kanali të dedikuar raportimi, ku Autoriteti ndërmjetësonte reflektimin e ankesave të përdoruesve shqiptarë, për përbajtje të dëmshme, me arsyetimet respektive ligjore mbi shkeljet që përbajtjet kryen. Në funksion të kësaj AMA hapi paraprakisht një dritare të posaçme në faqen e saj web, e cila mundësonë dërgimin e ankesave nga publiku, referuar përbajtjeve të dëmshme të publikuara në TikTok. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, për periudhën Gusht-Dhjetor 2024, bazuar në raportimet e përdoruesve dhe bashkëpunimin e Platformës, u arrit të hiqeshin 286 video me përbajtje të papërshtatshme, prej te cilave: 20 për akte dhune, 3 video për gjuhë urrejtje për shkak të orientimit seksual, 2 për urrejtje fetare, 31 për pamje veprash penale, 110 për ekspozimin e fëmijëve ndaj pornografisë, narkotikëve, alkoolit, duhanit dhe dhunës, 107 video për nxitje dhune dhe urrejtje dhe 13 audio për gjuhë që tejkalon standardet morale dhe etike të shoqërisë. Siç edhe është theksuar vazhdimi, rezultoi fenomen shumë shqetësues, Pirateria e produkteve audiovizive shqiptare. Për periudhën Gusht-Dhjetor 2024 u bllokuan nga Platforma TikTok, 1,505 video dhe u mbyllën 193 profile, të raportuara për Pirateri. Për të njëjtën periudhë janë shqyrtaar në total nga ekipet e AMA-s, 743 video për përbajtje të dëmshme dhe 1,513 për Pirateri.

Sipas Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës, dokument i politikës shtetërore të Shqipërisë, i miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave në datë 13.12.2023, për AMA-n është lënë detyrë, ndër të tjera, edhe adresimi i çështjes së përqendrimit të tregut mediistik, rritjes së transparencës dhe shtrirjes së audiencës. Angazhimi i AMA-s si autoritet rregulator në këtë drejtim është asistenca dhe mbështetja e OSHMA-vë në tregun audioviziv shqiptar, në sigurimin e një procesi transparent.



Pikërisht për të mundësuar Matjen e Shikueshmërisë në nivel institucional, AMA ka ndërmarrë iniciativën e nxitjes së këtij procesi. Konkretisht, në periudhën Janar-Shkurt 2024, AMA ka organizuar 3 tryesa me ofrues të shërbimeve mediatike audiovizive (OSHMA) dhe agjenci komunikimi e marketingu, me qëllim diskutimin e modalitetave për realizimin e procesit të Matjes së Shikueshmërisë audiovizive në Republikën e Shqipërisë. Po ashtu, AMA ka dhënë kontributin e vet edhe për sa i përket metodologjisë apo planit për të ngritur dhe zbatuar sistemin që e realizon praktikisht këtë proces. Në tryezat e organizuara për Matjen e Shikueshmërisë, AMA u prezantoi pjesëmarrësve metodologjinë e praktikave më të mira të realizuara nga vendet e BE-së dhe të Rajonit. Pas diskutimeve të shumta nga përfaqësuesit pjesëmarrës, është rënë dakort për ngritjen e Komitetit të Përbashkët të Industrisë (KPI), me 9 anëtarë, sipas formulës:

- 3 (tre) përfaqësues të televizioneve private me licencë kombëtare;
- 3 (tre) përfaqësues të televizioneve rajonale;
- 1 (një) përfaqësues nga Televizioni Publik Shqiptar (RTSH) dhe;
- 2 (dy) përfaqësues nga agjencitë e marketingut.

Pas një procesi inkurajues për palët, nën udhëheqjen e AMA-s, KPI, si një subjekt plotësisht i organizuar me të gjithë aktorët e tij, ka vazhduar hapat e tjerë, atë të regjistrimi në gjykatë, i cili do të bëjë të mundur fillimin praktikisht të procesit të Matjes së Shikueshmërisë, si një instrument i rëndësishëm, ndër të tjera edhe për identifikimin e ndikimit të mediave në publikun e gjërë.

Në kuadër të Edukimit Mediatik dhe mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës, Këshilli i Ankesave zhvilloi një fushatë me fokus moshën parashkollore, me prindër dhe edukatorë të kopshteve të Tiranës. Kjo fushatë u realizua në bashkëpunim me Drejtoren e Përgjithshme të Kopshteve dhe Çerdheve të Bashkisë Tiranë. Pjesë e fushatës ishin 21 kopshte në 11 njësi administrative të Tiranës, me fëmijë të moshës 5-6 vjeç, për shkak të veçorive të zhvillimit të tyre moshor dhe nevojës së tyre për orientim në botën audiovizuale dhe digitale, në prag të një hapi të rëndësishëm të jetës së tyre, siç është shkollimi.

AMA organizoi takime me prindër dhe edukatore ku u diskutua konkretisht mbi Prindërimin Digital, mbrojtjen e fëmijëve nga rreziqet kibernetike dhe orientimin e tyre për të marrë më të mirën nga teknologjia. Në këto tryesa morën pjesë 425 vetë, prej të cilëve: 12% edukatorë, 14% gjyshër, 16% baballarë. Në kuadër të kësaj fushatë audiovizuale u realizuan 23 video, me fokus sensibilizimin e opinionit publik për përdorimin e përgjegjshëm të mediave audiovizuale dhe mediave online, në lidhje me sinjalistikën në mjedisin audioviziv, prindërimin digital, përdorimin e ekuilibruar të internetit, rreziqet digitale, mbrojtjen e të dhënave personale në mjediset digitale etj.

Procesin e Edukimit Mediatik të Publikut, AMA e ka vazhduar me prioritet gjatë gjithë vitit 2024 me publikimin në faqen online dhe rrjetet sociale, të videoove dhe materialeve të tjera sensibilizuese mbi përdorimin e duhur të internetit, mbrojtjen nga lajmet e rreme dhe Dezinformimi, përdorimin e duhur të Inteligjencës Artificiale, mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve nga gjuha e urrejtjes dhe rreziqet e lojrave online etj.

Në përputhje me detyrimin e vet ligjor, parashikuar në ligjin nr. 97/2013 dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij, Këshilli i Ankesave (KA) ka vijuar të shqyrtojë ankesat e mbërritura në institucion në adresë të OSHMA-ve. Gjithsej, gjatë periudhës raportuese, KA ka shqyrtaur 349 ankesa, të dërguara respektivisht: 72.5% nga individë; 14.6% nga institucionë; 6.3% nga studio ligjore; 5.9% nga shoqëria civile; 1.4% nga media; 1.3% nga subjekte tregtare.

Përqindja më e madhe e ankesave të paraqitura kanë pasur për objekt, interesin më të lartë të fëmijës (59.5%); cënimin e dinjitetit të viktimit (15.2%); cënimin e privatësisë (8.9 %); të drejtën e përgjigjes (8.6%); diskriminimin gjinor/seksizmin (5.7%); cënimin e dinjitetit (5.7%); pamje/akte dhune (1.7%); diskriminimin racor (1.2%); komunikime tregtare në median audiovizive (2.3%); shhangje të tjera etike (21.5%); shkelje jashtë objektit të veprimtarisë së AMA-s (13.5 %). Sa i takon administrimit të ankesave, KA u ka kërkuar OSHMA-ve paraqitje pretendimesh në 25.2% të rasteve, ka konkluduar me "Térheqje

vëmendjeje” në 11.9% të ankesave të administruara dhe me sanksion finansiar në 2 raste. Në 6.7% të rasteve të vendimmarres së KA mbizotëron liria e shprehjes dhe vendimarrja ka shkuar në favor të lirisë editoriale. E thënë në shifra, gjatë vitit në raportim, Këshilli i Ankesave i ka tërhequr vëmendjen OSHMA-ve në 36 raste dhe ka vendosur 2 sanksione me gjobë.

Një prej detyrave të rëndësishme të Autoritetit, në funksion të shërbimit ndaj publikut përmes ofertës programore është edhe shqyrtimi tematik i përmbajtjeve të emetuar. AMA gjatë vitit 2024 ka shqyrtuar kryesisht (ex officio) 241 raste për përputhjen ligjore të përmbajtjeve të transmetuara, duke u fokusuar në aspekte të tillë si: mbrojtja e fëmijëve nga përmbajtjet e papërshtatshme; gjuha e urrejtjes dhe diskriminimi; barazia gjinore; shkeljet etike në përgjithësi; reklamat dhe komunikimet tregtare; përdorimi i gjuhës shqipe standarde të shkruar dhe të folur; respektimi i sinjalistikës paralajmëruese në fasha kohore të caktuara; tërësia programore të platformës së RTSH-së, në zbatim të kërkesave të Kontratës së Shërbimit, etj. Në procesin e shqyrtimit të përmbajtjeve të transmetuara, në 77 raste, AMA ka adresuar 62 “Tërheqje vëmendjeje” për OSHMA-të dhe në 15 raste “sanksion me gjobë”. Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2024, për monitorimin e transmetimeve digitale në Studion e Monitorimit të AMA-s, kanë qenë në regjistrim 48 njësi regjistrimi. Përveç subjekteve audio dhe audiovizive, janë në regjistrim edhe platformat Digitalb Satelitor, Digitalb Tokësor, Tring Satelitor, Tring Tokësor dhe Vodafone. Gjatë gjithë vitit janë regjistruar gjithsej në transmetimet digitale 420,000 orë transmetime audiovizive dhe rrëth 34,500 orë transmetime audio. Monitorimi i reklamave në subjektet audiovizive kombëtare janë 24,564 orë programe të monitoruara. Sa i takon shqyrtimit të ankesave nga Drejtoria e Monitorimit dhe Analizës së Përmbajtjeve, gjatë vitit 2024, në Studion e Monitorimit kanë ardhur për ndjekje 9 kërkesa/ankesa nga subjekte të ndryshme.

Lidhur me respektimin e të drejtave të transmetimit, Autoriteti, gjatë vitit 2024 ka kryer një numër të konsiderueshëm inspektimeve subjekteve kabllore/IPTV/OTT në terren. Po ashtu, gjatë vitit 2024 ka pasur risi në mënyrën e kryerjes së kontrolleve, pasi specialistë të Drejtorisë së Inspektimit dhe Mbikqyrjes kanë kryer dhe monitorimin e rrjetave online, duke identifikuar një sërë rastesh të shitjeve në mënyre abuzive, të produkteve audiovizive. Pas identifikimit të këtyre shkelësve, AMA, me prova zyrtare i ka raportuar ato pranë institucioneve të tjera ligjzbatuese, si Policia e Shtetit. Pas një pune të shkëlqyer nga Policia, nisur edhe nga provat e vëna në dispozicion nga AMA, në muajin dhjetor 2024, u krye me sukses një operacion për kapjen e një disa autorëve që tregtonin dhe prodhonin produkte audiovizive në kundërshtim me ligjin.

Gjithashtu të gjitha ankesat/kërkesat e operatorëve për ndërhyrje dhe mosrespektimin e të drejtës së transmetimit nga subjektet kabllore/IPTV/OTT, Autoriteti i ka trajtuar, duke iu dhënë përgjigje të gjithë subjekteve ankesave, si dhe duke marrë masat përkatëse në rast shkeljesh. Vlen të theksohet se, pjesa dërrmuese e ankesave për shkeljen e të drejtave të transmetimit, gjatë vitit 2024, lidhet me fenomenin e piraterisë televizive që kryhet nga subjekte të paautorizuara nga AMA për ofrimin e shërbimit audioviziv, kryesisht subjekte ISP (Internet Service Provider), të cilët nëpërmjet internetit kryejnë pirateri televizive. Duke qenë një fenomen shqetësues, AMA, në shtator, nisi turin e bashkëbisedimit në të gjitha qarqet e vendit, me operatorët e ligjshëm. Fokusi i tryezave, të drejtuara nga Kryetarja e AMA-s, ishte identifikimi i problematikave dhe shqetësimeve që kishin operatorët kabllorë si dhe ndihma e ndërsjelltë për luftimin e këtij fenomeni. Shqetësimet e operatorëve janë trajtuar nga Drejtoria e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe falë inspektimeve në terren i grupeve të punës, është bërë i mundur identifikimit e një numri të konsiderueshëm operatorësh ISP, të cilët kryen aktivitet audioviziv në shkelje të ligjit. Pas këtyre konstatimeve, AMA në bashkëpunim me AKEP, mori masa për mbylljen e më shumë se 20 serverave që transmeton kontent audioviziv pa të drejta si dhe bëri të mundur sanksionimin e 3 subjekteve ISP që operonin në kundërshtim me ligjin 97/2013, të ndryshuar. Për vitin 2024 AMA, ka përcjellë pranë AKEP-it 37 praktika zyrtare, me qëllim marrjen e masave, për mbylljen e 346 faqeve online, të cilat kryen shkelje të ligjt.



Në lidhje me veprimtarinë inspektuese, Drejtoria e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes në AMA, gjatë vitit 2024, përmes grupeve të veta të inspektimit, ka ushtruar 393 kontolle të aktivitetit të OSHMA-ve. Nga këto, 220 janë inspektime të kryera në bazë të ankesave dhe 173 janë monitorime kryesish. Në përfundim të kontolleve dhe shqyrtimit të procedurave përkatëse administrative, janë marrë 11 vendime për sanksione me gjobë ndaj subjekteve OSHMA, që janë konstatuar në shkelje të ligjit dhe për 9 raste të tjera është vendosur masa “Tërheqje vëmendje”. Drejtoria e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, gjatë vitit 2024, në fokus të veçantë ka pasur dhe monitorimi për respektimin e të drejtës së transmetimit për filmat artistikë dhe eventet sportive, në platforma/programe të ndryshme me pagesë. Për vitin 2024 janë kryer 1,168 orë monitorime për të drejtat e transmetimit për filmat artistikë dhe eventet sportive.

Sa më sipër, gjatë punës për mbikqyrjen dhe rregullimin e tregut audio/audioviziv, përfshirë edhe masat e marra nga Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve, pas shkeljeve të konstatuara nga OSHMA-të, gjatë vitit 2024, AMA ka vendosur për 48 masa administrative me Gjobë dhe 107 “Tërheqje Vëmendje”.

Gjatë vitit 2024 AMA ka vijuar fushatën ndërgjegjësuese dhe informuese “Fol shqip” me qëllimin e përmirësimit të gjuhës së folur dhe të shkruar në transmetimet audio/audiovizive, fushatë që ndikon drejtpërdrejt në rritjen e standardeve profesionale të redaksive. Fushata nisi në fillim të vitit 2024, me një tryezë gjithëpërfshirëse gazetarë-gjuhëtarë, e titulluar, “Fol Shqip-Të mbrojmë dhe të duam gjuhën shqipe”, dhe kishte si qëllim ndërgjegjësimin e punonjësve të medias për mbrojtjen e gjuhës shqipe nga fjalë e huaja. Periodikisht AMA ka publikuar në website-n zyrtar dhe në llogaritë e saj në rrjetet sociale, fjalë të huaja të përdorura nga gazetarët apo dhe formulime të pasakta, të shoqëruara këto me gjegjëset në shqip dhe format e duhura gjuhësore. Gjetjet e kësaj nisme reflektohen edhe në emisionin “Fol Shqip show” që transmetohet në Kosovë dhe Maqedoni.

Gjatë viti 2024, AMA ka zhvilluar një sërë takimesh dhe pjesëmarrjesh në konferanca jashtë vendit, me institucione të BE-së dhe autoritete homologe në Rajon dhe Europë si dhe ka lidhur disa Marrëveshje Bashkëpunimi. Në muajin Qershori, në mbledhjen e 59-të të Platformës Europeiane e Autoriteteve Rregullatore (EPRA), që është rrjeti më i vjetër dhe më i madh i rregulatorëve audioviziv në Europë, Kryetarja e AMA-s, znj. Armela Krasniqi, u zgjodh me shumicë votash Zv. Kryetare e këtij rrjeti. Në garë me kandidaten e rregulatorit audioviziv të Britanise së Madhe, OFCOM, Krasniqi ka marrë votat e 28 vendeve pjesëmarrëse, kundrejt 21 votave të dhëna për kandidaten britanike, Siobhan Walsh. Kjo është hera e parë që Shqipëria zgjidhet dhe përfaqësohet në nivele të tilla të larta në një platformë mbarëeuropiane. Pjesëmarrje të tjera të rëndësishme përmenden në takimet e organizuara nga Grupi i Rregulatorëve Europeanë për Shërbimet Mediatike Audiovizive (ERGA), Forumi i Autoriteteve Rregullatore të Transmetimeve të Detit të Zi (BRAF), Observatori European Audioviziv, WorldDAB, Rrjeti Mesdhetar i Autoriteteve Rregullatore, MNRA, në Konferencën Globale, e quajtuar ndryshe “Forumi Global i Rrjeteve”, organizuar nga UNESCO etj. Gjithashtu janë nënshkruar Memorandumet e Bashkëpunimit me rregulatorin turk, RTUK, rregulatorin polak, KRRiT dhe atë portugez, ERC. Shtyllat kryesore të këtyre bashkëpunimeve mbështeten në Edukimi Mediatik; Matjen e Shikueshmërisë; hulumtimin e opinionit publik dhe metodologjinë e monitorimit të përbajtjes audiovizive.

Një aspekt i rëndësishëm i punës gjatë vitit 2024 ka qenë edhe rritja e kapaciteteve në drejtim të mirëfunkcionimit të brendshëm institucional. Një nga projektet kryesore ka qenë ndërtimi i një infrastrukturë të re IT, bazuar në nyje të mbikonverguara (HCI), e cila ofron një kapacitet të lartë dhe teknologji të avancuar për menaxhimin e burimeve dhe hapësirës së ruajtjes së të dhënave. Për këtë infrastrukturë është hartuar dhe zbatuar edhe plani i mirëmbajtjes vjetore. Janë ndërmarrë masa për të garantuar disponueshmëri të lartë dhe për të reduktuar kohën e ndërprerjeve, duke siguruar një monitorim 24/7 dhe trajnime të rregullta për stafin IT.

Gjatë vitit 2024 është riorganizuar Drejtoria e Monitorimit dhe Analizës, duke rritur kapacitetet njerëzore për monitorimin e transmetimeve audiovizive, duke shtuar shqyrtimet cilësore që lidhen me diskriminimin, gjuhën e urrejtjes, format e ndryshme të çrregullimeve në informacion, proceset zgjedhore etj.

Ka përfunduar procesi i digitalizimit të dokumentacionit arkivor të njësisë së arkivë-protokollit, duke mundësuar optimizimin e eficencës dhe reduktimin e konsiderueshëm të kohës së qarkullimit shkresor në institucion. Institucioni ka digjitalizuar gjithashtu të gjitha aktivitetet e tij, të cilat publikohen në mënyrë të vazhdueshme në faqen zyrtare, duke u administruar përmes një sistemi të centralizuar të Menaxhimit të Përbajtjes (CMS).

Drejtoria e Botimit dhe Ndërveprimit në AMA ka zhvilluar një sistem të automatizuar për mbledhjen dhe analizën e të dhënave mbi OSHMA-të duke i dhënë fund një procesi të lodhshëm manual dhe të ngadalshëm, në koordinim dhe ruajtjen e evidencave. Me implementimin e platformës së re, është siguruar automatizimi dhe centralizimi i të dhënave, rritja e efikasitetit në përpunimin dhe analizimit të informacionit, si dhe monitorimi në kohë reale i tregut audio dhe audioviziv.

AMA vijon publikimin e Buletinit Periodik për të siguruar transparencë mbi sektorin audioviziv në Shqipëri, duke analizuar tendencat ekonomike, strukturën e pronësisë, aspektet teknike dhe karakteristikat e personelit. Edicioni i 10-të për vitin 2023 përfshin të dhëna mbi performancën financiare të televizioneve, radiove dhe platformave kabllore. Një fokus i veçantë i është kushtuar procesit të digjitalizimit dhe aksesueshmërisë në internet për personat me aftësi të kufizuara. Bashkëpunimi me partnerë të ndryshëm, që punojnë në fushën e medias, i ka shërbyer Autoritetit për mbështetjen e realizimin e projekteve në dobi të përmirësimit të raportimit në median audiovizive, të pasurimit të literaturës profesionale, në interes të standardizimit të raporteve mes punëdhënësit dhe punëmarrësit apo sensibilizimit për disa tematika me rendësi në aktualitet.





1. STRATEGJIA E AUTORITETIT

Objektivat strategjikë dhe Plani i Veprimit të Autoritetit përkojnë me procese të vijueshme të punës së AMA - s, për shkak të zhvillimeve të reja, ndryshimeve a përmirësimeve të kuadrit ligor. Për këtë shkak Strategjia përfshin procese dhe veprimtari të cilat zgjaten në kohë, për një periudhë tre vjeçare, konkretisht për periudhën 2024 - 2026.

Objektivat e vendosura nga AMA në Strategjinë 2024 - 2026 të miratuar me vendimin Nr.18, datë 26.02.2024 të Bordit të AMA - s, të detauar me objektiva dhe me një plan veprimi, do të ndihmojnë në përbushjen e strategjisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive për këtë periudhë kohore. Qëllimet strategjike të AMA-s, që mbulojnë periudhën tre vjeçare të strategjisë, ku çdo qëllim përmban objektiva specifikë, janë si më poshtë vijon:

1. Nxitja dhe mbështetja e standardeve profesionale në rritje të transmetimeve audiovizive nëpërmjet praktikave më të mira ndërkombëtare:

a) Forcimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit dhe të konsultimit me partnerët ndërkombëtarë të angazhuar në lirinë e shprehjes dhe të medias në BE dhe në rajon, me qëllim unifikimin e praktikave rregulluese të autoritetit;

b) Nisja e angazhimit të rregulatorit për njohjen dhe përdorimin e praktikave të së drejtës evropiane mbi reklamat publike, miratimin e metodologjisë për një proces transparent matje shikueshmërie në tregun audioviziv dhe përcaktimin e parimeve për veprimtarinë e shpërndarjes së videove në platformat e mediave sociale që funksionojnë në Shqipëri;

c) Mbështetje nëpërmjet konceptit të bashkë-rregullimit, të nismave nga OSHMA - të apo aktorët e tjerë lidhur me transmetimet audiovizuale, në marrjen e praktikave më të mira ndërkombëtare për përbajtje audiovizive që u përgjigjen në nivelin më të lartë nevojave të shikueshmërisë.

2. Sigurimi dhe nxitja e diversitetit dhe e pluralizmit në transmetimet audiovizive:

a) Mbështetja e lirisë dhe e pluralizmit të shërbimeve mediatike audiovizive, motivuar nga interesi publik duke u kujdesur për krijimin e një mjedisi funksional mediatik që të përbushë me transmetimet audiovizive nevojat e qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, duke respektuar kombin, gjuhën, traditën, besimet fetare, kulturën dhe diversitetin, si dhe parimin e gjithëpërfshirjes së audiencave;

b) Nxitja e shumëlojshmërisë dhe e cilësisë më të lartë të transmetimeve audiovizive në reflektim të standardeve dhe praktikave më të mira profesionale, duke patur në vëmendje shërbimin ndaj publikut dhe vetëm publikut, ku në funksion të së drejtës për informim, publiku të krijojë i pa ndikuar nga çrrëgullimet në informacion, opinionin e vet të lirë;

c) Nxitja e prodhimeve audiovizive që përdorin dhe respektojnë gjuhën shqipe, si dhe nxitja e përdorimit të gjuhës së shenjave në transmetimet audiovizive për t'u shërbyer audiencave me aftësi të kufizuara.

3.Qasje proaktive për transmetime audiovizive të përgjegjshme, motivuar nga interesit publik:

- Mbështetja për promovimin e edukimit mediatik në transmetimet audiovizive dhe mbështetja në trajnime të vazhdueshme të stafeve që krijojnë përbajtje audiovizive në drejtim të mbrojtjes dhe reagimit ndaj çregullimeve në informacion;
- Mbështetja nëpërmjet partnerëve në realizimin e edukimit mediatik të audiencave dhe nxitjen e mendimit kritik të tyre, me qëllim depërtimin me trajnime të edukimit mediatik të tipologji audiencash si prindërit, fëmijët në shkolla, mësuesit në shkolla dhe edukatorët në kopshte;
- Mbështetja dhe përfshirja e audiencave dhe e palëve të tjera të interesuara për t'u angazhuar aktivisht në gjetjen e zgjidhjeve të çështjeve të ndjeshme që lidhen me transmetimet audiovizive.

4.Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë dhe i efektivitetit të rolit mbikëqyrës dhe rregulator të autoritetit:

- Rritja e kapaciteteve për monitorimin cilësor dhe sasior të transmetimeve audiovizive në funksion të rolit mbikëqyrës dhe rregulator të autoritetit duke shtuar shqyrtimet cilësore që lidhen me diskriminimin, gjuhën e urrejtjes, format e ndryshme të çregullimeve në informacion, proceset zgjedhore etj. Modernizim teknik dhe teknologjik të monitorimit përmes përdorimit të soft - eve të ndryshme të avancuara;
- Fuqizimi i kapaciteteve teknike për zbulimin e piraterisë audiovizive dhe mbrojtjen e të drejtave të transmetimit në koordinim me të gjithë faktorët institucionalë. Ndërtimi dhe rritja e kapaciteteve dhe e infrastrukturës teknike, për matjen e përputhshmërisë së cilësisë së shërbimit audioviziv;
- Ruajtja e një sistemi të drejtë dhe të hapur për licencim/autorizim dhe rregullimin e shërbimeve mediatike audiovizive, në respektim të drejtësisë, të paanshmërisë dhe të konkurrencës së lirë. Nxitja e lehtësimit të procedurave në një masë të konsiderueshme nëpërmjet aplikimeve virtuale për licencat/autorizimet.

5.Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve dhe përmirësimi i sistemeve të mirëfunksionimit të brendshëm të autoritetit:

- Informatizimi i aktiviteteve të institucionit brenda një sistemi të qendërzuar menaxherial dhe publikimi i përbajtjeve të web - it të autoritetit në formë të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuar;
- Mbështetja e procesit të digitalizimit të dokumentacionit të brendshëm të autoritetit, proces që i ndihmon transparencës dhe llogaridhëni. Digitalizimi i arkivës fizike të dokumentacionit të autoritetit;
- Trajnime të vazhdueshme të stafit të autoritetit dhe veçanërisht zhvillim të kapaciteteve në trajnime të nëpunësve të rekrutuar rishtas si pasojë e implementimit të strukturës së re organizative të autoritetit.

Në Planin e Veprimit të Dokumentit Strategjik parashikohen veprimtaritë me përparrësi, si dhe rezultatet e pritshme për përbushjen e qëllimeve strategjike, të ndara në afate, për periudhën 2024 - 2026, për të gjitha këto fusha veprimi:

- Kuadri ligjor Aktet Nënligjore dhe Politikat;
- Infrastruktura e informacionit dhe njohurive;
- Transmetimet numerike;
- Monitorimi i spektrit radiofrekuencor;
- Veprimtaritë e mbikëqyrjes dhe të përputhshmërisë;
- Frekuencat dhe zhvillimet teknologjike;
- Promovimi i transmetimit të përgjegjshëm dhe fuqizimi i audiencave;
- Financat;
- Komunikimi dhe publikimi;
- Zhvillimi i burimeve njerëzore dhe organizative.

Një nga objektivat kryesorë të AMA - s, me të cilin është punuar me kujdes gjatë këtij viti raportimi, mbetet ai i përbushjes sa më mirë të nevojave të qytetarëve të Republikës së Shqipërisë nga ofruesit e shërbimeve audiovizive, duke respektuar gjuhën dhe larminë e traditave, besimeve fetare, kulturën dhe moralin e qytetarëve, vlerat demokratike të përcaktuara në Kushtetutë dhe veçanërisht lirinë e shprehjes.

AMA e ka nisur tashmë procesin e kontributit në përafrimin e legjislacionit tonë me orientimet e Bashkimit European, duke përafruar legjislacionin tonë me Direktivën (BE) 2018/1808 të Parlamentit European dhe të Këshillit me ndryshimet ligjore në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar”. Viti 2024 shënoi hapa të rëndësishëm në miratimin e akteve nënligjore, të cilat në kuadër të procesit të integrimit dhe përafrimit legjilativ, gjatë këtij viti raportimi, u miratuan dy akte nënligjore, të cilat përligjin veprimtarinë insitucionale dhe u vendosën në zbatim të ndryshimeve ligjore.

Trasparenca e strukturës pronësore të subjekteve të licencuara dhe/ose autorizuara nga AMA, ka ndodhur për të plotësuar një nga kërkesat e BE - së, duke shtuar se përtet rregullimit ligjor, duke përgatitur regjistrin dhe paraqitur grafikisht në faqen e vet zyrtare online, deklaratën dhe transparencën e strukturës së pronësisë së shoqërive apo individëve të pajisur me licencë/autorizim nga AMA, si edhe deklaratën e pronarëve përfitues të këtyre subjekteve që ushtrojnë aktivitet audio dhe audioviziv në Shqipëri. Në këtë linjë, me vendimin nr. 40, të Prillit të këtij viti në raportim, Autoriteti i Mediave Audiovizive miratoi rregulloren: “Për kërkesat dhe procedurat e rishikimit të ndryshimeve në strukturën e pronësisë dhe transparencën e të dhënavë të pronësisë së OSHMA - ve”. Ky rregullim ligjor dhe faktik i transparencës së strukturës pronësore të OSHMA - ve është një zbatim i detyrave funksionale të autoritetit, i cili do të vijojë dhe gjatë periudhës që përkon me zbatueshmérinë e Strategjisë.

Po gjatë vitit 2024, si pjesë e rëndësishme e detyrimeve që vijnë nga Plani Veprimit të Autoritetit, në kuadër të procesit të përafrimit të legjislacionit me legjislacionin e BE - së në fushën e medias audiovizive (si për shembull transpozimin e Direktivës 2018/1808 të BE), por dhe rritjes të volumit të punës tèresore të marrë në shqyrtim, i lind nevoja e përmirësimit të kuadrit nënligjor në fuqi që rregullon veprimtarinë e saj. Me hyrjen në fuqi të ndryshimeve të fundit të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar më 25 maj 2023, ndryshime këto të cilat përafruan plotësisht me Direktivën 2010/13/EU “Audiovisual Media Services Directive” (AVMSD), të amenduar me Direktivën 2018/1808 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian përcaktimet ligjore në fushën e transmetimeve audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre, si dhe për shërbimet e platformave të shpërndarjes së videove, domosdoshmerinë e rregullimit ligjor lidhur me kompetencat e autoritetit për rregullimin procedural në rastet e përbajtjes së ofruesve të shërbimit të shpërndarjes së videove të vendosur nën juridiksionin e Republikës së Shqipërisë dhe rregullimin e procedurës së administrimit për përbajtjet që i drejtohen publikut shqiptar të ofruara nga platformat e shpërndarjes së videove të themeluara në një shtet tjeter. Në përfundim, në zbatim të detyrimeve të ndërmarra në PKIE 2024 - 2026, si dhe me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit rregulator të AMA - s, AMA miratoi rregulloren me vendimin Nr.128, datë 23.12.2024 “Për kërkesat e posaçme që ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove duhet të përbushin për krijimin e ofrimin e sistemeve transparente, efektive e miqësore në përdorim” .

AMA bashkëpunon ngushtë me AKEP - in në inspektimet e kryera lidhur me fenomenin e piraterisë së produktit audioviziv dhe operatorëve piratë që transmetojnë nëpërmjet internetit dhe faqeve të ndryshme që ofrojnë produkte audiovizive pa autorizimin e AMA - s.

Në vijim të rezultateve të këtij viti në raportim, përbën domosdoshmëri vazhdimi i punës me vizion, përkthyer në objektiva konkretë për një sërë aspektesh, mes të cilave: ndjekja e hapave proceduriale për hyrjen në fuqi të aktit nënligjor për ndryshimet në strukturën pronësore dhe rritjen e transparencës së pronësisë, përputhur me detyrimet e rrjedhura nga harmonizimi më i fundit i ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar, me Direktivën e Bashkimit Evropian për Ofruesit e Shërbimeve Mediatike Audiovizive 2018/1808; ndjekja me rigorozitet e zbatimit nga Ofruesit e Shërbimeve Mediatike Audiovizive të

detyrimeve të ligjit 97/2013 dhe Kodit të Transmetimit, veçanërisht lidhur me mbrojtjen e fëmijëve nga përbajtjet që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor apo moral të tyre; aksesi në informacion të personave me aftësi të kufizuar; shmangia dhe ndalimi i gjuhës së urrejtjes; edukimi mediatik etj.

Po kështu, vazhdimi i punës do të përqendrohet edhe tek: rritja e bashkëpunimit me aktorët e grupit ndërinstitucional për lirimin e brezit DD2 nga transmetimet audiovizive dhe dhënia në përdorim të këtij brezi për shërbimet e lëvizshme 5G, në shërbim të zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të vendit dhe vijueshmëria e transmetimeve audiovizive në nivel lokal, si një standard thelbësor për zhvillimin e demokracisë dhe përfaqësimin e komuniteteve të ndryshme në sferën publike. AMA gjithashtu, synon të rrisë rolin e saj rregulator, por sipas rastit, edhe nxitës, në disa procese, zbatimi i të cilave synon të çojë përparrë vendin në rrugën drejt anëtarësimit në BE. Nisma të tilla janë për shembull hartimi i një metodologjje për matjen e shikueshmërisë, si një ndër kriteret kryesore të realizimit të transparencës së plotë mediatike në treg, apo implementimi gradual i Aktit European për Lirinë e Medias.





2. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË DHËNA NË REZOLUTËN E KUVENDIT PËR RAPORTIN VJETOR TË AUTORITETIT, PËR VITIN 2024

I) Të japë kontributin e saj në ndryshimet e ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në përputhje me standaret dhe rekondimet e BE-së për adresimin e problematikave të rëndësishme që kanë të bëjnë me çështje, si: transparenca e financimit të mediave, përqendrimi i lartë i pronësisë së mediave, reklamat publike, rritja e pavarësisë së rregullatorit, etj.

Përafrimi i legjisacionit me *acquis* e Bashkimit Evropian, ka qenë dhe mbetet një prej prioriteteve që Autoriteti i Mediave Audiovizive ka në vazhdimësi, pavarësisht se proceset e ndryshimeve ligjore iniciohen dhe udhëhiqen nga Ministria e linjës. Duke iu referuar këtij rekondimi, informojmë si vijon:

1.1. Garantimi i transparencës në pronësinë e mediave

Autoriteti i Mediave Audiovizive ka ndërmarrë hapa rregullues në kuadër të transparencës së strukturës së pronësisë dhe rregullimit nënligjor nëpërmjet miratimit të rregullores “Për kërkesat dhe procedurat e rishikimit të ndryshimeve në strukturën e pronësisë dhe transparencën e të dhënave të pronësisë së OSHMA”, me vendimin nr. 40, datë 26.04.2024.

Aktualisht, përtëj rregullimit ligjor, Autoriteti i Mediave Audiovizive ka përgatitur dhe paraqitur grafikisht në faqen e tij në internet deklaratën dhe transparencën e strukturës së pronësisë së shoqërive/individëve të pajisur me licencë/autorizim nga AMA dhe deklaratën e pronarit përfitues të këtyre subjekteve që ushtrojnë aktivitetet audio dhe audioviziv në Republikën e Shqipërisë, duke përbushur në këtë mënyrë një prej detyrimeve kryesore të procesit të integrimit <https://ama.gov.al/baza-e-te-dhenave-struktura-pronesore-e-oshma/>.

Baza e të dhënave e paraqitur në grafik, tashmë i publikuar në faqen zyrtare (web) të AMA - s, është një model i përzgjedhur mes Rregulatorëve Europian dhe konkretisht atij Portugez, në kuadër dhe të bashkëpunimit të vendosur tashmë midis dy autoriteve tona për shkëmbimin e praktikave më të mira intitucionale dhe politikbërjes, lidhur me transparencën e pronësisë së subjekteve të licencuar dhe/ose autorizuar për shërbimet audiovizive.

1.2. Reklama institucionale

Sipas ligjit 97/2013, i ndryshuar, nuk ka asnjë dispozitë të shprehur në lidhje me procedurat e transmetimit të reklamave institucionale. Rregullimi i vetëm i referohet periudhës zgjedhore, gjatë së cilës

transmetimi i kësaj tipologje reklamash kryhet sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Prej vitit 2022 me vetëregullim institucional tashmë, AMA – përmes Drejtorisë së Monitorimit kryen dhe matjen e volumit të reklamës institucionale duke mundësuar përmes publikimit periodik dhe transparencën e reklamës institucionale të transmetuar në subjektet audioviziv. Në kuadër të përkufizimit ligor të sanksionuar tashmë në Ligjin organik të funksionimit të institucionit, në vijimësi do të propozohen për organin ligjvënës ndryshime ligjore dhe konkretisht ato që mirregullojnë dhe procesin që AMA po kryen në këto momente lidhur me matjen e volumit të reklamës institucionale.

Ky rregullim ligor do të jetë një qasje e njëjtë me mënyrën e rregullimit të transmetimit dhe matjes së volumit të reklamës institucionale në vendet e tjera të rajonit apo të Bashkimit Evropian. Mund të përmendim këtu Italinë, Francën, Çekinë.

1.3. Pavarësia e rregulatorit

Në të njëjtën linjë me qëndrimin institucional të mbajtur nga AMA, ritheksojmë se ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, garanton pavarësinë e plotë dhë të qartë të Autoritetit, duke filluar me dispozitat që përcaktojnë statusin e AMA - s, mënyrën e propozimit dhe zgjedhjes së anëtarëve dhe kryetarit të AMA - s, papajtueshmëritë dhe konfliktet e interesit të anëtarëve dhe kryetarit të AMA - s, për të vazhduar me mënyrën e pavarur të financimit, mënyra e organizimit, funksionimit dhe vendimmarrjes së AMA - s.

Nenet 7 - 10 të ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar, përcaktojnë procedurën dhe kriteret për emërimin e Bordit dhe Kryetarit të AMA - s.

Duke iu referuar legjislacioneve të vendeve të tjera evropiane rezulton se mënyra e konstituimit, funksionit dhe financimit të AMA - s është e ngjashme me shumicën e këtyre vendeve, duke përmendur këtu Italinë apo Francën, në të cilat rregulatori i medias zgjidhet tërësisht (Italia) apo pjesërisht (Franca) nga parlamenti dhe raporton përpara tij lidhur me veprimtarinë vjetore, si dhe gëzon pavarësi të plotë institucionale nga ekzekutivi, si në aspektin finanziar edhe në atë të vendimmarrjes.

Si më poshtë vijon, citojmë disa prej modeleve të rregullimit të pamvarësisë isntitucionale sipas praktikave të konsoliduara Europiane:

1. Pavarësia e rregulatorit në Itali parashikohet shprehimisht në nenin 1 të ligjit nr. 249/1997, i ndryshuar. Ndërkohë anëtarët e Autoritetit zgjidhen nga parlamenti dhe emërohen me dekret të Presidentit të Republikës, sipas një procedure të mirëpërcaktuar, ku Presidenti i Autoritetit emërohet me dekret të Presidentit të Republikës, me propozimin e Presidentit të Këshillit të Ministrave në marrëveshje me Ministrin e Zhvillimit Ekonomik.

Sipas nenit 2, pika 8 e ligjit nr. 481/1995, anëtarët e Autoritetit qëndrojnë në detyrë për shtatë vjet dhe nuk mund të rizgjidhen, përvèç rastit kur janë zgjedhur për një periudhë më pak se tre vjet, për të zëvendësuar komisionerët që nuk kanë përfunduar mandatin.

1. Në Francë, Autoriteti rregulator ARCOM krijohet dhe funksionon sipas Dekret - ligjit nr. 12/2003 "Për themelimin e Autoritetit Rregulator të Komunikacionit dhe Miratimin e Statuteve", si vijon:



Arcom përbëhet nga një kolegj prej nëntë anëtarësh:

- presidenti i Arcos - it, i emëruar nga Presidenti i Republikës;
- tre anëtarë të emëruar nga Kryetari i Asamblesë Kombëtare;
- tre anëtarë të emëruar nga Presidenti i Senatit;
- një anëtar i emëruar nga Zëvendëskryetari i Këshillit të Shtetit dhe një anëtar i emëruar nga Kryetari i Parë i Gjykatës së Kasacionit.

Emërimi i presidentit dhe i tetë këshilltarëve nga pesë autoritete të veçanta është një nga garancitë kryesore të pavarësisë së organit. Referuar Kapitullit III të dekret - ligjit të sipërcituar, secili nga anëtarët e organeve të ARCOM, zgjidhet për një periudhë 3 - vjeçare, e rinovueshme për të njëjtën periudhë.

Nga ana tjetër, vende të zhvilluara, në kuptim të rregullimit të shtetit të së drejtës, ndarjes dhe balancës së pushteteve dhe implemetimit të parimeve demokratike, rezulton të kenë autoritete rregullatore në fushën e medias të cilët nuk gjëojnë pavarësi institucionale të plotë por funksionojnë si organe administrative në varësi të Ministrisë së Kulturës (Norvegjia), Ministrisë së Administratës Publike (Sllovenia) apo financhohen pjesërisht nga buxheti i shtetit (Çekia).

1. Autoriteti Norvegjez i Medias është një organ qeveritar mbikqyrës dhe administrativ që zbaton legjislacionin dhe vendimet e Qeverisë dhe Ministrisë së Kulturës dhe Barazisë. Autoriteti i Medias (Medietilsynet) është në varësi të Ministrisë së Kulturës (Kulturdepartementet) dhe financohet nga Buxheti Kombëtar. Ndryshe nga shumë rregulatorë të medias në Evropë, nuk ka asnjë bord apo këshill për Autoritetin e Medias.

2. Agjencia për Rrjetet dhe Shërbimet e Komunikimit (AKOS) është autoriteti për mediat audiovizive në Slloveni, i cili operon në varësinë e Ministrisë së Administratës Publike. AKOS raporton tek kjo ministri, e cila mbikqyr sektorë të ndryshëm, përfshirë komunikimin, transmetimin dhe mediat. AKOS - i gjithashtu është nën mbikëqyrjen e Asamblesë Kombëtare (Parlamentit) të Sllovenisë. Parlamenti shqyrton aktivitetet, buxhetin dhe pajtueshmërinë e agjencisë me rregulloret e mediave.

Në këtë kuptim, rregullimi ligor i AMA - s është i plotë, i detajuar dhe shterues në kuptim të garantimit të pavarësisë së rregulatorit.

1.4. Hartimi i akteve nënligjore

Në mbështetje të angazhimeve për ndryshime rregulatorë ligjore dhe nënligjore, si dhe në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga transpozimi i Direktivës 2018/1808 në ligjin e ndryshuar nr. 97/2013, AMA ka përfunduar hartimin e Projekt - Rregullore për Platformat e Shpërndarjes së Videove, e cila synon të qartësojë mënyrën e funksionimit të këtyre platformave në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe procedurat përkatëse për trajtimin e ankesave drejtuar tyre dhe jo vetëm. Aktualisht, projekt i një fjalë është në fazën e konsultimit publik me të gjithë grupet e interesit.

2) Të luajë një rol proaktiv në organizimin e tryezave të diskutimit me operatorët audiovizive dhe aktorë të tjera të rëndësishëm për nxitjen e procesit të matjes së shikueshmërisë, si një instrument i rëndësishëm për vetë operatorët, por dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në mbarëvajtjen dhe transparencën e tregut audioviziv në Shqipëri

Sipas Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës (Rule of Law Roadmap), dokument i politikës shtetërore të Shqipërisë, i miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave në datë 13.12.2023, për AMA - n është lënë

detyrë ndër të tjera dhe adresimi i çështjes së përqendrimit të tregut mediatik, rritjes së transparencës dhe shtrirjes së shikueshmërisë. Angazhimi i AMA - si autoritet rregulator në këtë drejtim është asistencë dhe mbështetja e OSHMA - ve në tregun audioviziv Shqiptar, në sigurimin e një procesi transparent.

Pikërisht për të mundësuar matjen e shikueshmërisë në nivel institucional, AMA ka ndërmarrë iniciativën për të organizuar disa tryeza diskutimi me aktorët në fushën e medias, me qëllim ngritjen e një Komiteti të Përbashkët të Industrisë (KPI).

Konkrektisht, në periudhën Janar - Shkurt 2024 AMA ka organizuar 3 tryeza me ofrues të shërbimeve mediatike audiovizive (OSHMA) dhe agjenci komunikimi e marketingu, me qëllim diskutimin e modaliteteve përfunksionimin e procesit të matjes së shikueshmërisë audiovizive në Republikën e Shqipërisë. Po ashtu, AMA ka dhënë kontributin e vet edhe për sa i përket metodologjisë apo planit për të ngritur dhe zbatuar sistemin që e realizon praktikisht këtë proces.

Në kuadër të zbatimit të këtij procesi në një kohë sa më të shpejtë, në dhjetor 2023, AMA ka përgatitur edhe projekt - propozimet për ndryshimet përkatëse në ligjin nr. 97/2013, të ndryshuar, duke përfshirë konceptin e matjes së shikueshmërisë. Aktualisht, ndryshimet e propozuara janë në fazë konsultimi publik.

Në tryezën e parë, të datës 15 janar me temë “Matja e shikueshmërisë në tregun audioviziv shqiptar dhe modalitetet për realizimin e këtij procesi”, morën pjesë përfaqësues të nivelit të lartë drejtues të operatorëve që prodhojnë përbajtje apo programe audiovizive dhe të agjencive të reklamave që operojnë në treg. AMA prezantoi për pjesëmarrësit në këtë takim dy modele të matjes së shikueshmërisë, të realizuara në vendet fqinjë me Shqipërinë, nga pikëpamja gjeografike, por edhe me realitetë të ngjashem ekonomiko - socialë, respektivisht në Maqedoninë e Veriut dhe Kroaci. Në fund të takimit, u ra dakord si më poshtë:

- Takimi i parë të konsiderohej si takimi i Grupit të Punës, anëtarë të të cilët ishin operatorët audiovizivë dhe agjencitë e reklamave të pranishëm në takim, si paraprijës të Komitetit të Përbashkët të Industrisë dhe
- AMA në këtë proces të ketë rol koordinues dhe në takimin e radhës do të sjellë modele të marra nga vendet e tjera të rajonit në mënyrë që operatorët të mund të zgjedhin modelin më të mirë dhe më të përshtatshëm për ta, për të vazhduar më tej me modalitetet e realizimit të matjes së shikueshmërisë.

Në dy tryezat e tjera, përkatësisht të datave 31 janar 2024 dhe 6 Shkurt 2024, me temë “Matja e shikueshmërisë në tregun audioviziv shqiptar: detaje mbi funksionimin e Komitetit të Përbashkët të Industrisë”, AMA ka prezantuar 5 (pesë) shembuj të marrë nga vende të tjera të rajonit dhe Bashkimit Evropian mbi metodologjinë e zbatuar në këto vende, në mënyrë që të zgjidhej varianti më i mirë dhe më i përshtatshëm për tregun audioviziv shqiptar. Kështu, u përdorën si modele reference metodologjitetë e përdorura në:

- Bullgari;
- Austri;
- Spanjë;
- Maqedoni e Veriut;
- Turqi.

Pas diskutimeve për metodologjinë që do të zbatohet, pjesëmarrësit ranë dakord për:

- Ngritjen e Komitetit të Përbashkët të Industrisë me 9 anëtarë, si dhe;
- Formulën e krijimit të këtij Komiteti.

Formula e pranuar është me 9 anëtarë si vijon:

- 3 (tre) përfaqësues të televizioneve private me licencë kombëtare;
- 3 (tre) përfaqësues të televizioneve rajonale;
- 1 (një) përfaqësues nga Televizioni Publik Shqiptar (RTSH) dhe;
- 2 (dy) përfaqësues nga agjencitë e marketingut.

Formula e pranuar gjerësisht do të zbatohet pas kohës së kërkuar nga përfaqësuesit e televizioneve rajonale për të studiuar shembujt e marrë nga vendet e rajonit dhe pasi të vendosin mes tyre për mënyrën e përzgjedhjes së përfaqësuesve respektivë.

Përfundimisht, në datën 10.07.2024, pas 6 muajsh diskutimi të vazhdueshëm me aktorët e medias në gjetjen e një formule të përbashkët që të përfshinte peshën kryesore të medias por edhe të agjencive reklamuese, është dakordësuar konstituimi zyrtarisht i Komitetit të Përbashkët të Industrisë (KPI).

Pas një procesi inkurajues për palët, nën udhëheqjen e Autoritetit të Mediave Audiovizive, KPI, si një subjekt plotësish i organizuar me të gjithë aktorët e tij, mbetet të ndërmarrë hapin tjetër, që është regjistrimi në gjykatë, i cili do të bëjë të mundur fillimin praktikisht të procesit të matjes së shikueshmërisë si një instrument i rëndësishëm, ndër të tjera edhe për identifikimin e ndikimit të mediave në publikun e gjërë.

3) Të marrë masat e nevojshme për zbatimin e Kodit të Ri të Transmetimit nga ana e OSHMA - ve, veçanërisht lidhur me luftën ndaj diskriminimit dhe promovimit të barazisë gjinore, parandalimin dhe luftën ndaj gjuhës së urrejtjes në transmetimet audiovizive, të cilat janë përfshirë për herë të parë në Kodin e Transmetimit

Kodi i Transmetimit është akti nënligjor më i rëndësishëm i ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ai përmban dhe përcakton parimet, rregullat, kërkosat dhe praktikat e transmetimeve audio dhe audiovizive në Republikën e Shqipërisë. Struktura dhe përbajtja e Kodit të Transmetimit mbështeten në parimet themelore të veprimitarës së transmetimeve audio dhe audiovizive, në standartet më të arrira profesionale bashkëkohore, në normat e kërkosat morale dhe etike, si edhe në praktikën e deritanishme të veprimitarës audio dhe audiovizive në Republikën e Shqipërisë.

Detyrimet e shtuara në sektionet e Kodit e Ri të Transmetimit, si: “Luftimi i diskriminimit dhe promovimi i barazisë gjinore”, “E Drejta për privatësi dhe mbrojtjen e të dhënave personale”, “Fëmijët në transmetimet audiovizive”, kanë pasur si rrjedhojë ristrukturimin e tematikës së ankesave të publikut.

Gjatë periudhës janar - dhjetor 2024, interesi më i lartë i fëmijës ishte shqetësimi kryesor me 59.5% të rasteve, duke shënuar një rritje të ndjeshme krahasuar me 16.4% të ankesave për të drejtat e fëmijëve dhe privatësinë e tyre në 2023 dhe 32% në 2022. Kjo tregon një shqetësim më të madh të publikut lidhur me mbrojtjen e fëmijëve nga përbajtjet mediatike të papërshtatshme.

Një tjetër kategori me rritje të ndjeshme ishte ajo e shhangjive të tjera etike, e cila në 2024 përbënte 21.5% të ankesave, krahasuar me 13.3% në 2023 dhe 13% në 2022. Kjo kategori përbledh ankesa që nuk lidhen drejtëpërdrejt me një përbajtje të caktuar mediatike, por me problematika më të gjera në tregun audioviziv, si përdorimi i fjalorit joetik, pasaktësitë apo devijimet në ligjërim, apo moskuptimi i specifikave të gjinive mediatike. Shtimi i kësaj kategorie ankesash shtron nevojën e intensifikimit të masave të edukimit mediatik.

Nga ana tjetër, komunikimet tregtare në median audiovizive shënuan një rënie të lehtë, nga 3.6% në 2023 në 2.3% në 2024, duke reflektuar ndoshta një kontroll më të rreptë mbi përmbajtjen reklamuese. Në të njëjtën kohë, ankesat për shkelje jashtë objektit të AMA-s u rritën në 13.5% në 2024, krahasuar me 7.2% në 2023, por ishin megjithatë më të ulëta se në 2022 (15%).

Në vijim të ndryshimeve në Kodin e Transmetimit, raportimi i vitit 2024 i strukturon ankesat në mënyrë më të detajuar, duke identifikuar për herë të parë problematika specifike si cenimi i dinjitetit të viktimit (15.2%), cenimi i privatësisë (8.9%), e drejta e përgjigjes (8.6%), diskriminimi gjinor/seksizmi (5.7%), cenimi i dinjitetit (5.7%), pamje/akte dhune (1.7%) dhe diskriminimi racor (1.2%). Kjo paraqitje më e hollësishme ofron një pamje më të nuancuar të problematikave mediatike.

Në përgjithësi, trendi i vitit 2024 flet për një rritje të shqetësimit për interesin e fëmijës dhe etikën në media si edhe shtim të ankesave për çështje të përgjithshme etike dhe atyre jashtë objektit të AMA-s, krahasuar me vitin 2023.

Në kuadër të trajtimit të ankesave, referuar nenit 51 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes”, si dhe udhëzimit “Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofriuesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv”, Këshilli i Ankesave ka patur komunikime të vazhdueshme me Bordet e Shqyrtimit të Ankesave pranë OSHMA - ve të cilat janë reflektuar në përbushjen e detyrimeve ligjore nga ana e tyre, duke hequr përmbajtjet e dëmshme audiovizive nga kanalet e tyre zyrtare.

Gjithashtu, gjatë periudhës raportuese AMA ka shqyrtuar kryesisht (ex officio) 241 raste për përputhjen ligjore të përmbajtjeve të transmetuara, ku ka identifikuar mosrespektim të kërkesave të ligjit 97/2013 apo Kodit të Transmetimit në 77 raste. Nga këto 77 raste në total, janë konstatuar se në 16 raste (21%) ka pasur përdorim të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit. Katër prej këtyre rasteve kanë pasur diskriminim gjinor.

Në vitin 2024 AMA në shqyrtimet e tematizuara të përmbajtjeve audio/audiovizive të transmetuara ka pasur në fokus dhe aspektin e përdorimit të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit. Për të krijuar një ide mbi peshën specifike që zënë këto fenomene negative mjafton të përmendim këto shifra: Nëse gjatë gjithë vitit 2024 AMA identifikoi 77 raste të transmetimit të përmbajtjeve të papërshtatshme në shkelje të ligjit 97/2013 apo Kodit të Transmetimit, në 16 raste (ose 21%), u ndeshën përdorim i gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit. Katër prej këtyre rasteve ishin si diskriminim gjinor.

Në procesin e analizës së përputhshmërisë ligjore për këto 16 përmbajtje, në 4 raste që ishin më të rënda u aplikua “sanksion me gjobë” ndaj subjekteve audiovizive të licencuara (një me gjobë 50 mijë lekë, dy me 100 mijë lekë dhe në një rast me gjobë 200 mijë lekë).

Krahas specifikimeve konkrete në referencën ligjore që nuk ishte respektuar, OSHMA - ve ju kërkua dhe heqja e përmbajtjeve të papërshtatshme nga kanali YouTube, apo llogaritë e redaksive në rrjetet sociale, kërkesa që u plotësuan në të gjitha rastet prej tyre.

Nga analiza e përputhshmërisë ligjore për rastet e përdorimit të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit për 10 OSHMA u aplikua dërgimi i shkresës me “tërheqje vëmendjeje”, duke shpjeguar dhe referencat konkrete ligjore që nuk ishin respektuar. Ndryshimet e fundit që janë bërë në Kodin e Transmetimit mbi luftën kundër gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit, kanë efekt pozitiv në komunikimin mes AMA - s dhe OSHMA - ve, ku vërehet më shumë ndjeshmëri mes redaksive për të treguar profesionalizëm në parandalimin dhe shhangjen e tyre nga programacioni, si në rastin e subjekteve me licencë kombëtare, ashtu dhe ato me licencë lokale/rajonale. Më poshtë jepen në formë të tabelizuar rastet konkrete që u identifikuan gjatë vitit 2024, në shkelje të ligjit dhe Kodit të Transmetimit, shoqëruar dhe me referencën ligjore përkatëse:



TIPOLOGJIA E SHKELJES	OSHMA	SANKSIONI
Shkelje etike, përdorim fjalori fyes dhe denigrues (Nuk janë respektuar kërkesat e Kodit të Transmetimit, pikë 1.6)	OSHMA Kombëtare	Térheqje vëmendje
Shkelje etike, përdorim fjalori fyes dhe denigrues, veprime të papërshtatshme (Nuk janë respektuar kërkesat e ligjit 97/2013, neni 4 dhe neni 32)	OSHMA Rajonale	Térheqje vëmendje
Shkelje etike, fjalor dhe sjellje të papërshtatshme (Nuk janë respektuar kërkesat e nenit 4 dhe 33/1 të ligjit 97/2013)	OSHMA Kombëtare	(Gjobë 100 mijë lekë)
Shkelje etike, përdorim fjalori fyes dhe denigrues (Nuk janë respektuar kërkesat e Kodit të Transmetimit, pikë 1.6 dhe 7.10)	OSHMA Kombëtare	Térheqje vëmendje
Përbajtje të papërshtatshme (Nuk janë respektuar kërkesat e ligjit 97/2013, neni 4, pikë 1; si dhe Kodin e Transmetimit, pikë 1.6)	OSHMA Kombëtare	Térheqje vëmendje
Përbajtje të papërshtatshme (Nuk janë respektuar kërkesat e ligjit 97/2013, neni 4 dhe 32; si dhe Kodin e Transmetimit, pikë 1.5 dhe 1.12)	OSHMA Rajonale	(Gjobë 100 mijë lekë)
Shkelje etike, përdorim fjalori fyes dhe denigrues (Nuk janë respektuar kërkesat e ligjit 97/2013, neni 32, pikë 4 dhe neni 33, pikë 1/d; si dhe të Kodit të Transmetimit, pikë 7.9)	OSHMA Kombëtare	Térheqje vëmendje
Përbajtje të papërshtatshme (Nuk janë respektuar neni 33 i ligjit, pikë 1/c; pikat 1.6, 5.1, 5.2, 7.1 dhe 7.2 të Kodit të Transmetimit)	OSHMA Rajonale	(Gjobë 200 mijë lekë)
Përbajtje të papërshtatshme me gjuhë diskriminimi (Nuk janë respektuar kërkesat e nenit 32, pikë 4/a, si dhe të Kodit të transmetimit pikat 7.4 dhe 7.9)	OSHMA Kombëtare	Térheqje vëmendje
Përbajtje të papërshtatshme me gjuhë urejtje dhe denigrimi (Nuk janë respektuar kërkesat e nenit 4/pika 2/d dhe neni 32, pikë 4/a)	OSHMA Rajonale	Térheqje vëmendje
Përbajtje të papërshtatshme (Nuk janë respektuar kërkesat e nenit 4/pika 2/dh; neni 33, si dhe pikës 1.5 të Kodit të Transmetimit)	OSHMA Rajonale	(Gjobë 50 mijë lekë)
Përbajtje të papërshtatshme (Nuk janë respektuar kërkesat e nenit 4/pikal/b; neni 32/1 dhe neni 33/ pikë 1/dh, si dhe pikat 4.10, 4.24 dhe 4.25 të Kodit të Transmetimit)	OSHMA Rajonale	Térheqje vëmendje
Përdorimi i fjalorit jo etik me gjuhë agresive dhe përbuzëse, duke mosrespektuar nenen 4, pikë 2/d të ligjit 97/2013, si dhe Kodin e Transmetimit, pikat 1.5 dhe 1.6	OSHMA Kombëtare	Térheqje vëmendje
Përdorim fjalori të papërshtatshëm, në shkelje të ligjit 97/2013, neni 33, pikë d, si dhe të Kodit të Transmetimit, pikë 1.3	OSHMA Rajonale	Térheqje vëmendje
Përdorim fjalori të papërshtatshëm, në shkelje të ligjit 97/2013, neni 4, pikat 1/b dhe 2/d	OSHMA Rajonale	Térheqje vëmendje
Përdorim fjalori të papërshtatshëm, në shkelje të ligjit 97/2013, neni 4, pikat 1/b dhe 2/d	OSHMA Kombëtare	Térheqje vëmendje



4) Të monitorojë zbatimin nga ana e OSHMA - ve të Kodit të Ri të Transmetimit, veçanërisht pikat të cilat lidhen me mbrojtjen e fëmijëve, që janë zgjeruar në Seksionin “Fëmijë në mediat audiovizive” dhe nëndarjet përkatëse

Në përbushje të detyrimit të vet ligjor dhe jo vetëm, mbrotja e fëmijëve në transmetimet audiovizive ka qenë dhe mbetet prioritet i AMA - s dhe Këshillit të Ankesave.

Interesi më i lartë i fëmijës është parësor në çdo vendimarrje të Këshillit të Ankesave dhe udhëheq veprimtarinë e tij të përditshme edhe përmes sensibilizimit dhe fushatave të edukimit mediatik me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të individëve për format e shumta të mesazheve mediatike dhe nxitjen e mendimit kritik kundrejt shumëlojshmërisë së informacionit.

59.5 përqind e ankesave të trajtuar nga Këshilli i Ankesave gjatë vitit 2024 kishin objekt cënimin e të drejtave të fëmijëve në trasmetimet audiovizive. Në kuadrin e shqyrtimit të ankesave, në rastet e evidentimit të shkeljeve, Këshillit të Ankesave ka dhënë masa paralajmëruese dhe i ka propozuar Bordit të AMA-s sanksione financiare.

Nr.	OSHMA	PERIUDHA	FORMATI	SHKELJA	SANKSIONI
1.	Rajonale	Janar 2024	Edicion informativ	Identifikim i tërthortë i fëmijës viktimë	Tërheqje vëmendjeje
2.	Kombëtare	Janar 2024	Edicion informativ dhe Talk Show	Identifikim i tërthortë i fëmijës viktimë	Tërheqje vëmendjeje
3.	Rajonale	Janar 2024	Edicion informativ	Identifikim i tërthortë i fëmijës viktimë	Tërheqje vëmendjeje
4.	Rajonale	Janar 2024	Edicion informativ	Identifikim i tërthortë i fëmijës viktimë	Tërheqje vëmendjeje
5.	Rajonale	Janar 2024	Edicion informativ	Identifikim i tërthortë i fëmijës viktimë	Tërheqje vëmendjeje
6.	Rajonale	Janar 2024	Edicion informativ	Identifikim i tërthortë i fëmijës viktimë	Tërheqje vëmendjeje
7.	Rajonale	Janar 2024	Edicion informativ	Identifikim i tërthortë i fëmijës viktimë	Tërheqje vëmendjeje
8.	Rajonale	Janar 2024	Edicion informativ	Identifikim i tërthortë i fëmijës viktimë	Tërheqje vëmendjeje
9.	Kombëtare	Janar 2024	Edicion informativ	Identifikim i tërthortë i fëmijës viktimë	Tërheqje vëmendjeje
10.	Kombëtare	Shkurt 2024	Edicion informativ	Identifikim i tërthortë i fëmijës dëshmitar në dhunë	Tërheqje vëmendjeje
11.	Rajonale	Shkurt 2024	Edicion informativ	Identifikim i tërthortë i fëmijës dëshmitar në dhunë	Tërheqje vëmendjeje



12.	Rajonale	Shkurt 2024	Edicion informativ dhe Talk Show	Identifikim i tērthortë i fēmijës dëshmitar nē dhunë	Tērheqje vēmendjeje
13.	Kombëtare	Shkurt 2024	Edicion informativ	Identifikim i tērthortë i fēmijës dëshmitar nē dhunë	Tērheqje vēmendjeje
14.	Rajonale	Shkurt 2024	Edicion informativ	Identifikim i tērthortë i fēmijës dëshmitar nē dhunë	Tērheqje vēmendjeje
15.	Kombëtare	Shkurt 2024	Edicion informativ	Identifikim i tērthortë i fēmijës dëshmitar nē dhunë	Tērheqje vēmendjeje
16.	Shērbim programor/ OSHMA Kombëtare	Shkurt 2024	Edicion informativ	Identifikim i tērthortë i fēmijës dëshmitar nē dhunë	Tērheqje vēmendjeje
17.	Rajonale	Shkurt 2024	Edicion informativ	Identifikim i tērthortë i fēmijës dëshmitar nē dhunë	Tērheqje vēmendjeje
18.	Rajonale	Shkurt 2024	Edicion informativ	Identifikim i tērthortë i fēmijës dëshmitar nē dhunë	Tērheqje vēmendjeje
19.	Rajonale	Shkurt 2024	Edicion informativ	Identifikim i tērthortë i fēmijës dëshmitar nē dhunë	Tērheqje vēmendjeje
20.	Rajonale	Shkurt 2024	Edicion informativ	Identifikim i tērthortë i fēmijës dëshmitar nē dhunë	Tērheqje vēmendjeje
21.	Rajonale	Shkurt 2024	Edicion informativ	Identifikim i tērthortë i fēmijës viktimë	Tērheqje vēmendjeje
22.	Kombëtare	Shkurt 2024	Edicion informativ	Identifikim i tērthortë i fēmijës viktimë	Tērheqje vēmendjeje
23.	Kombëtare	Shkurt 2024	Edicion informativ	Identifikim i tērthortë i fēmijës viktimë	Tērheqje vēmendjeje
24.	Rajonale	Shkurt 2024	Edicion informativ	Identifikim i tērthortë i fēmijës viktimë	Tērheqje vēmendjeje
25.	Kombëtare	Shkurt 2024	Edicion informativ	Identifikim i tērthortë i fēmijës viktimë	Tērheqje vēmendjeje

26.	Shërbim programor/ OSHMA Kombëtare	Shkurt 2024	Edicion informativ	Identifikim i tërthortë i fëmijës viktimë	Tërheqje vëmendjeje
27.	Rajonale	Shkurt 2024	Edicion informativ	Identifikim i tërthortë i fëmijës viktimë	Tërheqje vëmendjeje
28.	Kombëtare	Shkurt 2024	Edicion informativ	Identifikim i tërthortë i fëmijës viktimë	Tërheqje vëmendjeje
29.	Rajonale	Shkurt 2024	Edicion informativ	Identifikim i tërthortë i fëmijës viktimë	Tërheqje vëmendjeje
30.	Kombëtare	Dhjetor 2024	Program argëtues, informativ dhe edukativ	Trajtim i pabalancuar i ngjarjeve dhe faktave historike, përfshirë çështjet, që janë tema të debatit publik	Tërheqje vëmendjeje
31.	Kombëtare	Dhjetor 2024	Emision politik	Diskriminim i kategorive vulnerabël	Tërheqje vëmendjeje

Pas ngjarjes së rëndë të datës 18.11.2024, si pasojë e së cilës humbi jetën një adoleshent dhe u plagosën disa të tjera, Autoriteti ka dalë gjithashtu me tri reagime publike lidhur me mbulimin e dinamikës së ngjarjes, nëpërmjet të cilave ka tërhequr vëmendjen e mediave për përgjegjësi dhe profesionalizëm maksimal në emër të interesit më të lartë të fëmijës, respektit ndaj dhimbjes së familjarëve, ndjeshmërisë së mbarë opinionit publik shqiptar dhe detyrimit shoqëror gjithëpërfshirës.

Gjithnjë në kuadrin e interesit më të lartë të fëmijës, Këshilli i Ankesave, si pjesë e Autoritetit të Mediave Audiovizive, duke vlerësuar rëndësinë e kompetencave mediatike përputhur me specifikat moshore, zhvilloi një fushatë për Edukimin Mediatik me fokus moshën parashkollore, me prindër dhe edukatorë të kopshteve të Tiranës.

Kjo fushatë u realizua në bashkëpunim dhe bashkërendim me Drejtoren e Përgjithshme të Kopshteve dhe Çerdheve të Bashkisë Tiranë. Pjesë e fushatës ishin 21 kopshte në 11 njësi administrative të Tiranës, me fokus fëmijët parashkollarë të moshës 5 - 6 vjeç, për shkak të veçorive të zhvillimit të tyre moshor dhe nevojës së tyre për orientim në botën audiovizuale dhe digitale, në prag të një hapi të rëndësishëm të jetës së tyre siç është shkollimi.

Në këto tryeza morën pjesë 425 vetë, prej të cilëve: 12% - edukatorë, 14% - gjyshër, 16% - baballarë. Pjesëmarrësit shfaqën interesim dhe morën pjesë aktive në diskutime, duke ngritur disa shqetësimë, të lidhura me prindërimin digital, si: zakonet e këqia, si pasojë e mungesës së kohës nga ana e prindërve, ndikimin negativ të mjedisit, që sugjeron përdorimin e gjithgjendur të telefonit, mosfunkcionimin e disa mekanizmave të kontrollit online në territorin shqiptar, mospërdorimin e rregullt të sinjalistikës nga TV, etj.

Në kuadër të kësaj fushatë audiovizuale u realizuan 23 video me fokus sensibilizimin e opinionit publik



për përdorimin e përgjegjshëm të mediave audiovizuale dhe mediave online në lidhje me sinjalistikën në mjedisin audioviziv, prindërimin digjital, përdorimin e ekuilibruar të internetit, rreziqet digitale, mbrojtjen e të dhënavë personale në mjediset digitale, lojërat digitale, disinformimi, reklamat dhe blerjet online, siguria kibernetike, etj.

Mbrojtja e fëmijëve ka qenë dhe mbetet prioritet për AMA - n në procesin e monitorimit dhe analizës së përbajtjeve të transmetuara. Në thelb procesi i monitorimit dhe analizës bazohet në parimin se interes i më i lartë i fëmijës është parësor në çdo veprim të OSHMA - ve që përfshin fëmijën apo i drejtohet fëmijës dhe se subjektit e licencuara duhet të trajtojnë me respekt, dinjitet dhe profesionalizëm të gjithë fëmijët që marrin pjesë në programet audio dhe audiovizive.

Nga 77 rastet e identifikuara si shkelje të ligjit 97/2013 dhe Kodit të Transmetimit, gjatë vitit 2024, në 34 prej tyre (ose 44%), lidheshin me mbrojtjen e fëmijëve. Për tre raste të rënda u dha "sanksion me gjobë" për OSHMA - të (dy me 50 mijë lekë dhe një me 100 mijë lekë).

Nga analiza e tyre vërehet se tipologjia e tyre ishte:

- transmetimi i pamjeve të dhunës ekstreme apo me efekte të forta emocionale në oraret kur mendohet se para ekranit janë fëmijët;
- transmetimi i filmave apo dokumentarëve për të rritur në orare të papërshtatshme;
- mungesa e shenjave paralajmëruese për programe që duhen shikuar nga fëmijët nën shoqërinë me prindërit apo kujdestarët e tyre më të rritur;
- publikimi i gjeneraliteteve të fëmijës etj.

Rastet e mbrojtjes së fëmijëve jepen në formë të tabelizuar më poshtë duke treguar dhe referencat ligjore përkatëse, që nuk janë respektuar nga OSHMA - të.

TIPOLOGJIA E SHKELJES	OSHMA	SANKSIONI
Shkelje etike, mbrojtja e të miturve (Nuk janë respektuar kërkesat e Kodit të Transmetimit, pika 4.64)	OSHMA Kombëtare	Térheqje vëmendje
Shkelje etike, mbrojtja e të miturve, publikim i gjeneraliteteve të fëmijës (Nuk janë respektuar kërkesat e Kodit të Transmetimit, pika 4.24)	OSHMA Kombëtare	Térheqje vëmendje
Shkelje etike, mbrojtja e të miturve (Nuk janë respektuar kërkesat e nenit 32/1 të ligjit 97/2013)	OSHMA Kombëtare	Térheqje vëmendje
Shkelje etike, mbrojtja e të miturve (Nuk janë respektuar kërkesat e Kodit të Transmetimit, pika 4.28 dhe 4.63)	OSHMA Kombëtare	Térheqje vëmendje
Përbajtje të papërshtatshme (Nuk janë respektuar kërkesat e nenit 4 dhe 33 të ligjit 97/2013)	OSHMA Kombëtare	Térheqje vëmendje

Transmetim pamjesh të rënda (Nuk janë respektuar kërkesat e nenit 4 dhe 33 të ligjit 97/2013)	OSHMA Kombëtare	(Gjobë 100 mijë lekë)
Mosrespektimi i kohës për transmetimin e reklamave dhe komunikimeve tregtare për pijet alkoolike (Nuk janë respektuar kërkesat e ligjit 97/2013, nenin 42, pika 5; si dhe Kodi i Transmetimit, pika 4.43)	OSHMA Kombëtare	Térheqje vëmendje
Përbajtje të papërshtatshme (Nuk janë respektuar kërkesat e ligjit 97/2013, nenin 33, pika 5; si dhe Kodin e Transmetimit, seksioni 7)	OSHMA Kombëtare	Térheqje vëmendje
Përbajtje të papërshtatshme (Nuk janë respektuar kërkesat e ligjit 97/2013, nenit 4, pika 2; si dhe Kodit të Transmetimit, pika 3.1)	OSHMA Rajonale	Térheqje vëmendje
Përbajtje të papërshtatshme (Nuk janë respektuar kërkesat e ligjit 97/2013, nenin 33, pika 1/d; si dhe Kodit të Transmetimit, pika 1.6)	OSHMA Kombëtare	Térheqje vëmendje
Përbajtje të papërshtatshme (Nuk janë respektuar kërkesat e ligjit 97/2013, nenin 4, pika 1, gërmë "b" dhe neni 33, pika 1/"d")	OSHMA Rajonale	Térheqje vëmendje
Përbajtje të papërshtatshme (Nuk janë respektuar kërkesat e Kodit të Transmetimit pika 4.64)	OSHMA Kombëtare	Térheqje vëmendje
Përbajtje të papërshtatshme (Nuk janë respektuar kërkesat e nenit 32/1 dhe nenit 33, pika 1/"ç" e ligjit 97/2013, si dhe pika 3.9 e Kodit të Transmetimit)	OSHMA Kombëtare	(Gjobë 50 mijë lekë)
Përbajtje të papërshtatshme (Nuk janë respektuar kërkesat e nenit 32/1 dhe nenit 33, pika 1/"ç" e ligjit 97/2013, si dhe pika 3.9 e Kodit të Transmetimit)	OSHMA Rajonale	(Gjobë 50 mijë lekë)
Përbajtje të papërshtatshme (Nuk janë respektuar kërkesat e nenit 32/1 dhe nenit 33, pika 1/"ç" e ligjit 97/2013, si dhe pika 3.9 e Kodit të Transmetimit)	OSHMA Rajonale	Térheqje vëmendje
Përbajtje të papërshtatshme (Nuk janë respektuar kërkesat e nenit 32/1 dhe nenit 33, pika 1/"ç" e ligjit 97/2013, si dhe pika 3.9 e Kodit të Transmetimit)	OSHMA Rajonale	Térheqje vëmendje
Përbajtje të papërshtatshme (Nuk janë respektuar kërkesat e nenit 32/1 dhe nenit 33, pika 1/"ç" e ligjit 97/2013, si dhe pika 3.9 e Kodit të Transmetimit)	OSHMA Rajonale	Térheqje vëmendje

Përbajtje të papërshtatshme (Nuk janë respektuar kërkesat e nenit 32/1 dhe nenit 33, pika 1/”ç” e ligjit 97/2013, si dhe pika 3.9 e Kodit të Transmetimit)	OSHMA Rajonale	Térheqje vëmendje
Përbajtje të papërshtatshme (Nuk janë respektuar kërkesat e nenit 32/1 dhe nenit 33, pika 1/”ç” e ligjit 97/2013, si dhe pika 3.9 e Kodit të Transmetimit)	OSHMA Rajonale	Térheqje vëmendje
Përbajtje të papërshtatshme (Nuk janë respektuar kërkesat e nenit 32/1 dhe nenit 33, pika 1/”ç” e ligjit 97/2013, si dhe pika 3.9 e Kodit të Transmetimit)	OSHMA Rajonale	Térheqje vëmendje
Përbajtje të papërshtatshme (Nuk janë respektuar kërkesat e ligjit 97/2013, nenin 4, pika 1/b dhe 1/dh, neni 33, pika 1/d dhe të Kodit të Transmetimit, pikat 4.5, 4.6, 4.11, 4.66, 4.67 dhe 4.69).	OSHMA Rajonale	Térheqje vëmendje
Përbajtje të papërshtatshme (Nuk janë respektuar kërkesat e ligjit 97/2013, nenin 4, pika 1/b dhe 1/dh, neni 33, pika 1/d dhe të Kodit të Transmetimit, pikat 4.5, 4.6, 4.11, 4.66, 4.67 dhe 4.69)	OSHMA Rajonale	Térheqje vëmendje
Përbajtje të papërshtatshme (Nuk janë respektuar kërkesat e ligjit 97/2013, nenin 4, pika 1/b dhe 1/dh, neni 33, pika 1/d dhe të Kodit të Transmetimit, pikat 4.5, 4.6, 4.11, 4.66, 4.67 dhe 4.69)	OSHMA Rajonale	Térheqje vëmendje
Përbajtje të papërshtatshme (Nuk janë respektuar kërkesat e ligjit 97/2013, nenin 4, pika 1/b dhe 1/dh, neni 33, pika 1/d dhe të Kodit të Transmetimit, pikat 4.5, 4.6, 4.11, 4.66, 4.67 dhe 4.69)	OSHMA Rajonale	Térheqje vëmendje
Përbajtje të papërshtatshme (Nuk janë respektuar kërkesat e ligjit 97/2013, nenin 4, pika 1/b dhe 1/dh, neni 33, pika 1/d dhe të Kodit të Transmetimit, pikat 4.5, 4.6, 4.11, 4.66, 4.67 dhe 4.69)	OSHMA Rajonale	Térheqje vëmendje
Përbajtje të papërshtatshme (Nuk janë respektuar kërkesat e ligjit 97/2013, nenin 4, pika 1/b dhe 1/dh, neni 33, pika 1/d dhe të Kodit të Transmetimit, pikat 4.5, 4.6, 4.11, 4.66, 4.67 dhe 4.69)	OSHMA Rajonale	Térheqje vëmendje
Përbajtje të papërshtatshme (Nuk janë respektuar kërkesat e nenit 4, pika 2/b dhe 2/dh, nenit 33, pika 1/d; si dhe pikat 4.6, 4.11, 4.66, 4.67 dhe 4.69 të Kodit të Transmetimit)	OSHMA Rajonale	Térheqje vëmendje
Film në orar të papërshtatshëm, duke mos respektuar kërkesat e ligjit 97/2013, nenit 4, pika 1/b; si dhe pikat 4.1, 4.6 dhe 4.11 të Kodit të Transmetimit	OSHMA Kombëtare	Térheqje vëmendje



Transmetim pamjesh të papërshtatshme, duke mos respektuar kërkesat e ligjit 97/2013, nenit 4, pika 1/b dhe 2/b; si dhe pikën 1.6 të Kodit të Transmetimit	OSHMA Rajonale	Térheqje vëmendje
Transmetim pamjesh të papërshtatshme, duke mos respektuar kërkesat e ligjit 97/2013, nenit 4, pika 1/b dhe 2/b; si dhe pikën 1.6 të Kodit të Transmetimit	OSHMA Kombëtare	Térheqje vëmendje
Transmetim pamjesh të papërshtatshme, duke mos respektuar kërkesat e ligjit 97/2013, nenit 4, pika 1/b dhe 2/b; si dhe pikën 1.6 të Kodit të Transmetimit	OSHMA Rajonale	Térheqje vëmendje
Pamje jo etike dhe në orar të papërshtatshëm. Nuk janë respektuar kërkesat e ligjit 97/2013, neni 4, pika 1/b dhe neni 33, pika 1/d; si dhe Kodit të Transmetimit, pika 4.11	OSHMA Kombëtare	Térheqje vëmendje
Pamje të papërshtatshme, nuk janë respektuar kërkesat e Kodit të Transmetimit, pikat 3.16 dhe 3.18	OSHMA Rajonale	Térheqje vëmendje
Pamje të papërshtatshme për orarin e transmetimit, në shkelje të nenit 4, pika 1/b të ligjit 97/2013, si dhe Kodit të Transmetimit, pikat 4.1, 4.6 dhe 4.11	OSHMA Kombëtare	Térheqje vëmendje

5) Pas përfundimit të kursit të formimit për 15 interpretë të tjerë me gjuhën e shenjave, të vazhdojë të ndjekë procesin e plotësimit me interpretë/përkthyes për transmetimin me gjuhën e shenjave, në mënyrë që ky detyrim ligjor për të drejtën për informim për personat me aftesi të kufizuar në dëgjim të përbushet plotësisht

Referuar legjislacionit të AMA, neni 32/2 i ligjit 97/2013, i ndryshuar, ofrueshet e shërbimeve të mediave audiovizive kanë detyrim të marrin masa proporcionale që programet e transmetuara prej tyre të jenë të arritshme, në mënyrë graduale dhe progresive, nga personat me aftesi të kufizuar, si dhe të informojnë periodikisht për masat e marra në këtë drejtim. Gjithashtu, sipas nenit 67 pika 2/dh të ligjit 97/2013, përfituesi i licencës së shërbimit për programet audiovizive, duhet të përfshijë në mënyrë të arsyeshme përdorimin e gjuhës së shenjave në emisionet e lajmeve për njerëzit që nuk dëgjojnë, duke mundësuar realizimin e programit në përpunje me kërkesat e përcaktuara.

Veprimtaria e transmetimeve audiovizive, sipas nenit 4/d të ligjit 97/2013, duhet të garantojë të drejtën e çdo shtetasi për të marrë shërbime të transmetimeve audio dhe/ose audiovizive, të ofruara për publikun nga operatorët e shërbimeve audiovizive, që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Përbushja e këtij detyrimi ligjor në bashkëpunim me AMA - n është realizuar nga OSHMA - të, Klan, Top Channel, Vizion Plus dhe RTSH.

6) Ti kushtojë vëmendje të shtuar përbushjes së masave përkatëse të Planit Kombëtar për Personat me Aftesi të Kufizuar (2021 - 2025), të miratuar nga Këshilli i Ministrave, masa të cilat lidhen drejtpërdrejt me aksesueshmërinë në informacion dhe në komunikim të kësaj kategorie (personave me aftesi të kufizuar)



AMA, në cilësinë e autoritetit rregulator në fushën e mediave audiovizive, mban në vëmendje të veçantë e të vazhduar të gjitha përbajtjet audiovizive të cilat duhet të garantojnë respektimin e kërkesave ligjore lidhur me problematikën e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut. Ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, garanton në mënyrë të shprehur mosdiskriminimin për shkak paaftësie në aksesimin e përbajtjeve audio dhe audiovizive nga personat me aftësi të kufizuara.

Po ashtu, Kodi i Transmetimit i miratuar nga AMA përmban një sërë parashikimesh, që i referohen të drejtave dhe aksesit të personave me aftësi të kufizuara, të cilat janë hartuar në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara" dhe Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, si dhe duke pasur në vëmendje Planin Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (2021- 2025).

Në këto kushte, si edhe në kuadër të angazhimeve në fushën ndërkombëtare në drejtim të respektimit dhe promovimit të të drejtave dhe lirive të personave me aftësi të kufizuara, Autoriteti i Mediave Audiovizive, në vijimësi do të ketë në vëmendje marrjen masave e nevojshme që personat me aftësi të kufizuara të kenë akses në përbajtjen e transmetimeve audiovizive, në mënyrë që programet e transmetuara të bëhen gradualisht dhe në mënyrë progresive të aksesueshme, veçanërisht për personat me aftësi të kufizuara dëgjimi dhe shikimi, përmes interpretimit në gjuhën e shenjave, titrimit, përshkrimit me zë të titrave.

Evidentohet se në subjektet audioviziv kombëtare titrimi dhe dublimi i serialeve teleiviziv që transmetohen ka ardh në ndihmë veçanërisht për personat me aftësi të kufizuara dëgjimi dhe shikimi.

Marrja e masave si më sipër do të kërkohet nga subjektet audiovizive kombëtare të nisë fillimi nga transmetimet në kohën e shikueshmërisë maksimale, edicionet informative dhe programet me interes të veçantë për këtë kategori.

Në vlerësim dhe të komunikimit me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, lidhur me mbarëvajtjen e Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar 2021 - 2025, miratuar me Vendim Nr. 276/2021, objektivat e Planit janë të harmonizuara me Strategjinë e BE - së për Personat me Aftësi të Kufizuar 2020 - 2030. Theksojmë se aktualisht ekzistojnë ligji dhe VKM - të zbatuese, siç është VKM 1074/2015, ku pika 18 parashikon se: "Televizionet kombëtare transmetojnë rregullisht emisionin kryesor të lajmeve në opzionin e transmetimit të shoqëruar me titra dhe me gjuhën e shenjave". Në këtë kuadër do të organizohen tryeza pune ndërinstitucionale, të cilat do të parashikojnë dhe masat konkrete të cilat duhen ndërmarrë në këtë drejtim nga institucionet që janë të përfshira në

7) Të vijojë të japë kontributin e saj si pjesë e grupit ndërinstitucional të punës përlirimin e brezit të digjital dividend dy (DD2), si një proces me rëndësi dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të vendit, si dhe në ofrimin e shërbimeve me shpejtësi të lartë interneti

Pjesëmarrja dhe angazhimi i Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) në procesin e lirimit të brezit 700 MHz mbetet i vazhdueshëm për të garantuar që çdo aspekt i këtij tranzicioni të realizohet me sukses dhe të jetë në përputhje të plotë me interesat publike.

Në këtë kuadër, AMA ka marrë pjesë në një sërë takimesh të zhvilluara ndërmjet vendeve të rajonit, duke ndjekur me vëmendje ecurinë e procesit të lirimit të Dividentit të Dytë Digital (DD2). Gjatë këtyre takimeve, AMA ka kontribuar në ofrimin e zgjidhjeve të përkohshme për trajtimin e problematikave të hasura gjatë procesit.



Pas përfundimit të hartimit të projektit - ligjit “Për lirimin e frekuencave të Digital Divident 2 (DD2)”, AMA është në pritje të miratimit dhe hyrjes në fuqi të këtij projekt - ligji, që do të mundësojë vazhdimin e mëtejshëm të këtij procesi të rëndësishëm. Ky projekt - ligj ka për qëllim të sigurojë që qytetarët të kenë vazhdimi të aksesit në të gjitha programet televizive të transmetuara përmes rrjeteve tokësore, edhe pas lirimit të brezit 700 MHz, duke parashikuar një mekanizëm të kompensimit të pjesshëm për kostot shtesë dhe të drejtpërdrejta që mund të lindin si rezultat i lirimit të këtyre frekuencave.

8) Të ketë në vëmendje rritjen e vazhdueshme të cilësisë dhe efektivitetit të rolit rregulator të saj, si dhe përmirësimin e mëtejshëm të kapaciteteve njerëzore dhe sistemeve të mirëfunksionimit të brendshëm të autoritetit

Me ndryshimet e strukturës së AMA - s, miratuar me vendimin nr. 86/2022 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) është riorganizuar Drejtoria e Monitorimit dhe Analizës, në të cilën janë irritur kapacitetet njerëzore për monitorimin e transmetimeve audiovizive në funksion të rolit mbikëqyrës dhe rregulator të autoritetit duke shtuar shqyrtimet cilësore që lidhen me diskriminimin, gjuhën e urrejtjes, format e ndryshme të çrrëgullimeve në informacion, proceset zgjedhore etj. Gjatë periudhës raportuese AMA ka shqyrtuar kryesisht (ex officio) 185 raste për përputhjen ligjore të përbajtjeve të transmetuara, ku ka identifikuar mosrespektim të kërkesave të ligjit 97/2013 apo Kodit të Transmetimit në 60 raste. Nga këto në 12 raste (20%) ka pasur përdorim të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminim. Dy prej këtyre rasteve kanë pasur diskriminim gjinor.

Në lidhje me rolin mbikëqyrës dhe rregulator të autoritetit, AMA, gjatë kësaj periudhe ka qënë në kontakte të vazhdueshme me homologet e saj, në lidhje me teknikat dhe pajisjet e nevojshme që ndihmojnë në frenimin e fenomenit të piraterisë televizive. Ky është një proces në vazhdim. Gjithashtu, AMA, nëpërmjet kanalit të bashkëpunimit të vendosur me platformën TikTok, deri në fund të muajit Dhjetor 2024, ka raportuar në këtë platformë 1,513 raste të videove që transmetojnë produkte audiovizive pa të drejta, nga të cilat 1,505 raste është bërë bllokimi i këtyre videove nga TikTok. Në vijim, është kryer dhe mbyllja e 193 profileve në TikTok, të cilët pëndoreshin për shitjen e produkteve audiovizive, në mënyre pirate. Gjithashtu, AMA, ka kryer takime dhe me policinë e shtetit në lidhje me fenomenin e piraterisë dhe së shpejti do të ngrejë grupe të përbashkëta dhe me institucione të tjera, për kontolle të përbashkëta në terren në lidhje me këtë fenomen.

Një risi tjetër këtë vit, janë dhe takimet që po kryen Kryetarja e AMA - s, bashkë me stafin e saj, me të gjithë operatorët kabllor të Qarqeve të ndryshëm të vendit, ku diskutim kryesor është fenomeni i piraterisë që kryhet nga operatorë ISP të paautorizuar nga AMA, për transmetime audiovizive. Fokus i këtyre diskutimeve është dhe bashkëpunimi i ndërsjelltë në evidentimin e rasteve të ndryshme nga operatorët kabllorë dhe paraqitja e tyre pranë AMA - s, në mënyrë që kjo e fundit të vazhdojë me procedurat e mëtejme të inspektimit në terren. Gjithashtu, edhe ky proces është në vazhdimësi.

Gjatë vitit 2024, AMA në kuadër të zhvillimit të mëtejshëm të kapaciteteve dhe përmirësimit të sistemeve të mirëfunksionimit të brendshëm të autoritetit, ka përfunduar procesin e digitalizimit të dokumentacionit arkivor të njësisë së arkivë - protokollit. Nëpërmjet këtij procesi është mundësuar optimizimi i eficencës dhe reduktimi i konsiderueshëm i kohës së qarkullimit shkresor në institucion dhe sigurimi i kopjeve elektronike të dokumentacionit hard copy.

Gjatë vitit 2024, AMA në kuadër të zhvillimit të mëtejshëm të kapaciteteve dhe përmirësimit të sistemeve të mirëfunksionimit të brendshëm të autoritetit, ka përfunduar procesin e digitalizimit të dokumentacionit



arkivor të njësisë së arkivë - protokollit. Nëpërmjet këtij procesi është mundësuar optimizimi i eficencës dhe reduktimi i konsiderueshëm i kohës së qarkullimit shkresor në institucion dhe sigurimi i kopjeve elektronike të dokumentacionit hard copy.

Gjithashtu, institucioni ka digjitalizuar të gjitha aktivitetet e tij, të cilat publikohen në mënyrë të vazhdueshme në faqen zyrtare të internetit, duke u administruar përmes një sistemi të centralizuar të Menaxhimit të Përmbajtjes (CMS). Në përputhje me standartet dhe kërkesat e AMA - s për garantimin e qasjes së barabartë në informacion për personat me aftësi të kufizuara, janë ndërmarrë disa masa të rëndësishme për të siguruar aksesueshmëri të plotë, përfshirë:

- Ofrimi i teksteve alternative dhe përshtimeve për imazhet, në mënyrë që përdoruesit me nevoja të veçanta të kenë akses të plotë në përbajtje;
- Mundësimi i rregullimit të madhësisë së tekstit dhe elementeve vizuale të faqes, për një përvojë më të personalizuar dhe lehtësish të aksesueshme;
- Krijimi i një formulari kontakti të thjeshtë dhe të aksesueshmë për të gjithë vizitorët;
- Optimizimi i skemës së ngjyrave të faqes, duke përmirësuar kontrastin dhe lexueshmërinë, në përputhje me standartet ndërkombëtare të aksesueshmërisë.

Aktualisht, është duke u zhvilluar një seksion i dedikuar për personat me aftësi të kufizuara, ku do të ofrohet përbajtje tekstuale në formate audio për të lehtësuar aksesin në informacionin publik dhe për të përmirësuar përvojën e përdoruesve. Këto veprime janë në përputhje të plotë me rezolutën e AMA - s dhe angazhimet ndërkombëtare për barazi në qasje ndaj informacionit.

Në kuadër të përmirësimit të kapaciteteve njerëzore, në fokus kanë qënë politikat e trajnimit si pjesë e strategjisë së burimeve njerëzore, të cilët janë objektivi kryesor për të siguruar një administratë publike të efektshme, të përgjegjshme dhe profesionale. Specifisht është hartuar kalendari vjetor i nevojave për trajnim, mbështetur në një plan trajnimi të detajuar në bazë të kërkesave specifike të çdo njësie organizative si dhe në përkrahje të angazhimit të punonjësve për zhvillim të njojurive të tyre profesionale dhe organizative.

Në ndjekje të zbatimit të këtij kalendari trajnimi dhe në ushtrim të së drejtës së formimit profesional dhe jo vetëm, të gjithë nëpunësit civil kanë pasur mundësinë të ushtrojnë të drejtën për të përmirësuar aftësitë profesionale nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme.

Format e trajnimeve kanë qënë të ndryshme, duke përmendur edhe bashkëpunimin e ngushtë me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) ku në total, nga AMA për periudhën janar - dhjetor janë trajnuar 20 nëpunës civil. Llojet e trajnimeve që këta nëpunës kanë ndjekur pranë ASPA - s kanë qënë të ndryshme, duke filluar nga trajnimi i thelluar, nëpërmjet të cilit nëpunësit janë njojur me parimet themelore, mënyrën e organizimit të administratës, kuadrin ligjor, menaxhimin sa më të mirë të burimeve për arritjen e objektivave e deri te trajnimet e karrierës.

Pjesëmarrje të lartë të nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjera, ka pasur edhe në konferanca, simpoziume, workshop - e apo seminare të organizuara nga institucione apo organizata kombëtare/ndërkombëtare përfusha të ndryshme profesionale.

9) AMA, të luajë një rol proaktiv, nga njëra anë, duke reaguar me vendosmëri në rastet e kanosjeve dhe sulmeve kundër gazetarëve dhe nga ana tjetër, në përmirësimin e kushteve të punës për gazetarët, veçanërisht duke forcuar mbrojtjen e të drejtave të punësimit dhe sociale të tyre

Në periudhën raportuese AMA ka reaguar ndaj një incidenti që ndodhi më 28 Maj 2024, në një mjeshtësi të hapur, para godinës së Bashkisë së Tiranës, ku zhvillohej një protestë, por që siguria e grüpuit të reporterëve dhe kameramanëve të medias u vu në rrezik si pasojë e përdorimit të lëndëve shpërthyese (molotov). Duke shprehur shqetësim për ngjarjen, AMA në një qëndrim publik u shpreh se “pasiguria në punën e medias që mbulon një protestë a demonstratë është e papranueshme, është goditje përfjalën e lirë dhe kufizim përfundimini e publikut. Autoritetet ligjzbatuese të rendit, por dhe organizatorët e protestave, duhet të marrin masa konkrete përfundimtare aktivitetin e reporterëve në terren, përfundimtare lënë të hapur komunikimin e tyre me publikun në mbulimin e dinamikës së ngjarjeve”. AMA po ashtu, u kërkoi autoriteteteve, “që të identifikojnë sa më parë dhe të ndjekin ligjërisht çdo akt që sulmon drejtpërdrejt apo rrezikon ekipet e medias që janë në kryerje të detyrës”.

Gjithashtu, gjatë periudhës raportuese AMA ka vijuar mbështetjen e standardeve profesionale të transmetimeve audiovizive duke bashkëfinancuar projekte që synojnë të përmirësojnë raportimin nga redaksitë në çështje të ndryshme tematike që ato mbulojnë/trajtojnë në përbajtjet e transmetuara.

Kjo mbështetje konkrete e AMA - s jetet përmes Projekteve dhe ka pasur si qëllim realizimin e studimeve dhe kërkimeve sasiore dhe cilësore, aktiviteteve kualifikuese dhe trajnuese, fushatave informuese dhe sensibilizuese, botimeve dhe përkthimeve në fushën e medias.

Në këtë kuadër, AMA i është përgjigjur pozitivisht detyrimeve të procesit të integrimit duke e trajtuar mbrojtjen e gazetarëve gjatë raportimeve si dhe problematikat specifike të profesionit të tyre, duke u bërë pjesë aktive e Grüpuit Ndërinstitucional nën koordinimin e Ministrisë së Drejtësisë, me pjesëmarrjen e institucionit të KLP - së, KLGJ - së, Policisë së Shtetit, Inspektoriatin e Punës, shoqata e gazetarëve si dhe Fakultetit të Gazetarës përfundimtare të adresuar të gjitha problematikat që lidhen me profesionin e gazetarit, si dhe pozicionin dhe qasjen e tij gjatë ushtrimit të profesionit, rregullimet e kontratave të punës për gazetarët duke i hapur rrugën kështu zbatimit të një plani masash nën këtë drejtim. Viti 2024 u mbyll me shumë sfida nga institucionet e përmendura së bashku me AMA - n në këtë drejtim, pasi qëllimi i përbashkët ishte konkretizimi i një platforme të përbashkët me qëllim dhe bëren e hapave konkret sikurse dhe Komisioneri Europian i kërkon në drejtim të profesionistëve të medias.

Tjetër projekt që mbështet AMA është ai me titull “Evitimi i gjuhës së urrejtjes në median audiovizive”. Gjuha e urrejtjes është një sfidë e vazhdueshme me të cilën përballet shoqëria dhe në veçanti media. Zhvillimi i vrullshëm i teknologjisë, e ka ridimensionuar median tradicionale, duke e bërë atë të pranishme edhe në rrjetet sociale. Qëllimi i këtij drejtimi është vëzhgimi i mediave audiovizive përfundimtare sa e pranishme është gjuha e urrejtjes, faktorët që ndikojnë në shfaqjen e saj dhe njohja me praktika të suksesshme në vendet e tjera që kanë ndikuar në evitimin e gjuhës së urrejtjes pas zhvillimeve të vrullshme teknologjike.

Gjithashtu, një projekt më rëndësi në funksion të përmirësimit të profesionit të gazetarisë ishte projekt i parashikuar me drejtim “Profesioni i gazetarisë në epokën e ndryshimeve teknologjike dhe mediave të reja”. Profesioni i gazetarisë është në fazë të vazhdueshme ridimensionimi, kjo përfshak se ndryshimet e shumta të teknologjisë kanë ndikuar në stilin, formatin dhe në shpërndarjen e informacionit. Mediat e reja si dhe zhvillimi i teknologjisë kanë bërë që në një media proceset e punës të mos jenë njësoj si shumë vite më parë. Ndodhur në këto kushte, lindi nevoja e një vëzhgimi të mjeshtësuar mediatik në Shqipëri. Kjo do të ndihmonte përfundimtare sa ka ndryshuar profesioni i gazetarisë dhe sa janë përshtatur mediat audiovizive në vendin tonë krahësuar me vendet perëndimore në raport me ndryshimet teknologjike.



Në përputhje me detyrimet e veta ligjore, Këshilli i Ankesave në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2024, konceptoi organizimin e një anketimi (vrojtimi me objekt matjen e perceptimit) kombëtar, me synim matjen e perceptimeve të publikut shqiptar lidhur me standartet etike të ofertës audiovizive.

Ndërmarrja e një kërkimi sasior të mirëfilltë të kësaj natyre, paraqiste domosdoshmëri në kushtet e:

- përfundimit të procesit të digitalizimit dhe për pasojë të zgjerimit dhe diferencimit të ofertës audiovizive;
- nevojës për verifikim të sjelljes dhe pritshmërise të publikut në kushtet e sipërpërmendura;
- detyrimeve të rrjedhura në kuadrin e përshtatjes së legjislacionit organik shqiptar me atë të BE;
- shtimit të nismave qytetare, që flasin në emër të pritshmërise dhe perceptimit të publikut të gjërë dhe mundësisë së kufizuar për t'u vënë atyre përballë matjet tona përkatëse;
- nevojës së krijimit të një baze të besueshme të dhënat, për mbështetjen edhe statistikore të vendimarrjeve të Këshillit të Ankesave, në veçanti dhe Autoritetit, në përgjithësi.

Për t'iua përshtatur më mirë sfidave dhe kërkësave të kohës, pyetësori, i hartuar nga Këshilli i Ankesave përfshinte edhe një grup pyetjesh me fokus lirinë e shprehjes dhe të drejtat e gazetarëve si dhe një grup pyetjesh me fokus platformat e shpërndarjes së videoeve.

Për standard sa më të lartë shkencor të realizimit të synimeve, dizenjimin e një kampioni statistikor dhe demografik sa më përfaqësues në rang vendi dhe marzh sa më të vogël gabimi, vrojtimi u krye në bashkëpunim me Institutin e Statistikave.

10) Të ketë në fokus të punës së saj nxitjen dhe mbështetjen e standardeve profesionale të transmetimeve audiovizive nëpërmjet praktikave më të mira ndërkombëtare, si dhe sigurimin e diversitetit në transmetimet audiovizive

Gjatë periudhës raportuese, AMA ka vijuar dhe me fushatën ndërgjegjësuese dhe informuese “Fol shqip” me qëllimin e përmirësimit të gjuhës së folur dhe të shkruar në transmetimet audio/audiovizive, fushatë që ndikon drejtpërdrejt në rritjen e standardeve profesionale të redaksive. Periodikisht AMA ka publikuar në website - n zyrtar dhe në llogari të saj në rrjetet sociale fjalë të huaja të përdorura nga redaksitë apo dhe formulime shprehjesh jo të bazuara në standartet e shqipes së folur dhe të shkruar. Në fillim të muajit shkurt 2024, AMA organizoi tryezën me temë: “Fol Shqip – Të mbrojmë dhe të duam gjuhën shqipe”, ku ishin prezantë gjuhëtarë të shquar që i janë bashkuar kësaj fushate, gazetarë të medias audio/audiovizive dhe të shkruar, pedagogë e studentë të gazetarisë. Në tryezë u përmend përkrahja e menjëherëshme që iu bë fushatës nga komuniteti i medias, por dhe gjuhëtarët e studiuesit e fushës, çka vërteton ndjeshmërinë që ka për këtë aspekt. Nga të pranishmit u theksua se gjuha shqipe është tipar themelor i kombit shqiptar, prandaj atë duhet ta ruajmë dhe ta mbrojmë, ta shkruajmë e ta flasim sa më thjeshtë e sa më bukur. Po ashtu, u nënvizua se kultura e gjuhës është pjesë e kulturës së përgjithshme dhe kur kjo çalon, atëherë çalon edhe kultura e gjuhës.

Shumë gazetarë i janë bashkuar kësaj fushate të AMA që pati jehonë edhe në Kosovë e Maqedoninë e Veriut. Një ndër emisionet kryesorë të RTV21 ka pikërisht titullin “Fol Shqip Show” dhe në bashkëpunim me AMA-n evidentohen fjalët e huaja dhe u jepen gazetarëve fjalët zëvendësuese shqip.

Ndërkaq, në faqen zyrtare të AMA - s pas monitorimit të fjalëve të huaja të përdorura në mediat audiovizive, sillen në formë grafike dhe gjegjëset e tyre në shqip, e kjo me qëllimin për të trajnuar gazetarët dhe punonjësit e tjerë të medias në ruajtjen dhe pastërtinë e Gjuhës Shqipe.

11) Të punojë për përmirësimin e kuadrit rregulator në drejtim të forcimit të luftës kundër piraterisë televizive në përputhje me standartet e BE - së dhe praktikat më të mira ndërkombëtare

Në kuadër të zbatimit të detyrimeve periodike të përafrimit të legjislacionit të brendshëm me acquis e BE- së

në fushën e medias audiovizive, AMA ka propozuar ndryshime në ligjin 97/2013, të ndryshuar, për të forcuar luftën kundër piraterisë televizive dhe disa plotësimë të tjera në lidhje me konceptet e shtrirjes dhe funksionimit të licencës audiovizive si mangësi që janë ndeshur në ligj gjatë ushtrimit të funksionit të Autoritetit.

Rregullorja e Bashkimit Evropian 2022/2065 përfshin rregulla të zbatueshme për shërbimet ndërmjetëse në tregun e brendshëm të cilat janë më evidente në rastet e ritransmetimit të paautorizuar të eveneve të drejtëpërdrejta

Me qëllim realizimin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (2024 - 2026), AMA mbështetur në rekandimet e BE - së, eshtë e gatshme të krijojë një kuadër ligjor që të mbrojë sa më tepër krijuesit e programeve artistike apo mbajtësit e të drejtave të transmetimit të eveneve të mëdha nga abuzimet me transmetimet, pa patur të drejtë apo ritransmetimet e paautorizuara që mund të shkaktojë humbje të konsiderueshme në të ardhura, si për organizatorët e eveneve, ashtu dhe për ata që gëzojnë të drejtat e transmetimit të fituara sipas ligjit.

Lidhur për sa më sipër, eshtë detyrë funksionale e AMA - s dhe në kuadër të procesit të përafrimit të legjislacionit me legjislacionin e BE - së në fushën e medias audiovizive, që lindi nevojën e përmirësimit të kuadrit ligjor në fuqi në mënyrë që ti presë rrugën abuzimit me të drejtat e transmetimit si dhe ti vijë në ndihmë aktorëve të interesuar që këto të drejta i gëzojnë. Ndryshimet që propozohen ti bëhen ligjit lidhur me piraterinë janë si më poshtë vijon:

Neni 132/1 “Pirateria”

- Prodhuesi i një vepre audiovizuale eshtë personi fizik ose juridik, i cili eshtë përgjegjës për prodhimin e veprës, si dhe siguron burimet e nevojshme teknike e financiare për realizimin e saj, sipas kushteve të kontratës. E drejta e transmetimit audioviziv eshtë e drejta ekskluzive e prodhuesit apo e subjektit që gëzon të drejtën e transmetimit apo shpërndarjes me leje apo marrëveshje për kalim të drejash me prodhuesin;
- Kalimi i së drejtës, të bëhet vetëm në bazë të një kontrate me shkrim, e cila depozitohet pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive;
- Subjekti/personi i cili pa licencë/autorizim: transmeton, heq ose ndryshon të dhënat e të drejtave të transmetimit audioviziv, në formë elektronike, prodhon, shpërndan, me qëllim të vendosjes në treg, transmeton, komunikon me publikun ose vë në disposicion të publikut vepër ose objekte të mbrojtura nga të drejtat e transmetimit ose të drejta të tjera të lidhura me të, kryen shkelje të këtij ligji dhe si i tillë do të ndëshkohet. Subjekt i këtij ligji do të jenë edhe përfituesit, të cilët përfitojnë nga shkelja dhe marrin programe pa të drejta.
- Subjektit e licencuara nga AKEP, si ofrues të shërbimit të internetit, që transmetojnë vetë ose nëpërmjet rrjetit të tyre, programe pa patur të drejtë transmetimi, pas njoftimit nga AMA, brenda 30 minutave duhet të ndërpresin menjëherë transmetimin pa të drejta. Nëse subjekti nuk reagon brënda këtij afati, do ti nënshtrohet parashikimeve të nenit 133/5 të këtij ligji.

Ky nen eshtë një nga propozimet më të rëndësishme dhe të plota që i bëhen ligjit në këndëvështrim të konceptit “Pirateri” e cila hyn në këtë ligj në aspektin e shkeljes së të drejtave të transmetimit. Kemi ardhur në këtë pikë bazuar në fenomenet dhe problematikat e konstatuara në terren, të cilat kanë shtruar nevojën e rregullimit dhe përditësimit të ligjit organik të AMA - s, me të gjitha dukuritë që janë përhapur aq shumë në realitetin tonë mediatik.

Aktualisht ligji eshtë në konsultim publik në faqen zyrtare të AMA - s, në përfundim të së cilit AMA do të vijojë me fazat e tjera deri në përpunim të tekstit përfundimtar të projekt – ligjit, i cili do të paraqitet ne Kuvend.





3. REKOMANDIMET E LËSHUARA NË PROGRES - RAPORTIN E BE-SË DHE DETYRIME TË TJERA NDËRKOMBËTARE NDAJ AUTORITETIT^[1]

Disa nga rekomandimet e progres - rapportit të BE - së për Shqipërinë, për vitin 2024:

- Adresimi i përqendrimit të lartë në pronësinë së medias dhe rritja e ndjeshme e transparencës së financimit të medias, duke përfshirë rishikimin e kërkesave ligjore për reklamën publike, në përputhje me standardet europiane

Piketat e vendosura në Rezolutën e Kuvendit për vitin 2024 përkojnë qartazi dhe me rekomandimet e rapportit të BE - së për Shqipërinë, për vitin 2024, AMA në raportimet e saj përiodike për detyrimet të cilat vijnë nga Kapitujt e procesit të negociatave ku ne jemi kontribues, ka theksuar ashtu sikurse dhe për Rezolutën, pozicionin e saj si dhe hapat konkret të ndërmarrë për çështjet e adresuara.

Siq AMA ka reportuar edhe më parë, çdo vit institucioni harton Buletinin Periodik, i cili përban një set të dhënash, përfshirë këtu edhe të dhëna për kuotat e pronësisë, që aksionarët e OSHMA - ve zoterojnë, jo vetëm në tregun mediatik, por edhe në fusha të tjera të industrisë mediatike.

Buletini Periodik nr. 10, është i fundit i publikuar në faqen zyrtare të AMA - s dhe përban të dhëna për vitin 2023.

Gjithashtu, bazuar në nenin 62, pika 12 të ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar, përvèç kufizimeve në aksione të kompanive mediatike, përeaktohet edhe një "tavan" për të ardhurat nga reklamat. Sipas këtij neni, asnjë zotëruesh i licencave kombëtare të transmetimeve audio dhe licencave kombëtare të transmetimit audioviziv, përfshirë OSHMA - të të autorizuara për shërbimin e programeve të mbështetura në rrjete satelitore, në bazë të këtij ligji, nuk mund të transmetojnë më shumë se 30% të reklamave në tregun e transmetimeve audiovizive. Përmes këtij parashikimi ligjor, synohet të mënjanohet situata e centralizimit të pushtetit mediatik në duart e një subjekti mediatik të licencuar për rrjet numerik kombëtar apo shërbim kombëtar audioviziv si dhe dominimit të tregut mediatik, prej një ose më shumë subjektesh.

Në bazë të këtij neni, AMA monitoron dhe publikon informacion periodik, në baza mujore, mbi volumin e reklamave të transmetuara nga transmetuesit kombëtarë. Në baza vjetore për vitin në raportim, të dhënat e reklamave institucionale kanë qenë nga 0,08% në 2,21% për subjektet private dhe nga 0,003 % deri në 10.95% për transmetuesin publik.

[1] https://commission.europa.eu/document/download/0154dee1-5026-45de-8b37-e3d56ef7925_en?filename=59_1_58088_coun_chap_albania_al.pdf page 15,16,19

Nën monitorim mbahen edhe zëra të tjerë në transmetimet audiovizive si, koha e plotë në minuta dhe përqindje për partitë politike; koha për institucionet në minuta dhe përqindje; aktorët sinkron; temat e lajmit në minuta dhe përqindje në radio dhe televizione me licencë kombëtare, si dhe blerësit më të mëdhenj të hapësirës televizive. Kjo bazë e plotë e të dhënave mbi tendencat e transmetimeve audio dhe audiovizive publikohen çdo muaj edhe në faqen zyrtare të AMA-s <https://ama.gov.al/monitorimi-i-permbajtjeve/>.

Për më tepër, kuadri ligjor dhe nënligjor në fuqi parashikon kufizime që lidhen me formën e organizimit të shoqërisë mbajtëse të licencës së transmetimit audio/audioviziv numerik, përqindjen e aksioneve që mund të zoterojë një person fizik/juridik në këtë shoqëri, si dhe me numrin e licencave të transmetimit audio/audioviziv. Kufizime të tillë kanë për qëllim të sigurojnë nxitjen e pluralizimit në media dhe promovimin e shumëlojshmërisë së përbajtjes së tyre.

Vlen gjithashtu të theksohet se me ndryshimet e fundit të ligjit për mediat audiovizive, hyrë në fuqi në maj 2023, në kuadër të transpozimit të Direktivës së BE - së 2018/1808 (AVMSD), është përfshirë tashmë detyrimi që ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive duhet të bëjnë publik informacionin në lidhje me strukturën e tyre të pronesisë, duke përfshirë edhe pronarët përfitues.

Në prill të vitit 2024, AMA miratoi Rregulloren për ndryshimet në pronesi dhe deklarimin e pronarit përfitues. Rregullorja "Për kërkесat dhe procedurat e rishikimit të ndryshimeve në strukturën e pronesisë dhe transparencën e të dhënave të pronesisë së OSHMA-ve" për ndryshimet në strukturën pronësore solli risi mbi:

- Shqyrtimin nga AMA të ndryshimeve të ndodhura në strukturën pronësore brenda të njëjtë person juridik OSHMA, mbajtës i licencës ose i autorizimit nga AMA, të cilat nuk passjellin cedimin ose kalimin e të drejtave që burojnë nga licenca ose autorizimi;
- Shqyrtimin e ndryshimeve në strukturën pronësore mes personave juridikë privatë OSHMA, në rastet e hyrjes në marrëdhënie juridike civile të cilat passjellin cedimin ose kalimin e të drejtave që burojnë nga licenca ose autorizimi;
- Deklarimin e informacionit mbi përbërjen e strukturës së pronesisë së personit juridik OSHMA mbajtës i licencës ose i autorizimit nga AMA, duke përfshirë pronarin përfitues;
- Transparencë e shtuar mbi origjinën e burimeve të financimit për kryerjen e transaksioneve tregtare të kapitalit të shoqërisë mediatike prej ortakut/aksionerit;
- Deklarim të çdo lloj konflikti të mundshëm interes i që ndikon në veprimtarinë e OSHMA - së prej pronarëve;
- Procedurës së vlerësimit të aplikimit dhe vendimarrjes prej AMA - s;
- Bashkëpunimin e rregulatorit me institucione ose agjenci të tjera shtetërore të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me zbatimin e rregullores në praktikë, rast pas rasti, etj.

AMA ka publikuar një bazë të dhënash me informacion rrëth operatorëve audio dhe audiovizivë në Republikën e Shqipërisë, e cila gjendet në rubrikën OSHMA, në faqen WEB të saj. Në të përfshihen të dhënat e të gjithë OSHMA - ve që AMA ka autorizuar/licencuar, të përbledhura në një format i cili është lehtësish më i përdorshëm nga qytetarët apo grupet e interesit.

Një objektiv i arritur i Autoritetit të Mediave Audiovizive përgjatë vitit 2024 është edhe publikimi i një baze digitale të dhënash mbi strukturën e pronesisë së OSHMA - ve të autorizuar/licencuar nga AMA. Kjo bazë të dhënash është lehtësish e gjendshme dhe e aksesueshme për përdorim nga çdo i interesuar, pasi ndërtimi dhe struktura e informacionit të publikuar është realizuar në mënyrë të tillë që të jetë e qartë dhe e kuptueshme për të gjithë.



Ky informacion gjendet në faqen WEB të Autoritetit të Mediave Audiovizive, në rubrikën “Transparenca e Pronësisë së Medias” <https://ama.gov.al/baza-e-te-dhenave-struktura-pronesore-e-oshma/>.

- ***Adresimi i çështjes për forcimin e pamvarësisë dhe autonomisë së rregulatorit***

Autoriteti i Mediave Audiovizive është autoriteti rregulator kolegjial dhe të pavarur në fushën e shërbimeve të transmetimit audio dhe audioviziv në Shqipëri. AMA përbëhet nga Kryetari, Zv/Kryetari dhe pesë anëtarë; Anëtarët e Bordit të AMA - s nuk janë të ndikuar financiarisht ose politikisht; Anëtarët e Bordit emërohen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ndër profesionistët e dalluar të medias ose të drejtës në vend. Anëtarët kanë një mandat prej 5 vite, me mundësinë e rinovimit të vetëm një mandati. Anëtarët e AMA - s kryejnë detyrat e tyre me integritet dhe pavarësi profesionale, duke shmangur çdo ndikim nga interesa financiare, pikëpamje politike dhe duke garantuar të drejtën e publikut për informacion.

Përveç Bordit, ka një strukturë tjeter që operon në mënyrë të pavarur brenda AMA - s, e cila është Këshilli Ankesave. Këshilli i Ankesave emërohet nga AMA me shumicë votash 3/5; Ai përbëhet nga Kryetari dhe 2 anëtarë ekspertë në fushën e medias.

Ky Këshill ka një mandat 3 - vjeçar, me mundësinë e rinovimit të vetëm një mandati. Këshilli i Ankesave trajton ankesat ose kërkesat për një program të transmetuar audioviziv, përbajtje ose lajme, të marra nga çdo palë e interesuar, e cila ka pësuar ndonjë dëm në privatësinë, jetën private, dinjitetin ose të drejtat e tjera.

Pavarësia e Autoritetit garantonet me ligj nga:

1. Procesi i zgjedhjes së Kryetarit dhe anëtarëve dhe Kryetarit të AMA - s (nenet 8 - 12);
2. Rregullimi i mënyrës për të identifikuar rastet e mundshme të papajtueshmërisë dhe konflikteve të interesit të anëtarëve dhe Kryetarit të AMA - s (neni 7) – Anëtarët nuk duhet të kenë lidhje ose anëtarësi politike, të mos zoterojnë kapital, aksione, ose të drejta të tjera në fushën e medias audiovizive, të deklarojnë çdo rast të mundshëm të konfliktit të interesit në vendimmarrje, si dhe të mos shprehin ose mbajnë qëndrime publike që mund të démtojnë paanshmërinë e tyre;
3. Mënyra se si financohet Autoriteti (nenet 24 - 27) - Aktiviteti i AMA - s ka si qëllim ruajtjen e qëndrueshmërisë financiare të institucionit, përmes përdorimit efikas të burimeve të tij, duke përbushur detyrat dhe nevojat e Autoritetit, duke u udhëhequr nga transparenca dhe llogaridhënia;
4. Mënyra e organizimit, funksionimit, kompetencave dhe vendimmarrjes së AMA - s (nenet 15 - 21, 23, 28 - 29).

Në përputhje me nenin 24 të ligjit nr. 97/2013, datë 19.03.2013, burimet e financimit të AMA - s janë si më poshtë:

- a) të ardhurat nga pagesat për dhënien dhe rinovimin e licencave dhe/ose autorizimeve;
- b) të ardhurat nga pagesat vjetore të licencave dhe/ose autorizimeve;
- c) të ardhurat nga përpunimi administrativ i kërkesave për aplikime;
- d) Të gjitha indikatorët finanziarë publikohen në faqen e internetit të AMA - s.

Në përputhje me nenin 25 të ligjit të mësipërm, thuhet: “... Për të mbuluar shpenzimet e nevojshme për kryerjen e funksioneve të tij, AMA përcakton, me një vendim të veçantë, të gjitha tarifat për licencat dhe/ose autorizimet e ofruesve të shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive, shërbimeve të tjera, si dhe pagesat për përpunimin administrativ”.

Sipas vendimit të mësipërm, është miratuar Vendimi i AMA - s Nr. 220, datë 01.12.2017 "Për përcaktimin e tarifave për licencat/autorizimet dhe shërbimet e kryera nga Autoriteti i Mediave Audiovizive" për të përcaktuar tarifat e mbledhura nga ofruesit e mediave. AMA është një institucion që vetëfinancohet dhe në përputhje me nenin 25(5) të Ligjit Nr. 97/2013, "... Çdo mbetje nga të ardhurat e tarifave/pagimeve, e mbetur pas shpenzimeve funksionale të AMA - s, në fund të vitit finanziar, ruhet në llogaritë e AMA - s dhe përfshihet në planin e shpenzimeve të vitit tjetër...".

Në të njëjtën linjë me qëndrimin institucional të mbajtur nga AMA gjatë adresimit të kësaj çështje, ritheksojmë se ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, garanton pavarësinë e plotë dhë të qartë të Autoritetit, duke filluar me dispozitat që përcaktojnë statusin e AMA - s, mënyrën e propozimit dhe zgjedhjes së anëtarëve dhe kryetarit të AMA - s, papajtueshmëritë dhe konfliktet e interesit të anëtarëve dhe kryetarit të AMA - s, për të vazhduar me mënyrën e pavarur të financimit, mënyra e organizimit, funksionimit dhe vendimarrjes së AMA - s.

Duke iu referuar legjislacioneve të vendeve të tjera evropiane, rezulton se mënyra e konstituimit, funksionit dhe financimit të AMA - s është e ngashme me shumicën e këtyre vendeve, duke përmendur këtu Italinë apo Francën, në të cilat irregulatori i medias zgjidhet tëresisht (Italia) apo pjesërisht (Franca) nga parlamenti dhe raporton përpara tij lidhur me veprimtarinë vjetore, si dhe gjëzon pavarësi të plotë institucionale nga ekzekutivi, si në aspektin finanziar edhe në atë të vendimarrjes. Gjatë vitit 2024 AMA ka raportuar në kuadër të adresimit të kësaj çështje se rregullimi i legjimit të pamvarësisë dhe autonomisë së rregulatorit i qëndron përcaktimëve në ligj dhe mirëpret çdo referim për ndryshimet ligjore që garantojnë pamvarësinë dhe autonominë e Rregulatorit Audioviziv.

- Forcimi i rregullave të reklamës mediatike për të pasur një transparencë dhe pavarësi mediatike, duke përfshirë rregullat e shpërndarjes së reklamave shtetërore

Monitorimi i volumit të reklamave kryhet nga autoriteti i medias audiovizive dhe publikohet në faqen e internetit të institucionit si pjesë e procesit të matjes së përgjithshëm të volumit të reklamave. Autoriteti ka definuar termin "reklamimi institucional", i cili, gjatë periudhave zgjedhore, zbatohet sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor. Transparenca e shpërndarjes së reklamave shtetërore nuk përfshihet në procesin e matjes së volumit të reklamave të kryer nga AMA. Që nga viti 2022, AMA monitoron volumet e reklamave, duke përfshirë reklamimin institucional, si një tregues i transparencës së procesit të monitorimit të volumit të reklamave tek subjektet audiovizive. Në faqen e AMA - s, matja e volumit të reklamave është gjithashtu e aksesueshme dhe e publikuar. AMA monitoron dhe publikon informacion periodik, në baza mujore, mbi volumin e reklamave të transmetuara nga transmetuesit kombëtarë. Në baza vjetore për vitin në raportim, të dhënët e reklamave institucionale kanë qenë nga 0,08% në 2,21% për subjektet private dhe nga 0,003 % deri në 10.95% për transmetuesin publik.





4. TË DHËNA LIDHUR ME AKTIVITETIN E AUTORITETIT PËR KRYERJE INSPEKTIMESH OSE HETIMESH ADMINISTRATIVE, VENDIME TË SANKSIONEVE ME GJOBË NË RAPORT ME VITET E FUNDIT

Një ndër detyrat funksionale të AMA - s' është verifikimi i respektimit të kushteve të licencës dhe/ose autorizimit nga subjektet që ushtrojnë veprimtari audio dhe/ose audiovizive në Republikën e Shqipërisë. Mbështetur në nenin 78 të ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar, AMA ka të drejtë të ushtrojë kontroll të veprimtarisë programore, financiare, teknike dhe organizative të mbajtësit të një licence dhe/ose autorizimi. AMA, gjithashtu, ka kompetencë të vendosë sanksione sipas nenit 133, "Gjobat" për subjektet që veprojnë në kundërshtim me dispozitat ligjore. Sanksionet me gjobë mund të vendosen nga inspektorët ose nga vetë AMA me nismën e tyre ose pas ankimit të subjekteve të interesuara.

Lidhur me respektimin e të drejtave të transmetimit, Autoriteti, gjatë vitit 2024 ka kryer një numër të konsiderueshëm inspektimesh të subjekteve kabllore/IPTV/OTT në terren. Viti 2024, solli të reja në mënyrën e kryerjes së kontolleve për shkeljen e të drejtave të transmetimit, ku specialistë pranë kësaj drejtorie kanë kryer dhe monitorimin e rrjeteve online pranë zyrave të institucionit, duke identifikuar një sërë rastesh të shitjeve të produkteve audiovizive online në mënyre abuzive. Pas identifikimit të këtyre shkelësve, AMA, me prova zyrtare i ka raportuar ato pranë instancave të tjera ligjzbatusese, si policia e shtetit. Pas një pune të shkëlqyer nga institucioni i policisë, kjo ndodhur dhe nga fakti i provave të vendosura në dispozicion nga AMA, nga ana e policisë së shtetit në muajin dhjetor 2024, u krye një operacion me kapjen e një sërë autorësh, të cilët tregtonin dhe prodhonin produkte audiovizive në kundërshtim me ligjin.

Gjithashtu, një fokus të veçantë ka pasur inspektimi dhe monitorimi i subjekteve audiovizive në lidhje me cilësinë e sinjalit, si dhe kontentin e përbajtjes së programeve. Shërbimi duhet të jetë i shpejtë, pa ndërprerje, si dhe me cilësi digitale në mënyrë që qytetarët të marrin një shërbim cilësor të transmetimeve audiovizive.

Inspektimet janë kryer në bazë të ankesave të depozituara nga subjektet mbajtës të së drejtës, por dhe kryesisht nga AMA. Të gjitha ankesat/kërkesat e operatorëve për ndërhyrje mbi mosrespektimin e të drejtës së transmetimit nga subjektet kabllore/IPTV/OTT, autoriteti i ka realizuar duke iu dhënë përgjigje të gjithë subjekteve ankuese, si dhe duke marrë masat përkatëse në rast shkeljesh.

Sa i përket subjekteve të autorizuara nga AMA për ritransmetimin e produktit audioviziv, Drejtoria e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, ka kryer inspektimet me rigorozitet dhe paanësi, duke marrë masat e duhura në rast shkelje të ligjit 97/2013, të ndryshuar.

Vlen të theksohet se, pjesa dërrmuese e ankesave për shkeljen e të drejtave të transmetimit, gjatë vitit 2024, lidhet me fenomenin e piraterisë televizive që kryhet nga subjekte të paautorizuara nga AMA për ofrimin e shërbimit audioviziv. Konkretnisht, bëhet fjalë për subjekte ISP (Internet Service Provider), të cilët nëpërmjet internetit kryejnë pirateri televizive pa autorizim nga AMA.

AMA në bashkëpunim dhe me institucionin e AKEP, mori masa për mbylljen e më shumë se 20 serverave që transmeton kontent audioviziv pa të drejta si dhe bëri të mundur sanksionimin e 3 subjekteve ISP që operonin në kundërshtim me ligjin 97/2013, të ndryshuar duke i gjabitur ato me nga 5,000,000 lekë secilin.

Sqarojmë se, fenomeni i piraterisë televizive që kryhet nëpërmjet internetit, është një fenomen sa shqetësues aq dhe i komplikuar për t'u identifikuar, për arsyen se në shumicën e rasteve produkti audioviziv që transmetohet abuzivisht, vjen nga servera të vendeve të ndryshme të botës por dhe nga servera që operojnë në territorin e Shqipërisë. Sa i përket serverave që u konstatuan në vendin tonë, siç u citua dhe më lart ,u mbyllen 20 të tillë.

Gjithashtu, AMA, për vitin 2024 AMA, përçollti pranë AKEP - it 37 praktika zyrtare, me qëllim marrjen e masave, për mbylljen e 346 faqeve online, të cilat kryenin shkelje të ligjit 97/2013, të ndryshuar. Gjithashtu, lidhur me këtë fenomen, Drejtoria e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes u kërkoi Video Sharing Platforms (VSP-ve) të ndryshme, heqjen nga llogaritë e tyre të 1,539 link - eve, të cilët transmetonin produkt audioviziv pa të drejta transmetimi.

Nga këto, falë dhe bashkëpunimit me platformën TikTok, për vitin 2024 janë shënuar: 1,513 video të raportuara për pirateri nga të cilat 1,505 janë hequr nga platforma dhe 193 profile të mbyllura pasi janë raportuar për përbajtje të piratuara.

Cdo ankesë e mbërritur nga qytetarët, u shqyrtua me përgjegjësi nga grupi i punës, përgjegjës për bashkëpunimin me platformën TikTok, duke u analizuar konform dispozitave ligjore çdo denoncim i ardhur.

Në vijim, informacioni në formë krahasuese për periudhën 2021 - 2024:

SUBJEKTI	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
DigitAlb	48	175	83	11
Tring	4	4	49	24

Në lidhje me veprimtarinë inspektuese, Drejtoria e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes në AMA, gjatë vitit 2024, përmes grupeve të veta të inspektimit, ushroi 393 kontolle të aktivitetit të OSHMA - ve. Nga këto, 220 janë inspekte të kryera në bazë të ankesave dhe 173 janë monitorime kryesish.



Në përfundim të kontolleve dhe shqyrtimit të procedurave përkatëse administrative, janë marrë masat si më poshtë:

Njëmbëdhjetë (11) vendime për sanksione me gjobë ndaj subjekteve OSHMA, që janë konstatuar në shkelje të ligjit nr.97/2013, të ndryshuar, prej të cilave:

- 3 (tre) sanksione me gjobë me vlerë 1,000,000 lekë ndaj subjekteve përsëritës të shërbimit të tretëve për mosrespektim të të drejtave të transmetimit;
- 2 (dy) sanksione gjobë për moslejim kontrolli nga subjektet e autorizuara nga AMA, me vlera 120,000 dhe 200,000 mijë lekë;
- 3 (tre) sanksione gjobë me vlerë 5,000,000 lekë, ndaj subjekteve ISP (internet service provider) të paautorizuar nga AMA. Subjekte të cilët transmetonin produkt audioviziv në mënyrë pirate;
- 3 (tre) sanksione gjobë me vlerë nga 40,000 mijë lekë janë vendosur ndaj subjekteve OSHMA për mos dorëzim të përbajtjeve audiovizive;
- Për 9 (nëntë) raste të tjera është vendosur têrheqja e vëmendjes ndaj subjekteve OSHMA.

VITI	INSPEKTIMET	GJOBA TOTAL	TÊRHEQJE VËMENDJE	SEKUESTRIME
2021	118	13	12	3
2022	249	15 (1)	20	-
2023	332	9 (2)	3	3
2024	393	11 (1)	9	5

Për sa i përket veprimtarisë monitoruese, Drejtoria e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, gjatë vitit 2024, në fokus të veçantë ka pasur dhe monitorimi për respektimin e të drejtës së transmetimit për filmat artistikë dhe eventet sportive, në platforma/programe të ndryshme me pagesë. Për vitin 2024 janë kryer 1,168 orë monitorime për të drejtat e transmetimit për filmat artistikë dhe ato sportive.

Në fillim të vitit 2024, detyrimet e prapambetura të Operatorëve të Shërbimeve Mediatike Audiovizive (OSHMA) arritën në 317,248 mijë lekë. Kjo tregon një vazhdimësi të borxhit të akumuluar nga subjektet për shkeljet e mëparshme dhe një sfidë për institucionin në arkëtimin e këtyre detyrimeve.

Vendime për dënimë me gjobë gjatë vitit 2024:

Gjatë vitit 2024, AMA vendosi dënimë administrative ndaj operatorëve me një vlerë totale prej 19,721 mijë lekë. Kjo pasqyron përpjekjet e institucionit për të siguruar zbatimin e rregulloreve dhe ndëshkimin e subjekteve që nuk i respektojnë normat ligjore.

Detyrime të shlyera nga gjobat dhe kamatëvonesat 2024:

Gjatë vitit 2024, operatorët kanë shlyer një shumë prej 1,771 mijë lekë, duke kontribuar në uljen e borxhit të përgjithshëm. Megjithatë, krahasuar me gjobat e vendosura, kjo shumë mbetet e ulët dhe ka nevojë përmirësim të mbledhjes së detyrimeve për gjoba.

Gjoba të shfuqizuara apo të reduktuara 2024:

Një shumë prej 1,200 mijë lekë nga gjobat e vendosura është shfuqizuar ose reduktuar nga vendimet gjyqësore ose të Bordit te AMA - s. Kjo ka ardhur si pasojë e ankimeve të OSHMA – ve.

Ecuria e ekzekutimit të tituve ekzekutivë, për sanksione me gjobë, gjatë viteve 2018 - 2023, për arkëtimet e kryera dhe sa nga këo i takojnë institucionit, paraqitet si më poshtë:

TITUJT EKZEKUTIVË ME SANKSION GJOBË/VITET ARKETUAR	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
ARKËTIMET NË TOTAL (100%)	12,977	8,832	2,008	2,553	5,951	5,478	1,771
TË ARDHURA PËR AMA - N NGA GJOBAT (20%)	2,595	1,766	402	511	1,190	1,095	354

Detyrimi total në fund të vitit 2024:

Pas llogaritjes së të gjithë komponentëve – detyrimeve të prapambetura, gjobave të reja, pagesave të kryera dhe gjobave të shfuqizuara – detyrimi i përgjithshëm i mbetur në fund të vitit 2024 arrin në vlerën 333,998 mijë lekë. Kjo përbën një rritje në krahasim me fillimin e vitit, duke treguar se detyrimet e reja kanë tejkaluar shlyerjet dhe reduktimet e vendimeve të gjobave.

Gjatë vitit 2024 janë kthyer shuma 3,000 mijë lekë për dy gjoba, të cilat janë vendosur dhe janë paguar në vitet e mëparshme për shoqërime Tring sh.a., por për këtë janë pakësuar me 80% detyrimet ndaj shtetit për gjoba dhe për 20% të shumës të ardhurat e institucionit.



5. QEVERISJA E AUTORITETIT

5.1 Vendimarrja mbi licencat/autorizimet

Përgjatë vitit 2024 në zbatim të detyrave funksionale, duke u ndalur kryesisht në procesin e zbatimit me efektshmëri dhe në përputhje me kuadrin ligjor i cili rregullon veprimtarinë administrative në kuadër të ndjekjes së procedurave për licencimin/autorizimin, rinnovim licence/autorizimi, miratimin e ndryshimeve në kushtet e licencës dhe/ose autorizimit, zgjerim zone etj., si dhe ndjekjen e procedurës së hetimit administrativ ndaj OSHMA-ve të cilat në mosrespektim të detyrimeve finaciare dhe jo vetëm shkelin detyrimet ligjore që burojnë nga marëdhënia administrative me AMA-n, janë ndërmarrë të gjithë hapat proceduriale për nisjen dhe ndjekjen e vijueshmërisë administrative për rastet objekt trajtimi.

Bordi i AMA-s, që prej muajit shkurt 2022, e ka ushtruar veprimtarinë administrative me trupë të plotë, kolegjal, të përbërë prej 7 anëtarësh, duke bërë të mundur miratimin e të gjithë vendimmarrjeve që kërkojnë shumicë të cilësuar, si dhe shumicë të thjeshtë. Përveç kryerjes së funksioneve në cilësinë e organit kolegjal, gjatë periudhës reportuese, vend të rëndësishëm kanë edhe aspekte të tjera të veprimtarisë administrative të AMA-s, si përfaqësimi i institucionit në proceset gjyqësore ku AMA është palë, kryerja e kontrolleve dhe inspektive të ndryshme ndaj subjekteve, që ushtrojnë veprimit audiovizive, bashkëpunimi dhe këshillimi me organe të tjera shtetërore.

Referenca parësore ligjore, mbi të cilën e AMA e mbështet veprimtarinë e vet administrative dhe rregulatorë, mbetet ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Gjithashtu, veprimitaria e AMA-s ushtrohet në përputhje me Kushtetutën, ligjet dhe aktet nënligjore, që rregullojnë fushën e medias audio dhe audiovizive. Legislacioni dytësor (rregullore, vendime dhe udhëzime) i miratuar në bazë dhe zbatim të ligjit të posaçëm organik, luan një rol të rëndësishëm në realizimin e misionit dhe funksionit të Autoritetit.

Në cilësinë e autoritetit rregulator për shërbimet audio dhe audiovizive, dhe në zbatim të ligjit organik Autoriteti i Mediave Audiovizive, edhe gjatë vitit 2024, ka punuar për hartimin apo ndryshimin e akteve nënligjore, me qëllim përmirësimin e aktivitetit të institucionit dhe lehtësimit të veprimtarisë së operatorëve audio/audiovizivë.

Në zbatim të nenit 60 të ligjit organik, AMA, me nismën e vet, ose me kërkesën e subjekteve të interesuara, ka çelur disa gara për dhënien e licencës së shërbimit të programit audio analog, duke marrë në konsideratë ekzistencën e kapaciteteve të lira teknike në rrjetet numerike të operatorit publik dhe operatorëve privatë lokalë të transmetimit.

Konkrektisht, në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Rregullores “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audio analoge”, miratuar me vendimin nr. 7, datë 21.02.2023 të AMA-s, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) ka shpallur 5 gara audio analoge në përfundim të procedurave AMA ka proceduar me 3 vendime për dhënien licence transmetimi audio analoge dhe 2 vendime pa fitues. Dhënia në përdorim e frekuencave nga AMA bëhet në përputhje me përcaktimet e Planit Kombëtar të Frekuencave, Planin e Përdorimit të Frekuencave, duke pasur parasysh parimet e mosdiskriminimit, transparencës dhe objektivitetit. Për dhënien në përdorim të frekuencave si pasuri kombëtare e fundme përdoret procedura e hapur në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.



Sa i përket aplikimeve për marrje autorizimi, aplikime të cilat shqyrtohen mbi bazë kërkese të subjekteve të interesuar për vitin 2024 kanë shfaqur interes 10 subjekte. AMA në përfundim ka miratuar dhënien e autorizimit për një periudhë 5 vjeçare për ofrimin dhe përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve, mbështetur në rrjet kabllor për subjektet kërkues.

Për aplikimet për licencë/autorizim, gjatë vitit 2024, AMA ka vendosur:

- Dhënien e autorizimit për 10 subjekte (përsëritës/ ofrues në rrjete kabllorë/ internet IPTV dhe OTT);
- Rinovimin e autorizimit për 17 subjekte (përsëritës/ ofrues në rrjete kabllorë/ internet IPTV dhe OTT);
- Rinovimin e licencës për 15 subjekte audio analoge;
- Heqje /Konstatim pavlefshmërie së licencës/autorizimit për transmetime audioviziv për 5 subjekte (përsëritës/ ofrues në rrjete kabllorë/ internet IPTV dhe OTT).

APLIKIME		
NR.	LICENCË/AUTORIZIM	SUJEKTI
10	Dhënie autorizimi	Përsëritës/ Ofrues në rrjete kabllorë/ Internet IPTV dhe OTT
17	Rinovime autorizimi	Përsëritës/ Ofrues në rrjete kabllorë/ Internet IPTV dhe OTT
15	Rinovime licence	Audio Analog
5	Heqje /Konstatim pavlefshmërie	Përsëritës/ Ofrues në rrjete kabllorë/ Internet IPTV dhe OTT

Po gjatë këtij viti, 2 subjekte ekzistues të autorizuar për përsëritjen e shërbimit audioviziv të të tretëve, mbështetur në rrjet kabllor, kanë këruar zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit, si dhe 3 subjekte ekzistues të autorizuar për përsëritjen e shërbimit audioviziv të të tretëve, mbështetur në rrjet kabllor, kanë këruar reduktimin e zonës së ofrimit të shërbimit.



Vlen për tu theksuar që në çdo rast AMA, ka respektuar fryshtat e ligjit duke mos anashkaluar në asnjë rast shkeljen e parashikimeve ligjore dhe njëherazi duke paralajmëruar se për çdo kundërvajtje administrative ligji parashikon ndëshkimin me gjobë, ashtu sikurse dhe vendimarrjen me heqje licence dhe/ose autorizim. Në kuadër të ndjekjes së planit të licencimit dhe njëherazi të dhënies së autorizimit për shfrytëzimin e çdo kapaciteti audioviziv për informimin e publikut, është ndjekur me koherencë dhe transparencë të plotë procesi i vendimarrjeve ndaj aplikimeve, si dhe komunikimeve të vazhdueshme zyrtare për vijmësinë e gjëzimit të këtyre të drejtave që tashmë mbajtësit kanë.

Ndryshimet në pronësi

Në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, subjektet e licencuara/autorizuara kanë detyrimin që brenda 30 ditëve të njoftojnë AMA-n lidhur me ndryshimet e ndodhura në kërkesën për licencë dhe/ose autorizim, për kalim të drejtash apo për ndryshime në strukturën e pronësisë, brenda të njëjtë subjekt tregtar. Ndërsa kushtet e licencës/autorizimit të subjekteve OSHMA është dhe detyrimi për të njoftuar AMA-n për ndryshime në të dhënat e licencës dhe autorizimit.

Në vitin 2024, janë sanksionuar 2 subjekte për ndryshimet e ndodhura në strukturën e pronësisë, si dhe për mosnjoftimin e ndryshimit të të dhënavë të shoqërisë. Në mbështetje të parashikimeve të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, subjektet kanë detyrimin ligjor të njoftojnë për ndryshimet e ndodhura në të dhënat e paraqitura në kërkesën për marrje autorizimi, brenda afatit prej 30 ditësh nga data e kryerjes së ndryshimeve, si dhe të kërkojnë miratimin nga AMA.

Për aplikimet për miratim të ndryshimeve në strukturën gjatë vitit 2024, AMA ka vendosur:

APLIKIME 2024	
RASTE	MIRATIME TË NDRYSHIMEVE NË STRUKTURËN PRONËSORE TË SHOQËRISË
15	Miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën pronësore të shoqërisë, të trajtuar në çdo rast për licencë/autorizim
4	Miratimin e ndryshimeve të ndodhura për ndryshimin e emrit të shoqërisë/subjektit OSHMA, janë materializuar me vendimarrje
1	Miratimin e ndryshimeve të ndodhura të kushteve teknike në licencë audio, materializuar me vendimarrje

5.2 Ecuria e proceseve gjyqësore

Investimi i pushtetit gjyqësor është një instrument i së drejtës, që e ka bërë AMA - n palë, në procese të ndryshme gjyqësore, me palët e prekura nga aktet administrative si vendimarrjet e Autoritetit.

Ligjshmëria dhe themeltesia e akteve administrative, që janë objekt shqyrtimi gjyqësor, lidhen me dënimet administrative ndaj subjekteve audio dhe/ose audiovizive, vendimet për heqjen/pavlefshmërinë e licencës etj. Në mungesë të shlyerjes vullnetare të detyrimeve financiare nga ana e OSHMA - ve, AMA, si person juridik publik, ka investuar organet gjyqësore, duke kërkuar prej subjekteve audio/audiovizive debitorë të shlyejnë detyrimet financiare ndaj AMA - s ose Buxhetit të Shtetit. Në raste të tjera, AMA i është drejtuar gjykatave kompetente edhe në cilësinë e palës kërkuese, sikurse është edhe rasti i paraqitjes së kërkesave për lëshimin e urdhreve të ekzekutimit.

AMA, gjatë vitit 2024, është përfshirë në 27 procese gjyqësore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, nga të cilat:

a) 5 procese gjyqësore në cilësinë e palës paditëse:

- Fituar - 2;
- Humbur - 0;
- Kthim aktesh - 0;
- Në proces - 3;

b) 21 procese gjyqësore në cilësinë e palës së paditur:

- Fituar - 6;
- Humbur - 5;
- Në proces - 9;
- Pushuar gjykimi - 1.

c) 1 proces gjyqësor në cilësinë e palës së tretë:

- Në proces -1.

Ndaj proceseve gjyqësore të cilat rezultojnë të humbura në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, është ushtruar ankim në Gjykatën Administrative të Apelit dhe janë çështje në proces gjyqësor.

Në vijim bëmë me dije se, gjatë vitit 2024 janë administruar pranë AMA – s, 11 vendime të Gjykatës Administrative të Apelit, konkretisht:

- Fituar – 8, nga të cilat:

7 vendime të formës së prerë, përvendime me sanksion dhe;

- 1 vendim me objekt pavlefshmërinë e aktit administrativ (Tatime).

- Humbur 3, nga të cilat:

- 1 përmarrëdhënie pune;
- 1 përvendim me sanksion (gjobë);
- 1 me objekt detyrime financiare (pushuar).

AMA ka ndjekur në vijimësi e ecurinë e çështjeve gjyqësore, të cilat janë në proces gjykimi në Gjykatën Administrative të Apelit dhe në Gjykatën e Lartë, çështje këto të mbartura nga vitet paraardhëse. Edhe gjatë periudhës raportuese, ekzekutimi i vendimeve të AMA - s të shndërruara në tituj ekzekutivë, në zbatim të nenit 132 të ligjit organik, ka vijuar të kryhet përmes shërbimit privat përmbarimor. Për vitin 2024, AMA ka lidhur kontrata shërbimi për ekzekutimin e 19 titujve ekzekutivë, ndërkojë që gjatë kësaj periudhe kanë vijuar edhe procedurat për ekzekutimin e titujve në zbatim të kontratave të lidhura në vitet e kaluara.

Gjatë vitit 2024, 20 subjekte debitorë kanë shlyer detyrimet përvendime me gjobë.

Me 8 subjekte OSHMA, AMA ka nënshkruar marrëveshje përvendjen me këste të detyrimeve financiare.

Në mënyrë të detajuar, pasqyrimi i çështjeve gjyqësore në gjykim, në tri shkallët e gjyqësorit, jepet në Aneksin nr. 1, bashkëlidhur.





6. AUTORITETI SI RREGULLATOR PËR NJË TREG AUDIOVIZIV TË PËRGJEGJSHËM

6.1 Shqyrtimi tematik i përmbajtjeve të emetuara

Përputhshmëria ligjore e përmbajtjeve audio/audiovizive të transmetuara është një angazhim i përditshëm për AMA - n, duke pasur gjithmonë si referencë ligjin 97/2013, i ndryshuar, por dhe akte të ndryshme nënligjore të miratuara nga Autoriteti. Shqyrtimi tematik përfshin çdo lloj formati OSHMA - je:

- me licencë kombëtare apo lokale/rajonale;
- me program gjeneralist apo tematik.

Gjatë vitit që raportohet AMA ka shqyrtuar kryesisht (ex officio) 241 raste për përputhjen ligjore të përmbajtjeve të transmetuara. Këto shqyrtimë kanë qenë të planifikuara me bazë vjetore, por dhe bazuar në të dhëna nga përditshmëria e transmetimeve, nga ndjeshmëritë që mund të krijojnë në publik përmbajtje të caktuara, nga sinjalizime të ndryshme që mbërijnë në institucion etj.

Gjatë vitit 2024 shqyrtimet tematike u fokusuan në aspekte të tillë si:

- a. mbrojtja e fëmijëve nga përmbajtjet e papërshtatshme;
- b. gjuha e urrejtjes dhe diskriminimi;
- c. barazia gjinore;
- d. shkeljet etike në përgjithësi;
- e. reklamat dhe komunikimet tregtare;
- f. përdorimi i gjuhës shqipe standarde të shkruar dhe të folur;
- g. respektimi i sinjalistikës paralajmëruuese në fasha kohore të caktuara;
- h. tërcësia programore të platformës së RTSH - së, në zbatim të kërkesave të Kontratës së Shërbimit, etj..

Nga 241 rastet e shqyrtuara, 77 prej tyre kanë rezultuar që nuk kanë qenë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Pas analizimit të detajizuar të këtyre shkeljeve, në 15 raste AMA ka adresuar "sanksion me gjobë", pasi ishin ose përsërtije e mosplotësimit të kërkesave ligjore, ose kur bëhej fjalë për shkelje të rënda etike. Kurse në 62 raste AMA ka dhënë "tërheqje vëmendjeje". për OSHMA - të dhe në 15 raste "sanksion me gjobë".

Nisur nga këto të dhëna konkrete evidentohet se ka një rritje të dukshme të sasisë së shqyrtimeve. Kjo duket më qartë dhe në krahasimin e shifrave me tre vitet e mëhershme, sipas tabelës së mëposhtme.

	Gjatë vitit 2021	Gjatë vitit 2022	Gjatë vitit 2023	Gjatë vitit 2024
Shqyrtimë tematike	67	96	114	241
Tërheqje vëmendje OSHMA-ve	24	38	49	62
Gjobë	-	-	1	15

Duke analizuar shifrat e vitit 2024, vihet re se pjesa më e madhe e shkeljeve lidhej me mbrojtjen e fëmijëve nga përbajtje të papërshtatshme (44%), shpjeguar në mënyrë të hollësishme në pjesën e mësipërme të plotësimit të rekomandimeve të Kuvendit të Shqipërisë nga AMA. Shkelje evidente gjatë periudhës që raportohet është mosrespektimi i programacionit, bazuar në kushtet e licencës nga subjekte audio (23%), si dhe përdorim gjuhe urrejtjeje dhe diskriminimi (21%). Problematikat me reklamat dhe komunikimet tregtare (12%) janë më të pakta krahasuar me vitet e fundit.

Tipologja e shkeljeve të vitit 2024

Tipologja	Numër	Përqindje
Mbrojtja e fëmijëve nga përbajtjet e papërshtatshme	34 raste	44%
Mosrespektimi i programacionit, bazuar në kushtet e licencës/autorizimit	18 raste	23%
Përdorim gjuhe urrejtjeje dhe diskriminimi	16 raste	21%
Problematika me reklamat e transmetuara	9 raste	12%
Total	77 raste	100%

Tërheqjet e vëmendjes dhe sanksionet me gjobë nga shqyrtimet tematike në vitin 2024

NR.	KATEGORIA E SHKELJES	OSHMA	EMISIONI/RUBRIKA	SANKSIONI
1	Sugjerime për përmirësimin e buketës programore (Përputhshmëria me Kontratën e Shërbimit të Transmetimit Publik)	TV Kombëtar	Tërësia programore	Tërheqje vëmendje
2	Shkelje etike, mbrojtja e të miturve (Nuk janë respektuar kërkesat e Kodit të Transmetimit, pika 4.64)	TV Kombëtar	Program argëtues	Tërheqje vëmendje
3	Shkelje etike, përdorim fjalori fyes dhe denigrues (Nuk janë respektuar kërkesat e Kodit të Transmetimit, pika 1.6)	TV Kombëtar	Edukativ	Tërheqje vëmendje
4	Shkelje etike, mbrojtja e të miturve, publikim i gjeneraliteteve të fëmijës (Nuk janë respektuar kërkesat e Kodit të Transmetimit, pika 4.24)	TV Kombëtar	Investigativ dhe argëtues	Tërheqje vëmendje
5	Shkelje etike, përdorim fjalori fyes dhe denigrues, veprime të papërshtatshme (Nuk janë respektuar kërkesat e ligjit 97/2013, neni 4 dhe neni 32)	TV Rajonal	Debatues	Tërheqje vëmendje
6	Reklamë e fshehtë (Nuk janë respektuar kërkesat e nenit 42 të ligjit 97/2013)	TV Kombëtar	Debatues	Tërheqje vëmendje



7	Shkelje etike, mbrojtja e të miturve (Nuk janë respektuar kërkesat e nenit 32/1 të ligjit 97/2013)	TV Rajonal	Investigativ	Térheqje vëmendje
8	Shkelje etike, fjalor dhe sjellje të papërshtatshme (Nuk janë respektuar kërkesat e nenit 4 dhe 33/1 të ligjit 97/2013)	TV Kombëtar	Argëtues	Sanksion me gjobë
9	Reklamë e fshehtë (Nuk janë respektuar kërkesat e nenit 42 të ligjit 97/2013)	TV Kombëtar	Edicion lajmesh	Térheqje vëmendje
10	Shkelje etike, mbrojtja e të miturve (Nuk janë respektuar kërkesat e Kodit të Transmetimit, pika 4.28 dhe 4.63)	TV Kombëtar	Argëtues	Térheqje vëmendje
11	Përbajtje të papërshtatshme (Nuk janë respektuar kërkesat e nenit 4 dhe 33 të ligjit 97/2013)	TV Kombëtar	Debatues	Térheqje vëmendje
12	Transmetim pamjesh të rënda (Nuk janë respektuar kërkesat e nenit 4 dhe 33 të ligjit 97/2013)	TV Kombëtar	Edicion lajmesh	Sanksion me gjobë
13	Shkelje etike, përdorim fjalori fyes dhe denigrues (Nuk janë respektuar kërkesat e Kodit të Transmetimit, pika 1.6 dhe 7.10)	TV Kombëtar	Argëtues	Térheqje vëmendje
14	Mosrespektimi i kohës për transmetimin e reklamave dhe komunikimeve tregtare për pijet alkoolike (Nuk janë respektuar kërkesat e ligjit 97/2013, nenit 42, pika 5; si dhe Kodit të Transmetimit, pika 4.43, 4.28 dhe 4.63)	TV Kombëtar	Edicion lajmesh	Térheqje vëmendje
15	Përbajtje të papërshtatshme (Nuk janë respektuar kërkesat e ligjit 97/2013, nenit 33, pika 5, si dhe Kodit të Transmetimit, seksioni 7)	TV Kombëtar	Argëtues	Térheqje vëmendje
16	Përbajtje të papërshtatshme (Nuk janë respektuar kërkesat e ligjit 97/2013, nenit 4, pika 2, si dhe Kodit të Transmetimit, pika 3.1)	TV Rajonal	Debatues	Térheqje vëmendje
17	Përbajtje të papërshtatshme (Nuk janë respektuar kërkesat e ligjit 97/2013, nenit 4, pika 1, si dhe Kodit të Transmetimit, pika 1.6)	TV Kombëtar	Debatues	Térheqje vëmendje
18	Përbajtje të papërshtatshme (Nuk janë respektuar kërkesat e ligjit 97/2013, nenit 33, pika 1/d, si dhe Kodit të Transmetimit, pika 1.6)	TV Kombëtar	Argëtues	Térheqje vëmendje
19	Përbajtje të papërshtatshme (Nuk janë respektuar kërkesat e ligjit 97/2013, nenit 4 dhe 32, si dhe Kodit të Transmetimit, pika 1.5 dhe 1.12)	TV Rajonal	Debatues	Sanksion me gjobë



20	Transmetim reklame politike (Mosrespektim i nenit 41, pika 2, në ligjin 97/2013)	TV Rajonal	Blloku i reklamave	Térheqje vëmendje
21	Përbajtje të papërshtatshme (Nuk janë respektuar kërkesat e ligjit 97/2013, neni 4, pika 1, gërmë "b" dhe neni 33, pika 1/"d")	TV Rajonal	Argëtues	Térheqje vëmendje
22	Përbajtje të papërshtatshme (Nuk janë respektuar kërkesat e Kodi të Transmetimit, pika 4.64)	TV Rajonal	Argëtues	Térheqje vëmendje
23	Sugjerime për përmirësimin e buketës programore (Përputhshmëria me Kontratën e Shërbimit të Transmetimit Publik)	TV Kombëtar	Térësia programore	Térheqje vëmendje
Me hyrjen në fuqi të ndryshimeve të fundit të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar më 25 maj 2023, ndryshime këto të cilat u kryen me qëllim përafrimin e lartë me Direktivën e BE - së 2018/1808, janë përcaktuar kritere të reja lidhur me informacionin që duhet të administrojë Autoriteti i Mediave Audiovizive, sa i takon strukturës pronësore të OSHMA - ve dhe kërkesës të transparencës së pronësisë së deklaruar në institucion prej këtyre subjekteve. Konkretilisht, nen 32, pika 1/1 e ligjit parashikon se: “..1/1. Ofrohet e shërbimeve mediatike audiovizive bëjnë publik informacionin në lidhje me strukturën e tyre të pronësisë, duke përfshirë edhe pronarët përfitues, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.”

Këto detyrime të reja ligjore që burojnë ndaj institucionit, kombinuar së bashku me ardhjen në rritje të kërkesave nga ana e BE - së përmirësim të kuadrit rregulator kombëtar për publikimin e informacionit të pronësisë së sektorit të medias audio/audiovizive, sjell si domosdoshmëri krijimin e një mekanizmi monitorues prej AMA - s.

Në këtë kuadër rregullorja e cila ka hyrë në fuqi dhe zbatohet në mënyrë rigorozë nga strukturat e AMA, ka risi për sa i përket:

- Shqyrtimit nga AMA të ndryshimeve të ndodhura në strukturën pronësore brenda të njëjtit person juridik OSHMA, mbajtës i licencës ose i autorizimit nga AMA, të cilat nuk passjellin cedimin ose kalimin e të drejtave që burojnë nga licenca ose autorizimi;
- Shqyrtimin e ndryshimeve në strukturën pronësore mes personave juridikë privat OSHMA, në rastet e hyrjes në marrëdhënie juridike civile të cilat passjellin cedimin ose kalimin e të drejtave që burojnë nga licenca ose autorizimi;
- Deklarimin e informacionit mbi përbërjen e strukturës së pronësisë së personit juridik OSHMA, mbajtës i licencës ose i autorizimit nga AMA, duke përfshirë pronarin përfitues;
- Transparencë e shtuar mbi origjinën e burimeve të financimit për kryerjen e transaksioneve tregtare të kapitalit të shoqërisë mediatike prej ortakut/aksiionerit;
- Deklarim të çdo lloj konflikti/interesi të mundshëm që ndikon në veprimtarinë e OSHMA - së prej pronarëve;
- Deklarim mbi të ardhura nga reklama, donacione, sponsorizimeve etj., të pronarit përfitues nga persona juridikë publik, kryer me qëllim promovimi mediistik.

Aktualisht, përtej rregullimit ligjor, Autoriteti i Mediave Audiovizive ka përgatitur dhe paraqitur grafikisht në faqen e tij në internet deklaratën dhe transparencën e strukturës së pronësisë së shoqërive/individëve të pajisur me licencë/autorizim nga AMA dhe deklaratën e pronarit përfitues të këtyre subjekteve që ushtrojnë aktivitetet audio dhe audioviziv në Republikën e Shqipërisë, duke përmbrushur në këtë mënyrë një prej detyrimeve kryesore të procesit të integrimit <https://ama.gov.al/baza-e-te-dhenave-struktura-pronesore-e-oshma/>.



Baza e të dhënavët në grafik, tashmë i publikuar në faqen zyrtare (web) të AMA - së është një model i përgjedhur mes Rregullatorëve Evropian dhe konkretisht atij Portugez në kuadër dhe të bashkëpunimit të vendosur tashmë midis dy autoriteve tonë për shkëmbimin e praktikave më të mira intitucionale dhe politikbërjes lidhur me transparencën e pronësisë së subjekteve të licencuar dhe/ose autorizuar për shërbimet audiovizive.

- Rregullore "Për kërkasat e posaçme që ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove duhet të përbushin për krijimin e ofrimin e sistemeve transparente, efektive e miqësore në përdorim"

Në kuadër të zbatimit të detyrimeve periodike të përafrimit të legjislacionit të brendshëm me Acquis e BE - së në fushën e medias audiovizive, në vijim të detyrimeve të ndërmarrta nga Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në kuadër të hartimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2024 – 2026, miratoi me vendimin nr. 128, datë 23.12.2024), Rregulloren "Për kërkasat e posaçme që ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove duhet të përbushin për krijimin e ofrimin e sistemeve transparente, efektive e miqësore në përdorim", si një akt nënligjor që trajton në mënyrë të posaçme rregullimin ligor mbi platformat e shpërndarjes së videove.

Kjo rregullore synon gjithashtu të rregullojë kushtet e përgjithshme të ofrimit të përbajtjeve audiovizive nga përdoruesit në platformat për shpërndarjen e videove dhe nuk prek shërbimet mbështetëse të transmetimeve audiovizive, me qëllim kryesor ofrimin e programeve për informim, argëtim ose edukim.

- Miratimin për disa shtesa dhe ndryshime të "Kodit të Transmetimit", miratuar me Vendim nr. 60, datë 10.07.2023, të AMA - s, përkitazi platformave të shpërndarjes së videove (Vendim nr. 117, datë 11.11.2024)

Transpozimi i Direktivës 2018/1808 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të datës 14 Nëntor 2018 në ligjin 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, me ligjin 30/2023, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 97/2013 ", shtroi domosdoshmërinë e plotësimit të Kodit të Transmetimit me dispozita specifike, që prekin veprimtarinë e Platformave të Shpërndarjes së Videove (PSV).

Kodi i plotësuar i Transmetimit, me ndërhyrjet e propozuara nga Këshilli i Ankesave, ndenji i publikuar në faqen zyrtare të Autoritetit, rubrika "Konsultim publik" në periudhën: 30.09.2024 – 30.11.2024 dhe në përfundim të saj, në përputhje dhe në zbatim të Ligjit 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i kaloi Bordit të AMA -s, i cili e miratoi me Vendimin nr. 128, datë 23.12.2024.

8.3 Nevoja për ndryshime të kuadrit ligor që rregullon veprimtarinë e institucionit

Siqë është raportuar më parë, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) ushtron veprimtarinë e tij sipas ligjit nr. 97/2013, datë 04.03.2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Ky ligj është në përputhje me Direktivën 2010/13/EC për Shërbimet Mediatike Audiovizive dhe rregullon veprimtarinë e mediave audiovizive dhe shërbimet mbështetëse të tyre, mbi bazën e parimit të neutralitetit të teknologjisë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Gjatë periudhës raportuese, AMA ka vijuar plotësimin e kuadrit ligor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore përkatëse që prekin veprimtarinë e mediave audiovizive. Në zbatim të përcaktimëve të legjislacionit organik dhe në kuadër të transparencës institucionale, si dhe nevojës për të kërkuar nga palët e interesuara opiniione, propozime dhe reagime, hartimi i legjislacionit zbatues u shoqërua me një proces konsultimi dhe këshillimi publik midis palëve të interesuara.

Rregullorja e Bashkimit Evropian 2022/2065 përfshin rregulla të zbatueshme për shërbimet ndërmjetëse në

tregun e brendshëm të cilat janë më evidente në rastet e ritransmetimit të paautorizuar të eventeve të drejtëpërdrejta, ku ndeshet më shpesh me rastet e transmetimit të pautorizuar që kryhet nga transmetues që nuk kanë të drejtë apo marrëveshje transmetimi me ata që gjithnjë këtë të drejtë dhe duke u shkaktuar dëmfinanciar këtyre të fundit.

AMA edhe gjatë vitit 2024 ka organizuar tryeza/takime me të gjithë aktorët e interesuar për të marrë mendime, sugjerime dhe komente përkatesisht nga të gjithë palët e interesuara, sidomos OSHMA - të të cilat preken/përfitojnë drejtpërdrejt nga ndryshimet e propozuara në ligj.

Sipas Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës (Rule of Law Roadmap), dokument i politikës shtetërore të Shqipërisë, i miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave në 13.12.2023, për AMA - n eshtë lënë detyrë adresimi i çështjes së përqendrimit të tregut mediatik, rritjes së transparencës, rregullimit të aspekteve të pronësisë së medias dhe shtrirjes së audiencës dhe angazhimi i AMA - s si autoritet rregulator, eshtë asistenza dhe mbështetja e OSHMA - ve në tregun audioviziv shqiptar në sigurimin e një procesi transparent.

AMA po e përbush këtë kriter duke koordinuar takimet, kontribuar në metodologjinë dhe planin për të ngritur dhe zbatuar sistemin që e realizon këtë proces.

Në cilësinë e autoritetit rregulator të pavarur, AMA do të vazhdojë rolin e tij nxitës deri në krijimin e Komitetit të Përbashkët të Industrisë (KPI), si dhe duke dhënë ndihmën përkatëse, sipas nevojës, për metodologjinë që do të zbatohet për matjen e shikueshmërisë, dhe vijimësine e materializimit dhe në Ligj të këtij objktivi.

8.4 Mbikëqyrja e shfrytëzimit të spektrit të frekuencave

Fokusi kryesor, edhe gjatë vitit 2024, sa i takon mbikëqyrjes së shfrytëzimit të spektrit të frekuencave, ka qenë monitorimi në terren lidhur me identifikimin e mbulimit me sinjal numerik audioviziv të territorit të vendit si dhe verifikimi i mbështetjes së operatorëve lokalë/rajonalë në rrjetet kombëtarë numerike.

Nga monitorimet e kryera në të gjitha qarqet e vendit, rezulton se RTSH dhe operatorët privatë kombëtarë numerikë nuk mbulojnë me sinjal numerik zona të caktuara të vendit, si më poshtë:

1. OPERATORI PUBLIK SHQIPTAR, RTSH

QARKU BERAT

- Lagjet pas Kalasë së Beratit
- Njësia administrative Roshnik
- Njësia administrative Sinjë
- Njësia administrative Potom
- Njësia administrative Çepan.

Reth 5% e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim

QARKU KORÇË

- Njësia administrative Voskopojë
- Njësia administrative Dardhë
- Çerravë (qendër)
- Njësia administrative Mokër (pjesërisht)
- Njësia administrative Gorë
- Njësia administrative Barmash.

Reth 6 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.



QARQET TIRANË – DURRËS

- Njësia administrative Shëngjergj
- Njësia administrative Baldushk (pjesërisht)
- Njësia administrative Krujë
- Njësia administrative Cudhi.

Rreth 2 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU ELBASAN

- Njësia administrative Labinot Fushë - Xibrakë
- Njësia administrative Qukës (pjesërisht)
- Njësia administrative Lunik (Kostenjë, Dranovicë, Orenjë, Streblevë).

Rreth 1 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU VLORË

- Njësia administrative Borsh (pjesërisht)
- Njësia administrative Himarë (pjesërisht)
- Fshatrat e lumbit të Vlorës (Drashovicë, Kotë, Brataj, Tërbaç, Velçë, Vranisht, Kuç).

Rreth 3 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU SHKODËR

- Njësia administrative Ana e Malit
- Njësia administrative Vau i Dejës (pjesërisht)
- Njësia administrative Kelmend.

Rreth 4 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU GJIROKASTËR

- Njësia administrative Picar
- Njësia administrative Zagori
- Njësia administrative Kurvelesh
- Njësia administrative Krahës
- Njësia administrative Qesarat
- Njësia administrative Dropull i sipërm
- Njësia administrative Pogon.

Rreth 19 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU DIBËR

- Njësia administrative Maqellarë (pjesërisht)
- Njësia administrative Sllovë, Kala e Dodës
- Qyteti i Bulqizës (pjesërisht)
- Njësia administrative Shupenzë, Zerçan dhe Ostren.

Rreth 6% e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU KUKËS

- Njësia administrative Lekbibaj.

Rreth 2 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

2. SHOQËRIA “MEDIA VIZION”

QARKU BERAT

- Njësia administrative Kuçovë
- Njësia administrative Polican
- Njësia administrative Çorovodë.

Rreth 19% e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU KORÇË

- Njësia administrative Voskopojë
- Njësia administrative Dardhë
- Njësia administrative Çërravë
- Njësia administrative Mokër.

Rreth 4 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU TIRANË

- Njësia administrative Zall Bastar
- Njësia administrative Shëngjergj
- Njësia administrative Baldushk (pjesërisht)
- Njësia administrative Krrabë
- Njësia administrative Ndraq.

Rreth 2 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU DURRËS

- Njësia administrative Krujë
- Njësia administrative Cudhi.

Rreth 4 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU SHKODËR

- Njësia administrative Malësia e Madhe
- Njësia administrative Pukë
- Njësia administrative Vau i Dejës
- Njësia administrative Fushë - Arrëz
- Njësia administrative Ana e Malit.

Rreth 8 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU KUKËS

- Njësia administrative Bajram Curri
- Njësia administrative Has.

Rreth 12 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU DIBËR

- Njësia administrative Peshkopi
- Njësia administrative Bulqizë
- Njësia administrative Klos
- Njësia administrative Maqellarë
- Njësia administrative Burrel.

Rreth 41 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.



QARKU LEZHË

- Njësia administrative Rrëshen.
- Rreth 4 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU ELBASAN

- Njësia administrative Përrenjas
- Njësia administrative Librazhd
- Njësia administrative Qukës
- Njësia administrative Peqin
- Njësia administrative Gramsh.

Rreth 8 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU GJIROKASTËR

- Njësia administrative Tepelenë
- Njësia administrative Përmet
- Njësia administrative Këlcyrrë
- Njësia administrative Krahës
- Njësia administrative Picar
- Njësia administrative Zagori
- Njësia administrative Kurvelesh
- Njësia administrative Qesarat
- Njësia administrative Dropull
- Njësia administrative Pogon.

Rreth 40 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU VLORË

- Njësia administrative Delvinë
 - Njësia administrative Dhërmi
 - Njësia administrative Borsh
 - Njësia administrative Konispol
- Fshatrat e lumit të Vlorës (Drashovicë, Kotë, Brataj, Tërbaç, Velçë, Vranisht, Kuç etj.).
- Rreth 7 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

3. SUBJEKTI TV “KLAN”

QARKU KORÇË

- Njësia administrative Voskopojë
 - Njësia administrative Dardhë
 - Njësia administrative Çërravë
 - Njësia administrative Mokër (pjesërisht).
- Rreth 4 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU TIRANË

- Njësia administrative Zall Bastar
- Njësia administrative Shëngjergj
- Njësia administrative Baldushk (pjesërisht)
- Njësia administrative Krrabë
- Njësia administrative Ndraq.

Rreth 2 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.



QARKU DURRËS

- Njësia administrative Krujë
 - Njësia administrative Cudhi.
- Rreth 4 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU SHKODËR

- Njësia administrative Malësia e Madhe
- Njësia administrative Pukë
- Njësia administrative Fushë – Arrëz
- Njësia administrative Ana e Malit.

Rreth 8 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU GJIROKASTËR

- Njësia administrative Krahës
- Njësia administrative Picar
- Njësia administrative Zagori
- Njësia administrative Kurvelesh
- Njësia administrative Qesarat
- Njësia administrative Dropull
- Njësia administrative Pogon.

Rreth 25 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU VLORË

- Njësia administrative Borsh
- Njësia administrative Konispol
- Fshatrat e lumit të Vlorës (Drashovicë, Kotë, Brataj, Tërbaç, Velçë, Vranisht, Kuç etj.).

Rreth 3 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

4. SUBJETET TV “TOP CHANNEL”, “DIGITALB” DHE “ADTN”

QARKU BERAT

- Njësia administrative Kuçovë
- Njësia administrative Polican (DIGITALB” DHE “ADTN”)
- Njësia administrative Çorovodë.

Rreth 19 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU KORÇË

- Njësia administrative Ersekë
- Njësia administrative Leskovik
- Njësia administrative Voskopojë
- Njësia administrative Dardhë
- Njësia administrative Çërravë
- Njësia administrative Mokër.

Rreth 6 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU FIER

- Pjesërisht Bashkia Divjakë.

Rreth 0.3 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.



QARKU TIRANË

- Bashkia Kavajë
- Njësia administrative Zall Bastar
- Njësia administrative Shëngjergj
- Njësia administrative Baldushk (pjesërisht)
- Njësia administrative Krrabë
- Njësia administrative Ndraq
- Pjesërisht Bashkia Vorë.

Rreth 6 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU DURRËS

- Njësia administrative Krujë
- Njësia administrative Cudhi.

Rreth 4 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU SHKODËR

- Njësia administrative Malësia e Madhe
- Njësia administrative Vau i Dejës
- Njësia administrative Fushë - Arrëz
- Njësia administrative Ana e Malit.

Rreth 8 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU KUKËS

- Njësia administrative Bajram Curri
- Bashkia Kukës
- Njësia administrative Has.

Rreth 75% e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU DIBËR

- Njësia administrative Bulqizë
- Njësia administrative Klos
- Njësia administrative Maqellarë
- Njësia administrative Burrel.

Rreth 41% e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU LEZHË

- Njësia administrative Rrëshen.

Rreth 4 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU ELBASAN

- Njësia administrative Përrenjas
- Njësia administrative Librazhd (“DIGITALB” DHE “ADTN”)
- Njësia administrative Quqës
- Njësia administrative Peqin
- Njësia administrative Gramsh.

Rreth 8 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU GJIROKASTËR

- Njësia administrative Tepelenë
- Njësia administrative Përmet
- Njësia administrative Këlcyrë
- Njësia administrative Krahës
- Njësia administrative Picar
- Njësia administrative Zagori
- Njësia administrative Kurvelesh
- Njësia administrative Qesarat
- Njësia administrative Dropull
- Njësia administrative Pogon.

Rreth 40 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU VLORË

- Njësia administrative Selenicë
- Njësia administrative Dhërmi ("DIGITALB" DHE "ADTN")
- Njësia administrative Konispol.
- Njësia administrative Delvinë ("DIGITALB" DHE "ADTN").
- Fshatrat e lumit të Vlorës (Drashovicë, Kotë, Brataj, Tërbaç, Velçë, Vranisht, Kuç etj.).

Rreth 16 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

Në nivel kombëtar, përqindja e popullsisë së pa mbuluar me shërbim audioviziv numerik është paraqitur në tabelën si vijon, për çdo operator.

Nr.	Subjekti	Përqindja e popullsisë e pambuluar me shërbim audioviziv numerik
1	RTSH	2.8%
2	TV Klan	3%
3	Top Channel	11%
4	Digitalb	11%
5	Media Vizion	7.5%
6	ADTN	11%

Informojmë se për zonat e pambuluara me shërbim audioviziv nga rrjetet kombëtare tokësore numerike, mundësohet ofrimi i shërbimit audioviziv nëpërmjet platformave kabllore, satelite, IPTV, OTT dhe Internet TV, sipas përcaktimeve ligjore/nënligjore në fuqi.



9. TRANSMETIMET NUMERIKE

9.1 Lirim i brezit të Dividendifit Dijital Dy (DD2)

Për lirimin e brezit 700 MHz nga transmetimet audiovizive dhe kalimin e frekuencave të Dijital Dividentit DY (DD2) në përdorim për rrjetet e komunikimeve elektronike të lëvizshme, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) ka ndjekur një sërë hapash për të përmbushur këtë tranzicion, duke përfshirë inventarizimin e rrjeteve numerike, koordinimin ndërkufitar dhe përditësimin e planifikimit të frekuencave. Planit të Ri Numerik UHF u realizua në bashkëpunim të ngushtë me shtetet fqinje për koordinimin e frekuencave. Ky plan synonte ruajtjen e 7 rrjetave aktuale televizive në Shqipëri, duke e bërë vendin tonë të vetmin që me planin e ri të ndarjes së kanaleve televizive numerike ka arritur të ruajë dhe të konfirmojë përdorimin e 7 rrjeteve numerike.

Pas finalizimit me sukses të procesit të koordinimit ndërkufitar, plani përfundimtar u miratua nga AMA dhe u formalizua në ndarjen e re të kanaleve televizive numerike, e cila paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

Rrjetet Numerike	AL 001D	AL 002D	AL 003D	AL 004D	AL 005D	AL 006D	AL 007D	AL 008D	AL 009D	AL 010D	AL 011D	AL 012D	Numri i kanaleve në total
MUX 1 (RTSH)	33	42	42	33	33	42	28	36	27	37	28	na	6
MUX 2 (RTSH)	34	40	40	34	34	40	27	22	28	38	27	na	6
MUX 3 (KLAN)	28	30	30	28	41	30	41	29	45	23	23	na	6
MUX 4 (DIGITALB)	21	36	38	21	21	45	31	48	48	48	31	na	5
MUX 5 (TOP CHANNEL)	22	32	32	24	39	47	39	47	47	47	na	na	6
MUX 6 (MEDIA VIZION)	45	45	45	45	43	43	43	43	43	na	na	na	6
MUX 7 (ADTN)	23	23	25	23	23	25	35	32	21	35	na	na	5
Lokale	41	26	27*	na	na	na	na	34*	na	42*	na	na	26

Në vijim të këtij procesi, AMA ka administruar dokumentet finale të përcjella nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) mbi projektin e BEsë "Mbi asistencën teknike në fushën e telekomunikacionit". Këto dokumente përbajnjë rekandime mbi licencat, vlerësimin e kostove të migrimit dhe strategjinë e migrimit sipas metodologjisë "Island Procedure". Kjo strategji do të zbatohet menjëherë pas miratimit të ligjit "Për Lirimin e Frekuencave të Digital Dividentit DY (DD2)" dhe do të ndiqet me përpikmëri nga AMA në terren.

Gjatë vitit 2024, AMA ka patur angazhim të plotë në përditësimin e Planit Kombëtar të Frekuencave bazuar në aktet finale të WRC-23, duke marrë pjesë aktive në takimet e organizuara nga MIE. Në këto takime u vendos që lirimi i brezit DD2 të kryhet brenda dhjetorit të vitit 2025.

9.2 Kontrata AMA - RTSH

Gjatë vitit 2024, Autoriteti vijoi zbatimin e standardit të realizimit të dy shqyrtimeve të performancës së Transmetuesit Publik (një për gjashtëmujorin e parë dhe një për të dytin), mbi përbajtjet e transmetuara nga kanalet e RTSH - së, si dhe të dhënave mbi mosbulimin me sinjal të disa zonave të shërbimit në territorin e vendit tonë.

Këto dy shqyrtime u kryen në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht, në nenet 18 dhe 19, ku pasqyrohen objektivat dhe funksionet e Autoritetit; në nenin 33, mbi detyrimet e OSHMA - ve; kreun 12, që rregullon veprimtarinë e RTSH - së, ku përfshihen nenet 90 – 126 etj; si dhe i referohen përbajtjes së Kontratës së Shërbimit të Transmetimit Publik, miratuar nga Autoriteti me vendim nr. 18, datë 02.03.2017.

Për gjeljet në këto shqyrtime, AMA ka informuar drejtuesit e RTSH - së, si dhe Kuvendin e Shqipërisë. Si gjetje për shqyrtimin që u realizua në fund të muajit dhjetor 2024, aspektet kryesore ishin:

- RTSH KUVENDI transmeton dhe r/transmeton periodikisht seancat plenare, apo mbledhjet e komisioneve parlamentare të përhershme dhe të përkohshme, por në programacionin e këtij kanali ende nuk po përfshihen përbajtje informuese, biseda, intervista e konsulta me ekspertë e profesionistë, për projekt - ligje e akte të tjera në proces hartimi e këshillimi publik, mjaft të dobishme këto për ndjekësit. Ky ka qenë një rekomandim i përsëritur dhe i Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik. Po ashtu, përsërisim sugjerimin se RTSH Kuvendi mund të përgatisë e të transmetojë emisione, dokumentarë, speciale etj., për historinë e parlamentarizmit shqiptar, figura të shquara të së shkuarës parlamentare, për botime e njojhe të akteve themelore të Parlamentit European etj.
- RTSH FËMIJË ka përgjithësisht programacion që i përbush kërkesat e parashikuara në Kontraten e Shërbimit të Transmetimit Publik të RTSH - së. Përfshirja e filmave të viteve të fundit, si dhe realizimi i emisioneve me natyrë interaktiviteti do ta bënte më tërheqës këtë kanal, duke iu përgjigjur shijeve dhe kërkesave të gjeneratës së re. Ndjejhet dukshëm nevoja e rritjes së numrit dhe të llojeve të emisioneve me dhe përfshirja e grupmoshave 12 – 15 vjeç.
- AMA i qëndron sugjerimit të shprehur dhe më parë se mënyra e mësimdhënies në kanalin RTSH SHKOLLË mund të rikonceptohet duke i mëshuar më shumë anës praktike të llojit demonstrime në laboratorë, vizita në qendra historike, muzeale, biznese prodhimi, biseda me ekspertë sipas specifikave të lëndëve përkatëse. Pasurimi i dijeve edhe në arsimin profesional do të ishte një vlerë e shtuar për këtë kanal edukativ. Orari i transmetimit të shpjegimeve nga mësuesit e lëndëve ka mbetur po i njëjtë me kohën e kufizimeve të pandemisë, kur nxënësit nuk shkonin në shkollë për shkaqe objektive. Ndaj vijimi i këtij regjimi kohor, nga mëngjesi deri në orët e para të mbadites është jo efektiv, ndërkohë që nxënësit janë në mënyrë të përmirësuar duke ndjekur programin mësimor. Edhe për fundjavën duhet të shikohet mundësia e



· shtimit të programeve zbavitëse dhe argëtuese, duke reduktuar përsëritjet e transmetimeve të shpjegimeve të lëndëve të ndryshme mësimore nga ditët e javës.

· Pavarësisht vështirësive të rekrutimit të ekspertëve të gjuhës së shenjave, kanali RTSH 1 do të duhet të vijojë në mënyrë të qëndrueshme transmetimin e edicioneve informative të shoqëruara me shpjegimet përkatëse, për të ndihmuar dhe mbështetur ndjekësit e programeve, të cilët përballen me mosdëgjimin. Po ashtu, në mënyrë të qëndrueshme, RTSH do të duhet të përmbushi plotësish kërkesat e ligjit nr. 76/2014, për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9636, datë 06.11.2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar. Kutojmë se në nenin 1 të këtij ligji thuhet se: RTSH “transmeton çdo muaj programe edukative për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit, në përputhje me ligjin për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”. Këto programe edukative kanë një kohëzgjatje në total prej 90 minutash dhe transmetohen nga ora 08:00 deri në orën 22:00. Një prej këtyre programeve, me kohëzgjatje prej 30 minutash, transmetohet detyrimisht nga ora 17:00 deri në orën 22:00”.

AMA pas marrjes zyrtarisht nga RTSH të Projekt - Kontratës së shërbimit (protokolluar në institucion me nr. 3467/2, datë 12.12.2022), e cila ka kaluar në një fazë të detajuar shqyrtimi dhe korrespondencia edhe gjatë 2023 dhe në datë 31.01.2024, është ridërguar me komentet e institucionit për diskutim pranë RTSH - së.

Gjatë vitit 2024, megjithë korrespondencat e kryera me RTSH - në mbi korrigjimin dhe plotësimin e projekt - kontratës së transmetuesit publik, AMA, pasi ka shqyrtuar përbajtjen e projekt - kontratës ka dërguar komentet dhe propozimet e tij me shkresë nr. 201/1 prot., datë 06.02.2024, me qëllim përmirësimin e përbatjes në përputhje me kërkesat e ligjit organik.

Së fundmi, RTSH me shkresën nr. 203/10 prot., datë 05.06.2024 ka paraqitur kontratën e shërbimit të transmetimit publik RTSH - AMA për periudhën 5 - vjeçare. Në këtë shkresë, theksohet se Këshilli Drejtues i RTSH - së, me vendimin nr. 9, datë 08.04.2024 ka miratuar kontratën e rishikuar të shërbimit të transmetuesit publik, e cila është nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i RTSH - së.

Autoriteti i Mediave Audiovizive, AMA, në mbledhjen e tij të radhës, me vendimin nr. 77 datë 09.07.2024, ka vendosur:

1. Refuzimin e miratimit të Kontratës së Shërbimit të Transmetimit Publik midis AMA - s dhe RTSH – së;
2. Rishikimin e projekt - kontratës nga ana e RTSH - së sipas rekomandimeve të AMA – s, propozuar me shkresën nr. 201/1 prot., datë 06.02.2024.

Sa më sipër, RTSH, në zbatim të nenit 117 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 3 “AMA mund të nënshkruajë kontratën e shërbimit të transmetimit publik ose të kërkojë rishikimin e saj brenda 30 ditëve nga paraqitja e saj”, i është kërkuar RTSH - së të rishikojë projekt - kontratën e shërbimit të transmetuesit publik dhe ta paraqesë AMA - s sipas afateve kohore sa më sipër.

Theksojmë se deri në hartimin e raportit vjetor të AMA – s, kontrata me transmeuesin publik nuk është paraqitur ende e miratuar në AMA.

9.3 Planifikimi dhe administrimi i spektrit të frekuencave

Planifikimi dhe administrimi i spektrit të frekuencave audio/audiovizive realizohet në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore e rregullatore kombëtare dhe ndërkombëtare. Menaxhimi në mënyrë sa më efektive i shfrytëzimit të spektrit audio/audioviziv krijon mundësi për licencimin e operatorëve të rinj në treg, siguron shmangjen e interferencave të dëmshme brenda dhe jashtë vendit, si dhe garanton cilësi të lartë shërbimi te përdoruesit fundorë.



9.3.1 Planifikimi i frekuencave për shërbimet audiovizive

Bazuar në aktet ligjore e nënligjore kombëtare dhe ndërkombe, brezi frekuencor, i përcaktuar për transmetime tokësore numerike DTT, është brezi UHF dhe VHF. Bazuar në Planin Kombëtar Numerik (PKN), banda UHF, aktualisht, është në përdorim nga operatorët audiovizivë, që mundësojnë transmetimet numerike në të gjithë territorin e vendit. Operatori publik shqiptar RTSH disponon frekuencia për dy rrjetë numerike si dhe 5 operatorët privatë kombëtarë numerikë kanë në dispozicion frekuencia për 1 rrjet numerik secili prej tyre. Ndërkohë është licencuar edhe një rrjet lokal, i cili mbulon me shërbim allotmentin Elbasan. Plani Frekuencor Numerik, paraqitet si më poshtë:

ALLOTMENTET	MUX-ET								Local
	MUX 1	MUX 2	MUX 3	MUX 4	MUX 5	MUX 7	MUX 6		
AL001D/ Shkodra	28	41	34	59	45	54	22		
AL002D/ Kukësi	26	32	50	40	42	52	36		
AL003D/ Dibra	38	24	55	30	25	60	54		
AL004D/ Lezha	43	23	33	46	29	na	na		
AL005D/ Tirana	34	21	41	56	59	39	57		
AL006D/ Elbasani	23	33	42	48	49	40	46	37	
AL007D/ Fieri	27	31	35	28	22	45	29		
AL008D/ Berati	25	30	32	36	54	47	24		
AL009D/ Korca	43	45	51	55	57	27	21		
AL010D/ Gjirokastra	26	37	44	29	50	35	48		
AL011D/ Vlora	23	39	46	57	43	51	53		

9.3.2 Planifikimi i frekuencave për shërbimet audio

Për planifikimin dhe administrimin e spektrit audio FM 87.5 - 108 MHz, AMA, në vijimësi, ka vlerësuar periodikisht kapacitetet e lira të frekuencave audio, si dhe ka përditësuar Planin e Përdorimit të Frekuencave për këto shërbime. Disponueshmëria e frekuencave të lira, të brezit audio FM, mbetet një tjetër sfidë për rregullatorin, duke qenë se në qarqet ku ka më shumë kërkesë për këtë shërbim si Tiranë, Durrës, Fier dhe Vlorë, identifikoohen mungesa në burime të fundme, ndërkohë disponohen resurse të nevojshme për qarqet e tjera të vendit.

AMA, gjatë vitit 2024, ka kryer studimet teknike me qëllim:

- Rinovimin e 11 licencave të subjekteve që ofrojnë transmetime audio analoge;
- Zgjerimin e zonës së licencimit të 3 subjekteve të interesuara për të ofruar transmetime audio në qarqe të ndryshme të vendit;
- Ndryshimin e karakteristikave teknike të transmetimit me qëllim mbulimin e plotë të zonës së licencimit.

9.3.3 Koordinimi i frekuencave të brezit audio dhe audioviziv

Gjatë vitit 2024, AMA ka vijuar procesin e koordinimit me vendet nënshkruese të Marrëveshjes GE84 për transmetimet analoge audio FM, për evidentimin e hapësirave të optimizimit dhe shtimit të kapaciteteve transmetuese.

Bazuar në kërkesat e ardhura për koordinim nga vendet fqinjë, AMA ka kryer studimet teknike dhe ka verifikuar përputhshmërinë e propozimeve të paraqitura nga vendet e rajonit me përcaktimet në marrëveshjen GE84. Administrata e Bosnje-Hercegovinës, Bullgarisë, Greqisë dhe Maqedonisë së Veriut, kanë kërkuar miratimin e AMA-s lidhur me caktimet frekuencore, sipas të cilave Shqipëria është konsideruar e prekur nga modifikimet apo shtimet e kërtuara.



Gjithashtu, gjatë këtij viti, janë kryer dhe procedurat e koordinimit në përputhje me:

- Aktet finale të Konferencës Rajonale GE-06 (Rajoni 1 dhe Rajonit 3) "Për planin e transmetimeve audio/audiovizive digitale në brezin frekuencor 174-230 MHz.

Në kuadër të procesit të koordinimit të brezit III VHF për transmetimet audio/audiovizive digitale (në teknologjinë DVB-T2 dhe T-DAB), me vendet që lagen nga ujërat e deteve Adriatik dhe Jon (Itali, Kroaci, Slloveni, Mal i Zi, Bosnie Hercegovinë, Greqi dhe Shqipëri), iniciuar nga administrata e Italisë, edhe gjatë vitit 2024 janë organizuar disa takime, me qëllim rialokimin dhe përdorimin e këtij brezi në mënyrë efikase, proporcionale dhe pa interferenca të dëmshme. Bazuar në Planin GE-06, Shqipëria mund të ndërtojë një rrjet kombëtar që mundëson transmetime audiovizive tokësore digitale (DTT) dhe dy rrjete kombëtare që mundësojnë transmetime audio tokësore digitale (T-DAB). Ndërkohë draft plani i ri frekuencorë i rialokimit të brezit të III VHF, në krahasim me Planin GE-06, mundëson për administratën shqiptare përvec sa më sipër, rrjetin e tretë kombëtar për transmetime audio digitale T-DAB. Procedura e koordinimit të brezit III VHF do të vijojë edhe gjatë vitit 2025, me qëllim dakordësimin e përdorimeve të kanaleve frekuencore nga secila administratë palë e diskutimeve, si dhe finalizimin e propozimeve me firmosjen e një marrëveshjeje shumëpalëshe midis vendeve pjesëmarrëse.

9.4 Adresimi i interferencave të shkaktuara nga operatorët audio/audiovizivë

Shmangia e interferencave të dëmshme

Në kuadër të përmirësimit në identifikimin e interferencave, që vijnë nga vendet fqinje dhe atyre të shkaktuara nga pikat transmetuese në territorin e Shqipërisë dhe marrjen e masave për shmangien e tyre, edhe gjatë vitit 2024, AMA ka pasur në fokus të veçantë monitorimin e spektrit audio FM, në të gjithë territorin e vendit. Monitorimi synon identifikimin dhe zgjidhjen, në kohë të shpejtë, të interferencave që shkaktohen nga sinjalet e emetuara nga transmetuesit e vendeve fqinje.

Në këtë kuadër, AMA, administron sistemin e qendërzuar të monitorimit të spektrit audio FM, në 12 stacione transmetimi. Ky sistem, monitoron on-line spektrin audio FM, përkatesisht në qytetet Kukës, Shkodër, Lezhë, Durrës, Fier, Vlorë, Berat, Gjirokastër, Korçë, Pogradec, Librazhd dhe Sarandë. Krahas identifikimit të menjëhershëm të interferencave, sistemi bën të mundur:

- Identifikimin e menjëhershëm të rasteve kur operatorët në treg ndryshojnë frekuencat;
- Identifikimin e menjëhershëm të përdorimit në mënyrë ilegale të spektrit audio;
- Kontrollin e gjendjes reale të transmetimit të subjekteve audio të licencuar (janë në transmetim apo jo);
- Kontrollin e parametrave teknikë të transmetimit të subjekteve audio. Në qytetet e tjera, monitorimi i spektrit audio është kryer në mënyrë periodike nëpërmjet Qendrës së Lëvizshme të Monitorimit të Frekuencave (QLMF).

Interferencat e shkaktuara brenda vendit

Gjatë vitit 2024, AMA nuk ka administruar asnjë ankesë lidhur me interferencat e shkaktuara brenda vendit.

Interferencia të shkaktuara drejt vendeve të tjera

Referuar interferencave në transmetimet audiovizive gjatë vitit 2024, AMA ka administruar ankesat e rregulatorëve të Malit të Zi, Greqisë, Maqedonisë së Veriut dhe Italisë, të cilët kanë raportuar nivele të larta sinjali në territoret e tyre nga transmetuesit tanë audiovizivë. Këto sinjale kanë shkaktuar interferenca me transmetimet e lëvizshme 5G në vendet përkatëse.



AMA ka arritur të zgjidhë disa nga këto ankesa përmes migrimeve tranzitore provizore, duke shfrytëzuar të gjitha kapacitetet e spektrit frekuencor në dispozicion. Megjithatë, në kushtet aktuale, nuk është e mundur të implementohen skenarë të tjerë teknikë provizorë për eliminimin e interferencave me shtetet fqinje.

Interferencat e shkaktuara nga transmetimet audiovizive në brezin LTE 800

Referuar interferencave të brendshme, AMA gjatë vitit 2024, ka administruar ankesën e sipërmarrësave të komunikimeve elektronike “One Albania”sha.a mbi shkaktimin e interferencave të dëmshme në brezin e transmetimeve LTE 800, në qarkun Gjirokastër. Për zgjidhjen e ankesës së sipërmarrësit “One Albania sh.a.u ngri një grup i përbashkët monitorimi AMA, AKEP dhe operatori mobile. Pas verifikimeve të nevojshme në terren u identifiku burimi i interferencës dhe ju adresua operatorëve përkatës.

Interferencat e shkaktuara nga transmetimet FM në brezin e navigacionit ajror (108-137 Mhz)

Për sa u përket interferencave të shkaktuara nga transmetimet e FM në vendet fqinje, gjatë vitit 2024, AMA ka administruar ankesën e administratave të Maqedonisë së Veriut dhe Kroacisë mbi interferencën e shkaktuar në brezin aeronautik (108-137 Mhz) nga operatorët tanë respektivisht “Radio Club FM” dhe “Radio MCN”. Në lidhje me këtë problematikë, u kryen konstatimet e nevojshme, si dhe marrja e masave përrregullimin e parametrave teknike të transmetimit dhe vendosjen e tyre brenda normave të lejuara, duke eleminuar interferencat e dëmshme shkaktuar nga këto subjekte.

9.5 Sektori TIK

Gjatë vitit 2024, në kuadër të modernizimit dhe rritjes së kapaciteteve teknologjike, u realizua ndërtimi i një infrastrukturë të re IT të bazuar në nyje të mbikonverguara (HCI). Kjo teknologji e avancuar siguron një kapacitet të lartë përpunimi dhe menaxhim të automatizuar të burimeve, duke përmirësuar ndjeshëm efikasitetin dhe performancën e shërbimeve institucionale. Sistemi i ri u implementua për të adresuar kufizimet e infrastrukturës ekzistuese dhe për të garantuar një platformë moderne, të sigurt dhe të qëndrueshme për administrimin e të dhënavës dhe shërbimeve kritike të institucionit.

Në kuadër të këtij projekti, u realizua ndërtimi i një infrastrukturë të avancuar të bazuar në teknologjinë e nyjeve të mbikonverguara, e cila ofron një menaxhim të optimizuar të hapësirës së ruajtjes dhe burimeve përpunuese. Gjithashtu, u krye një përmirësim i rrjetit ekzistues përmes furnizimit me pajisje të reja Firewall, të cilat sigurojnë një nivel më të lartë mbrojtjeje dhe komunikim të sigurt me nyjet e virtualizimit. Për të garantuar një përdorim efikas të kësaj platformë, u organizuan trajnime të specializuara për stafin IT, duke i aftësuar ata me njohuritë e nevojshme për administrimin dhe operimin e infrastrukturës së re.

Siguria dhe disponueshmëria e të dhënavës janë prioritete kyçë të kësaj infrastrukturë të re. Për këtë arsy, u implementuan masa për mbrojtjen dhe ruajtjen e të dhënavës në disa kopje, duke garantuar një rikuperim të shpejtë në rast të ndonjë incidenti. Përmirësimet e realizuara sollën gjithashtu një rritje të ndjeshme të performancës së sistemit në nivel pajisjesh hardware, përpunimi, leximi dhe shkrimi të të dhënavës, si dhe operacioneve IO. Për të siguruar një nivel të lartë sigurie në rrjet, u vendosën zgjidhje të dedikuara për mbrojtjen e infrastrukturës HCI. Gjithashtu, infrastruktura e re është projektuar për të mbuluar jo vetëm nevojat aktuale, por edhe ato të ardhshme të institucionit, duke ofruar kapacitetet dhe parametrat e nevojshëm për hostimin e shërbimeve dhe sistemeve të tjera.

Për të siguruar një funksionim të qëndrueshëm dhe afatgjatë të kësaj infrastrukturë të avancuar, është hartuar dhe një plan i mirëmbajtjes vjetore. Ky plan synon të mbajë të gjitha pajisjet dhe sistemet teknologjike në performancën e tyre optimale, të garantojë mbrojtjen nga kërcënimet kibernetike dhe të parandalojë ndërprerjet e papritura të shërbimeve institucionale. Në këtë kuadër, janë parashikuar përditësime të rregullta të softuerit dhe pajisjeve për të adresuar çdo dobësi sigurie dhe për të siguruar funksionim efikas të sistemit.



Një tjetër projekt i rëndësishëm gjatë vitit 2024 ka qenë implementimi i sistemit për arkivimin digjital të dokumenteve dhe dosjeve të institucionit. Ky sistem ka mundësuar migrimin dhe organizimin e të dhënave aktuale në format digjital, duke krijuar një platformë të bazuar në web për administrimin e arkivës digjitale. Përmes këtij sistemi eshtë siguruar përputhshmëria me standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin shqiptar për dokumentin elektronik, duke automatizuar procesin e digitalizimit dhe garantuar ruajtjen e sigurt të materialeve digjitale. Ky zhvillim ka sjellë përfitime të konsiderueshme, duke përmirësuar menaxhimin dhe organizimin e dokumentacionit, rritur qasjen në informacion dhe siguruar një administrim më efikas.

Në maj të vitit 2024 eshtë finalizuar implementimi i këtij sistemi për arkivimin digjital të dosjeve dhe dokumenteve që ruhen në arkivin e Autoritetit të Mediave Audiovizive. Me këtë projekt janë migruar të dhënat ekzistuese në format digjital, duke përfshirë dokumentet e mëparshme të digitalizuara nga institucioni. Kjo qasje ka lehtësuar shkëmbimin e informacionit ndërmjet institucionit, qytetarëve dhe administratës publike, duke rritur efikasitetin e proceseve administrative.

Modület përkatëse të platformës funksionojnë në mënyrë të integruar, duke mundësuar shkëmbimin dhe transmetimin e informacionit në mënyrë efikase. Sistemi eshtë instaluar në një nga serverët e institucionit dhe mund të aksesohet ekskluzivisht nga rrjeti i brendshëm, duke garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave.

Me anë të realizimit të këtij projekti, janë arritur disa objektiva kyçë, duke përfshirë implementimin e një sistemi informatik të bazuar në web, i cili shërben për administrimin e arkivës digjitale. Ky sistem ka lehtësuar ndjeshëm procedurat e administrimit të dosjeve, kërkimit dhe përpunimit të dokumenteve arkivore. Gjithashtu, eshtë siguruar përputhshmëria me standardet e përgjithshme ndërkombëtare për arkivim dhe me Ligjin Nr. 10 273, datë 29.4.2010, "Për dokumentin elektronik", i ndryshuar me Ligjin Nr. 124/2016.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i këtij projekti ka qenë sigurimi i një funksionimi të pandërprerë të sistemit gjatë ditëve të punës, duke garantuar disponueshmërinë dhe performancën e tij. Për të mbështetur këtë funksionalitet, eshtë organizuar një program trajnimi për stafin përdorues dhe teknik, me qëllim që ata të jenë në gjendje të operojnë dhe mirëmbajnë sistemin në mënyrë të pavarrur.

Gjithashtu, nga sektori TIK në bashkëpunim me Drejtorinë e Botimit dhe Ndërveprimit në AMA eshtë nisur zhvillimi një sistem të automatizuar për mbledhjen dhe analizën e të dhënave mbi Operatorët e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA). Deri më tani, procesi i mbledhjes së të dhënave ka qenë manual dhe i ngadalshëm, duke krijuar vështirësi në koordinim dhe ruajtjen e evidencave. Me implementimin e platformës së re, AMA ka për qëllim të sigurojë automatizim dhe centralizim të të dhënave, duke garantuar rritje të saktësisë në përpunimin dhe analizimin e informacionit, si dhe monitorimi në kohë reale të tregut audio dhe audioviziv. Kjo do të na ndihmojë në identifikimin e trendëve dhe problemeve në treg, duke lehtësuar shqyrtimin e ankesave dhe vendimmarrjen e bazuar në të dhëna të sakta.

Sektori TIK, gjatë vitit 2024 ka filluar zhvillimin i një sistemi të automatizuar për studimin dhe analizën e thelluar të aspekteve të ndryshme të dinamikës së tregut audio dhe audioviziv në Republikën e Shqipërisë. Ky sistem do të mundësojë centralizimin e të dhënave nga OSHMA-të dhe optimizimin e përpunimit të tyre, duke rritur efikasitetin dhe analizën. Platforma do të ndihmojë në identifikimin e trendëve dhe problemeve në treg, si dhe vlerësimin e performancës së këtyre subjekteve. Përmirësimi rrënjesor do të jetë në aksesin dhe monitorimin e tyre në kohë reale. Me këtë platformë, AMA do të ketë një pasqyrë të plotë të tregut duke lehtësuar raportimin dhe mbikëqyrjen efektive.



10. AUTORITETI NË PËRMBUSHJE TË REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Bazuar në programin e auditimit me nr. 896/2 prot., datë 03.11.2022, Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), gjatë vitit 2023, ndërmori një auditim pranë AMA - s, me objekt “Mbi auditimin Financiar dhe të përputhshmërisë”, i cili përfshiu periudhën 01.01.2019 – 30.06.2022 për në verifikimin e zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve.

Me shkresën nr. 896/9 prot., datë 18.05.2023, KLSH dorëzoi Raportin Përfundimtar të Auditimit duke nënvisuar se në përgjithësi veprimtaria e institucionit, është kryer në përputhje me kuadrin ligor dhe aktet nënligjore në fuqi dhe për devijime materiale, por jo të përhapura të konstatuara, dha rekomandimet përkatëse.

AMA, duke vlerësuar raportin përfundimtar dhe rekomandimet përkatëse, hartoi “Matricën e zbatimit të programit të rekomandimeve”, të dërguara nga KLSH - ja dhe pasi analizoi situatën, përcaktoi strukturën përkatëse dhe afatet e zbatimit të rekomandimeve, si për propozime për ndryshime apo përmirësimë në legjislacion dhe akte nënligjore, ashtu dhe për ato me karakter organizativ, si masa administrative dhe disiplinore.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, nëpërmjet programit të auditimit me nr. 900/1 prot, datë 11.10.2023 me objekt: “Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH për auditimin e evaduar në 6 - mujorin e parë të vitit 2023”, kreu procedurën përkatëse të verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të lëna dhe në datën 29.12.2023, përçolli pranë AMA - s Raportin përfundimtar, ku nënizon opinionin se: nga 46 rekomandime, niveli zbatimit është:

- 30 rekomandime janë zbatuar plotësisht;
- 15 rekomandime janë në proces zbatimi dhe
- 1 rekomandim i pa zbatuar.

Statusi i zbatueshmërisë së rekomandimeve të KLSH - së, në proces dhe e pazbatuar, ka rezultuar jo për shkak të mosmarries së masave nga AMA, por për shkak të afateve të vendosura nga KLSH, përtej periudhës të kryerjes së këtij auditimi.

AMA po vijon me marrjen e masave për zbatueshmërinë e rekomandimeve.




Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1479 prot., datë 12.12.2024 “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimet e performancës të evaduara në 6 - mujorin e dytë të vitit 2023”, KLSH nëpërmjet Akt Verifikimit nr. 3 kërkoi nga AMA zbatimin e rekomandimeve të KLSH – së.

Në përgjigje të Akt - Verifikimit nr. 3, datë 16.01.2025 të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Departamenti i Auditimit të Performancës, administruar në Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA), me nr. 230 prot., datë 16.01.2025, mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e performancës me temë “Garantimi i mbrojtjes së të drejtës së autorit”, AMA paraqiti observacionet sa më poshtë:

- Lidhur me mosrespektimin e afateve ligjore për informimin dhe raportimin në KLSH për zbatimin e rekomandimeve të lëna në zbatim të nenit 15 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nga ana e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), bëjmë me dije se nga ana e AMA - s gjatë kësaj periudhe nuk janë ndërmarrë iniciativa ligjore lidhur me “Garantimin e mbrojtjes së të drejtës së autorit” duke qenë se iniciativa ligjore për këtë fenomen nis nga MEKI si Ministria përgjegjëse dhe jo nga AMA. Në vijim të sa më sipër, theksojmë faktin që AMA ka vijuar procesin e punës duke u përqendruar në luftën kundër piraterisë dhe cënimit të të drejtave të transmetimit duke e diktuar procesin me kuadrin ligjor institucional, siç është Ligji 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Lidhur me masat për ndryshimet ligjore në shambahjen e mbivendosjes së kompetencave sipas fushave të përgjegjësisë, si dhe të rishikojnë/nënshkruajnë marrëveshjet e bashkëpunimit, lidhur me garantimin e mbrojtjes të së drejtës së autorit, ISHMT dhe AMA janë duke shqyrtuar hapësirat ligjore dhe institucionale për hartimin e një Memorandumi Bashkëpunimi midis dy institacioneve. Propozimit për nënshkrimin e këtij Memorandumi i jemi përgjigjur institucionalisht duke vlerësuar piketat e këtij bashkëpunimi dhe vijimësinë sipas korrespondencës bashkëlidhur këtij komenti. Fillimi i vitit 2025 do të jetë dhe inicimi faktik ndërisitacional, i cili do të vijojë me nënshkrimin e marrëveshjes së mirëkuptimit midis dy institacioneve.



11. AUTORITETI NË PËRMBUSHJE TË TRANSPARENCËS DHE RRITJES SË IMAZHIT INSTITUCIONAL

11.1 Organizimi i brendshëm i institucionit

Organizimi i brendshëm i institucionit

Në mbështetje të Planit Strategjik të Veprimit 2024 - 2026 të AMA – s, miratuar me vendimin nr.18, datë 26.02.2024 të anëtarëve të saj, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkivë - Protokollit në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të kapaciteteve dhe përmirësimit të sistemeve të mirëfunksionimit të brendshëm të institucionit, ka pasur në fokus të punës së saj menaxhimin me efikasitet të burimeve njerëzore dhe zhvillimin e mëtejshëm të nepunësve aktual dhe atyre të rekrutuar rishtaz.

Sa i përket pozicioneve në strukturën aktuale miratuar me vendimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr. 86/2022 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozitioneve të punës të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), për të cilat marrëdhëniet juridike dhe financiare të punës rregullohen me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, janë lidhur gjithësej 3 kontrata pune për pozicionet respektive vakante të strukturës.

Po ashtu, procesi i plotësimit të vendeve vakante në strukturë për nepunësit civil ka vijuar edhe gjatë vitit 2024, duke hartuar planin vjetor të rekrutimit dhe duke përfshirë të gjitha fazat ligjore për çdo pozicion të shpallur.

Gjatë vitit 2024 janë publikuar gjithësej 21 shpallje për pozicionet vakante në shërbimin civil (sipas strukturës), nga të cilat 5 janë të pa zhvilluara me procedurat pasardhëse, pasi në fazat respektive të procesit të rekrutimit nuk janë paraqitur kandidatë për konkurrim si dhe në një rast kandidatët e kualifikuar në fazën e parë të procesit nuk janë shpallur fitues nga Komisioni i Vlerësimit. Gjithësej, gjatë vitit 2024 janë realizuar 17 rekrutime për pozicionet respektive vakante, nepërmjet procedurave ligjore deri në nxjerrjen e urdhreve të emërimit rast pas rasti. Aktualisht, janë vakante sipas strukturës 7 pozitione pune, 6 prej të cilave janë pozitione të nepunësit civil dhe një pozicion me kontratë pune (Përgjegjës i Sektori Teknik/ Drejtoria Inspektimit dhe Mbikëqyrjes). Nga këto 6 pozitione të lira në shërbimin civil, 4 prej tyre janë nepunës të nivelit ekzekutiv (4 specialistë), 1 nepunës i nivelit të ulët drejtues (Përgjegjës Sektori) dhe një nepunës i nivelit të mesëm drejtues (Drejtor Drejtoria).

Sa i përket plotësimit të vendeve vakante me nëpunës civil gjatë vitit 2024, nga 17 nëpunës civilë të emëruar gjithsej:

- 3 janë nëpunës civil të nivelit të mesëm drejtues (dy me ngritje në detyrë dhe një me me proceduren e pranimit nga jashtë shërbimit civil);
- 7 nëpunës civil të nivelit të ulët drejtues (dy nëpunës me ngritje në detyrë dhe pesë nëpunës me proceduren e pranimit nga jashtë shërbimit civil);
- 7 nëpunës të nivelit ekzekutiv (1 nëpunës me procedurën e lëvizjes paralele dhe 6 nëpunës me procedurën e pranimit nga jashtë shërbimit civil).

11.2 Programi i transparencës

Autoriteti i Mediave Audiovizive e ushtron veprimtarinë e tij mbështetur në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe si një institucion i pavarur publik, sigurohet që të jetë transparent ndaj publikut, duke zbatuar dispozitat që rrjedhin nga ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.

Programi i transparencës, i cili është publikuar në faqen zyrtare të institucionit, është i rishikuar, i ndarë në disa nënkategori për publikimin e informacionit nga autoriteti publik. Në të, përfshihen korniza ligjore të veprimtarisë së autoritetit, në kuadër të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, i ndryshuar, mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi AMA - s, informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të AMA - s, informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, shërbimet që ofrohen nga AMA, procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve, informacione/dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykojnë të dobishme për publikim nga AMA etj.

Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së Autoritetit, nëpërmjet pasqyrimit të detajuar të tij në faqen zyrtare <https://ama.gov.al/>. Në përbajtje të programit të transparencës, evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menu - të ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet, me linkun përkatës. Përveç kësaj, çdo dokument i bërë publik, është përditësuar në formë e përbajtje.

Faqja zyrtare e AMA - s është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë, në format lehtësish të kuptueshëm. Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënavë personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve, gjë e cila mbikëqyret dhe nga nëpunësi për mbrojtjen e të dhënavë personale, i caktuar nga institucioni si person përgjegjës.

AMA ka ndjekur standardin e tërheqjes së mendimeve, sugjerimeve dhe propozimeve nga ana e grupeve të interesit, duke zbatuar me rigorozitet proceset e konsultimit dhe këshillimit publik, prej të cilave përmirëson projektet e paraqitura në faqen zyrtare të AMA - s. Gjithashtu, Autoriteti publikon “Regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve”, i cili pasqyron të gjitha kërkesat për informacion, që kanë mbërritur në institucion dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet çdo 1 muaj dhe publikohet në faqen e internetit të Autoritetit. Gjatë vitit 2024, pranë AMA - s kanë mbërritur rreth 72 kërkesa për informacion, të cilat kanë marrë përgjigje brenda afatit të parashikuar në ligj (10 ditë pune), duke shënuar kështu një rekord pozitiv për Autoritetin.

Në shërbim të publikut dhe përmirësimit të procedurave administrative, pjesë e transparencës janë dha formularët digjitalë për ankesa/aplikime, duke mundësuar thjeshtimin e procedurave për ofrimin e shërbimeve ndaj publikut. Rritja e transparencës dhe përgjegjshmërisë së rregulatorit, ndikon në fuqizimin e besueshmërisë së qytetarëve.



Lehtësimi i barrës burokratike, nëpërmjet komunikimit me publikun apo dhe me subjektet që Autoriteti licencon/autorizon, është një nga synimet kryesore të institucionit, kjo dhe falë postës elektronike të AMA-s, info@ama.gov.al. Kthimi i përgjigjeve bëhet sipas afateve të përcaktuara nga ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar. Gjithashtu, duke qenë se rrjetet sociale Facebook dhe Instagram janë në përdorim nga shumë qytetarë, AMA ka në këto rrjete adresat e saj zyrtare, gjë e cila ka rritur interaktivitetin me qytetarët dhe është parë si mënyrë efikase për të arritur qëllimet në rrugë më të shpejtë dhe më pak burokratike.

AMA ka publikuar një bazë të dhënash me informacion rreth operatorëve audio dhe audiovizivë në Republikën e Shqipërisë, e cila gjendet në rubrikën OSHMA, në faqen WEB të saj. Në të përfshihen të dhënrat e të gjithë OSHMA - ve që AMA ka autorizuar/licencuar, të përbledhura në një format i cili është lehtësish më i përdorshëm nga qytetarët apo grupet e interesit.

Një objektiv i arritur i Autoritetit të Mediave Audiovizive përgjatë vitit 2024 është edhe publikimi i një baze digitale të dhënash mbi strukturën e pronësisë së OSHMA - ve të autorizuar/licencuar nga AMA. Kjo bazë të dhënash është lehtësish e gjendshme dhe e mundshme për përdorim nga çdo i interesuar, pasi ndërtimi dhe struktura e informacionit të publikuar është realizuar në mënyrë të tillë që të jetë e qartë dhe e kuptueshme për të gjithë. Ky informacion gjendet në faqen WEB të Autoritetit të Mediave Audiovizive, në rubrikën “Transparenca e Pronësisë së Medias”.

Mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive janë të hapura për takimet me qytetarët që kanë ankesa/pyetje apo për subjektet që kanë paqartësi në procesin e plotësimit të dokumenteve, vështirësi në fazat e aplikimit apo pyetje rreth procesit të marrjes/rinovimit të licencës. Drejtoritë e Autoritetit, të udhëhequra kryesisht nga drejtori, zhvillojnë takime ballë për ballë, në sallën e pritjes, duke vendosur në shërbim të subjekteve apo qytetarëve informacionin e nevojshëm, duke shmangur procesin burokratik, që mund të krijohet nëpërmjet komunikimit shkresor. Po ashtu, në vijim të komunikimit dhe transparencës mes subjekteve/qytetarëve dhe Autoritetit, në faqen zyrtare të AMA - s, krahas email - it zyrtar janë të publikuara dhe email - et e secilës drejtori, si dhe numrat e telefonit për të lehtësuar dhe adresuar problematikat në departamentin përkatës.

Nëpërmjet hyrjes në fuqi të ndryshimeve më të fundit në ligjin nr. 97/2013, datë 19.03.2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të cilat u realizuan kryesisht me qëllim përafrimin e legjislacionit të brendshëm në fushën e mediave audiovizive me Direktivën e BE 2018/1808 (Direktiva e Shërbimeve Mediatiche Audiovizive), janë përforcuar detyrimet e institucionit për të mundësuar aksesin sa më të përshtatshëm në informacion për kategoritë e personave me aftësi të kufizuara (PAK).

Përcaktimi i një personi kontakti në faqen zyrtare për dhënien e informacionit dhe marrjen e ankesave, lehtësish të arritshme nga personat me aftësi të kufizuara në shikim e dëgjim, ndihmojnë në përbushjen e objektivave të AMA - s, të dala në zbatim të ligjit organik për mediat audiovizive, si dhe të praktikave më të mira të së drejtës së BE, mbi të drejtën e aksesit në informacion nga komunitete me mangësi të pjesshme ose të plotë shikimi ose dëgjimi, aftësia e të cilëve për të perceptuar sinjale audio apo audiovizive është e kufizuar në atë masë, që e bën të pamundur gëzimin e së drejtës së informimit.

Së dyti, sa i takon elementëve të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuari, analizuar në një kornizë më të gjërë, Plani Kombëtar i Republikës së Shqipërisë për Personat me Aftësi të Kufizuari (PKVPAK 2021–2025), i miratuar me VKM - në nr. 276, datë 12.05.2021, përfshin në objektivin e tij specifik nr. 3: “realizimin e aksesueshmërisë në informimin dhe në komunikim për personat me aftësi të kufizuari”, konkretisht aksesueshmërinë e kësaj kategorie në faqet e internetit. Qëllimi i aksesueshmërisë në internet është heqja e barrierave ndaj personave me aftësi të kufizuara në përdorimin e faqeve të internetit.



- Individët që janë të verbër ose me shikim të reduktuar, kërkojnë që faqet e internetit të shoqëruara me lexues të ekranit, të cilët lexojnë tekstin me zë të lartë; ofrojnë tekste alternative për imazhet dhe përshkruajnë imazhet; lejojnë ndryshimin e madhësisë së tekstit, imazheve dhe faqosjet e fakteve dhe sigurojnë mjete alternative të lundrimit në internet;
- Personat që nuk dëgjojnë apo kanë vështirësi dëgjimi, do të kërkojnë titra për çdo përmrbajtje, përfshirë dhe video, multi - player, aplikacione;
- Personat me aftësi të kufizuara në lëvizje, mund të kërkojnë kohë shtesë për të lundruar në internet.

Masat e parashikuara synojnë përmirësimë të kuadrit ligjor ekzistues, duke përfshirë zhvillimin/adaptimin e standardeve të sigurimit të qasjes në internet, për të siguruar që personat me aftësi të kufizuar të kenë akses në baza të barabarta me të tjerët në faqet e internetit të sektorit publik, shërbimet, aplikacionet dhe përmrbajtjen e tyre.

11.3 Aktivitete të Autoritetit

Gjatë vitit 2024 AMA ka vijuar aktivitetet e saj me grupet e interesit, në lidhje me çështje të rëndësishme, që prekin median audiovizive. Në kuadër të procesit të rishikimit të Kodit të Transmetimit, përafrrimit të legjislacionit të brendshëm me asquis e BE - së, intensifikimit të bashkëpunimit me partnerët dhe rregullatorët e vendeve të rajonit dhe më gjerë, si dhe çështjeve të tjera me rëndësi, AMA ka kryer një sërë veprimtarish e takimesh si:

- AMA iniciuese e procesit të Matjes së Shikueshmërisë

Vitin 2024 AMA e ka nisur me organizimin e 3 Tryezave tepër të rëndësishme, të cilat shënjojnë edhe fillimin e procesit të Matjes së Shikueshmërisë në Shqipëri.

- **Tryeza e parë** u organizua më 15 janar 2024, ku u ftuan të gjithë ofruesit e shërbimit audioviziv dhe agjenci të ndryshme të cilat operojnë në fushën e matjes së shikueshmërisë;
- **Tryeza e dytë** u organizua më 31 janar 2024. Të ftuar ishin sërisht ofruesit e shërbimit audioviziv dhe agjenci të reklamave/marketingut, të cilët u njohën me disa modele të ndjekura nga vendet e tjera të rajonit dhe BE - së, për realizimin e procesit të Matjes së Shikueshmërisë. Në këtë takim u morën dhe vendimet e para të rëndësishme për procesin, siç ishte dhe dakordësia mbi përbërjen dhe numrin e anëtarëve të atij që do të quhet Komiteti i Përbashkët i Industrisë;
- **Tryeza e tretë**, më 6 shkurt 2024, organizuar me prezencën e ofruesve të shërbimit audioviziv të pajisur me licencë rajonale, me qëllim zgjedhjen e tre prej tyre që do të bëhen anëtarë të KPI - së, deri në zgjedhjen e ardhshme, për të plotësuar kështu gjithë përbërjen e Komitetit, si më poshtë:

- 1- Radio Televizioni Shqiptar (Televizioni publik);
- 2- Top Channel (OSHMA Kombëtare);
- 3- TV Klan (OSHMA Kombëtare);
- 4- Vizion Plus (OSHMA Kombëtare);
- 5- ABC News (OSHMA Rajonale);
- 6- Euro Balkans News (OSHMA Rajonale);
- 7- News 24 (OSHMA Rajonale);
- 8- Ogilvy Albania (Agjenci reklamash);
- 9- Plus Media (Agjenci reklamash).

Përfundimisht, në datën 10.07.2024, pas 6 muaj diskutim të vazhdueshëm me aktorët e medias në gjetjen e një formule të përbashkët që të përfshinte peshën kryesore të medias por edhe të agjencive reklamuese, u dakordësua konstituimi zyrtarisht i Komitetit të Përbashkët të Industrisë (KPI). Pas një procesi inkurajues për palët, nën udhëheqjen e Autoritetit të Mediave Audiovizive, KPI, si një subjekt plotësish i organizuar



me të gjithë aktorët e tij, mbetet të ndërmarrë hapin tjetër, që është regjistrimi në gjykatë, i cili do të bëjë të mundur fillimin praktikisht të procesit të matjes së shikueshmërisë si një instrument i rëndësishëm ndër të tjera edhe për identifikimin e ndikimit të mediave në publikun e gjerë.

- Takime të tjera promovuese të vlerave të organizuara nga AMA

Takim tjetër përgjatë 2024, konkretisht më **13 shkurt 2024**, ishte ai i organizuar në Gjirokastër me rastin e **Ditës Botërore të Radios**, e cila është caktuar si e tillë nga UNESCO si një përpjekje për të theksuar rëndësinë e këtij mediumi në shoqëri. Në këtë takim të organizuar nga AMA, morën pjesë personalitetë të ndryshme, përfaqësues të ofruesve të shërbimit audio në rajonin e Gjirokastrës, gazetarë, etj. Organizimi i këtij takimi ceremonial, synonte të theksonte vlerësimin e Autoritetit të Mediave Audiovizive për mediume të tilla, si pjesë shumë të rëndësishme të një shoqërie, për rolin dhe ndikimin që ato mbartin.

Më 20 shkurt 2024, AMA ka organizuar një tjetër aktivitet shumë të rëndësishëm, me synimin e ndërgjegjësimit ofruesit e shërbimeve audiovizive dhe gazetarët në përdorimin e rregullt e të pastër të gjuhës shqipe, si një parim i cili udhëheq edhe veprimtarinë e ofruesve të këtyre shërbimeve, ashtu siç edhe ligji e përcakton. **Konferenca Fol Shqip** mblodhi gjuhëtarë, gazetarë, pedagogë, akademikë, studentë të gazetarisë, në një tryezë të përbashkët, të cilët diskutuan mbi rëndësinë e ruajtjes së pastërtisë së gjuhës shqipe në përdorimin e saj gjatë transmetimeve audiovizive, si dhe frenimin e dukurisë së përdorimit të panevojshëm të fjalëve të huaja.

- Zhvillimi i fushatës së Edukimit Mediatik në Kopshte, Tiranë

Në periudhën e parë të vitit 2024, Këshilli i Ankesave në AMA ka organizuar një sërë takimesh në kopshtet e kryeqytetit, në kuadër të edukimit mediatik. Qëllimi i këtyre takimeve informuese dhe edukuese ka qënë njojja e prindërve dhe edukatorëve me rreziqet ndaj të cilave mund të përballen fëmijët gjatë lundrimit të tyre në internet, sfidat dhe mënyrat se si duhet të përgjigjemi ndaj rreziqeve të tilla, me qëllim mbrojtjen e të miturve nga ekspozimi ndaj këtyre rreziqeve në mjedisin online.

Për shkak të veçorive të zhvillimit të tyre moshor dhe nevojës për orientim në botën mediatike dhe digitale, në prag të një hapi të rëndësishëm të jetës së tyre, siç është shkollimi, Edukimi Mediatik nga AMA u përqendrua në 20 kopshte, në të gjitha njesitë administrative të Tiranës. Në çdo kopsht ku ekipet e AMA - s kanë qenë, janë zhvilluar biseda informuese dhe edukuese, bashkëbisedim me prindër, gjyshër dhe edukatorë të pranishëm, janë transmetuar video informuese të realizuara nga AMA si dhe janë shpërndarë materiale të publikuara për këtë qëllim. Vëmendje e veçantë në këto biseda iu kushtua nevojës së orientimit të fëmijës në mjedisin audioviziv dhe përdorimit të mekanizmave mbrojtës për shëndetin e tij fizik dhe mendor, ushtrimit të kontrollit prindëror mbi praninë dhe sjelljen e fëmijës në internet, mënyrave të kufizimit të kohës së fëmijës online, mbrojtjen e tij nga rreziqet kibernetike, etj.

Në çdo takim të pranishmit kanë shprehur interes dhe kanë kërkuar më shumë informacione për veçori të përdorimit të duhur të internetit, rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale në mjediset digitale, si edhe për mjetet e mbrojtjes prej rreziqeve që vijnë prej hapësirës kibernetike etj.

- Raportime periodike në kuadër të angazhimeve ndërkombëtare dhe ndërinstitucionale

Po ashtu Sektori i Legjislacionit Ndërkombëtar dhe Integrimit kryen raportime periodike 3 - mujore dhe 6 - mujore në kuadër të angazhimeve ndërkombëtare sa i përket monitorimit dhe realizimit të masave institucionale të nevojshme për përbushjen e objektivave dhe detyrave të lëna nga Komisioni në fushën e mediave audiovizive, si më poshtë listojmë kontributet periodike dhe te vazhdueshme:

- Kontribut mbi Planin e Veprimit dhe Pasaportën e Indikatorëve në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale



- të Drejtësisë 2024 - 2030 të hartuar nga Ministria e Drejtësisë, në rolin e institucionit lider për hartimin dhe monitorimin e politikave strategjike në fushën e drejtësisë (përgjigje shkresës nr. 4015 prot., datë 19.07.2024, protokolluar me shkressën tonë nr. 2184 prot., datë 22.07.2024);
- Kontribut lidhur me projekt - vendimin dhe dokumentat strategjikë, të hartuar nga Ministria e Drejtësisë “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024 - 2030, të planit të saj të veprimit, si dhe pasaportës së treguesve”;
- Kontribut lidhur me Raportin e IV - t periodik të Shqipërisë në kuadër të zbatimit të Konventës së Kombeve të Bashkuara “Mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore” në adresimin e rekomandimeve të Komitetit Ekonomik dhe Social (CESCR);
- Kontribut i Autoritetit të Mediave Audiovizive lidhur me Projekt - Planin e Veprimit për fazën V (2025 - 2029) të Programit Botëror për Edukimin mbi të Drejtat e Njeriut (WPHRE) në përputhje me Rezolutën 54/7 të Këshillit për të Drejtat e Njeriut;
- Kontribut i Autoritetit të Mediave Audiovizive lidhur me zbatimin e rekomandimeve për paragrafët 19.b dhe 35 - 36 të Vëzhgimeve Përbyllëse CERD/CALB/CO/13 - 14 të komitetit CERD në kuadër të Konventës për Eleminimin e Diskriminimit Racor;
- Pjesëmarrje në takimet e grupit të punës të ngritur në bazë të Urdhrit nr. 39, datë 24.01.2024 “Për ngritjen dhe funksionimin e grupit teknik ndërinstitucional të punës për hartimin e ndryshimeve në ligjin nr. 9870/2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, si dhe dhënia e kontributit të AMA - s për hartimin e ndryshimeve në ligjin nr. 9870/2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri” (periudha Maj – Korrik 2024);
- Dhënia e kontributit në kuadër të marrëveshjes CEFTA sa i përket angazhimeve që Shqipëria ka ndërmarrë si rrjedhojë e anëtarësimit në Organizatën Botërore të Tregtisë;
- Kontribut i Autoritetit të Mediave Audiovizive për përgatitjen e Raportit Kombëtar mbi zbatimin e Deklaratës dhe Platformës për Veprim;
- Kontribut i Autoritetit të Mediave Audiovizive në kuadër të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave 2024 - 2030;
- Dhënia e kontributit të Autoritetit të Mediave Audiovizive në lidhje me Growth Plan Reform për përmirësimin e lirisë së shprehjes në përputhje me standartet e BE - së, në kuadër të Rule of Law;
- Dhënia e kontributit të Autoritetit të Mediave Audiovizive përmes plotësimit të pyetësorit mbi Gjuhën e Urrejtjes;
- Dhënia e kontributit të AMA - s në kuadër të angazhimit për hartimin e Raportit Kombëtar të Rishikimit Periodik Universal (UPR) sa i përket nivelit të zbatimit të rekomandimeve sipas fushës së përgjegjësisë;
- Dhënia e kontributit në hartimin, kryerjen e ndryshimeve dhe finalizimin e tekstit të rregullores “Për kërkosat e posaçme që ofruesit e shpërndarjes së videove duhet të përmbushin për krijimin e operimin e sistemeve transparente, efektive e miqësore në përdorim”;
- Dhënia e kontributit të Autoritetit të Mediave Audiovizive në kuadër të Programit për Parandalimin e Vetëvrasjeve në Shqipëri 2025 – 2030;
- Hartimi i marrëveshjes së bashkëpunimit midis Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Autoritetit të Mediave Audiovizive;
- Dhënia e kontributit të Autoritetit të Mediave Audiovizive në lidhje me Planin e Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2022 – 2025;
- Dhënia e kontributit në lidhje me Planin e Masave për zbatimin e Rekomandimeve në zbatim të Konventës për të Drejtat e Fëmijës (CRC);
- Pjesëmarrje në takimet e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrin Evropian për kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore” dhe Kriterin Politik;
- Pjesëmarrje në takimin online të organizuar nga Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (FRA) në bashkëpunim me Komisionin Evropian, Xchange i 2 - të lidhur me Kartën e të Drejtave të Njeriut të BE - së;
- Pjesëmarrje në trajnimet e zhvilluara pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Enerjisë në kuadër të përdorimit efikas të Platformës së Integrimit Evropian dhe Anëtarësimit (PIEA) për kapitullin 10 “Transformimi digjital dhe media”;

- Pjesëmarrje në takimin e radhës në kuadër të procesit të hartimit të kontributit për Raportin e Sundimit të ligjit 2025 të Bashkimit Evropian të zhvilluar pranë Ministrisë së Drejtësisë;
- Pjesëmarrje në takimin për Monitorimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave 2024 - 2030 të zhvilluar pranë Ministrisë së Drejtësisë;
- Shqyrtimi, analizimi dhe përgatitja e kontributit për Instrumentin e Raportimit për semestrin III (periudha korrik – shtator) 2024 në kuadër të Paketës së Semestrit & Integrimi Evropian (PSIE) 2024 për Kapitullin 31 "Politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes";
- Shqyrtimi, analizimi dhe përgatitja e kontributit për periudhën janar - dhjetor 2024 në kuadër të Paketës së Semestrit & Integrimi Evropian (PSIE) 2024 për Kapitullin 31 "Politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes";
- Vlerësimi i Raportit Screening i Komisionit Evropian 2024 dhe angazhimet në kuadrin negociues të Kapitullit 31;
- Dhënia e kontributit mbi detyrat e lëna nga Raporti Screening i Komisionit Evropian 2024 në kuadër të Kapitullit 31;
- Shkresë kthim përgjigje mbi kontributin e Autoritetit të Mediave Audiovizive për Kapitullin 31 "Politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes" (përgjigje shkresës nr. 9486/1 prot., datë 26.06.2024, protokolluar me shkresën tonë nr. 2007 prot., datë 01.07.2024);
- Vlerësimi i Raportit Screening i Komisionit Evropian 2024 dhe angazhimet në kuadrin negociues të Kapitullit 10;
- Shqyrtimi dhe hartimi i kontributit për Semestrin IV (Tetor – Dhjetor) të vitit 2024 në kuadër të Paketës së Semestrit & Integrimi Evropian (PSIE) 2024 referuar Kapitullit 10 “Transformimi digital dhe media”;
- Shqyrtimi dhe hartimi i kontributit për periudhën Janar – Dhjetor të vitit 2024 referuar Kapitullit 10 “Transformimi digital dhe media”;
- Dhënia e kontributit në lidhje me guiding questions në kuadër të kapitullit 10 "Transformimi digital dhe media";
- Përgatitja e komenteve dhe rishikimi i pozicionit negociues në kuadër të kapitullit 10 " Transformimi digital dhe media";
- Kontributi i dytë i Autoritetit të Mediave Audiovizive në kuadër të progres raportit për Kapitullin 10;
- Shqyrtimi dhe hartimi i kontributit për 3 mujorin e dytë të vitit 2024, referuar kapitullit 7 “Pronësia Intelektuale”;
- Dhënia e kontributit të AMA - s në lidhje me Paketën e Semestrit të Integrimit Evropian të kapitullit 7 “Pronësia Intelektuale” për semestrin II, IV 2024;
- Dhënia e kontributit mbi detyrat e lëna nga Progres Raporti i Komisionit 2024 për periudhën janar - korrik dhe tetor - dhjetor 2024 referuar kapitullit 7 “Pronësia Intelektuale”;
- Shqyrtimi dhe hartimi i kontributit për semestrin I, II, III dhe IV të vitit 2024 lidhur me monitorimin e ecurisë së masave të Udhërrëfyesit për shtetin e së drejtës në kuadër të Kapitullit 23 “Gjyqësori dhe Të Drejtat Themelore”;
- Dhënia e kontributit mbi zbatimin e rekomandimeve të marra në kuadër të Raportit të vitit 2024 në lidhje me Sundimin e Ligjit;
- Dhënia e kontributit të AMA - s në lidhje me monitorimin e PSIE për periudhën tetor - dhjetor 2024 në kuadër të “Funksionimit të Institucioneve Demokratike”;
- Përgatitja e kontributit referuar ecurisë së masave të parashikuara në Udhërrëfyesin për lirinë e shprehjes, në kuadër të kapitullit 23 “Gjyqësori dhe Të Drejtat Themelore”;
- Dhënia e kontributit në lidhje me pyetjet e dërguara nga Komisioni në lidhje me “Media Pluralism and Media Freedom” në kuadër të Kapitullit 23 “Gjyqësori dhe Të Drejtat Themelore”, sipas kërkesës së dërguar nga Ministria e Drejtësisë;
- Dhënia e kontributit të AMA - s në lidhje me projekt raportin e Sundimit të Ligjit (Rule of Law) 2024 në kuadër të Kapitullit 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”;
- Dhënia e kontributit periodik të AMA - s lidhur me progresin e Udhërrëfyesit të shtetit të së Drejtës për

periudhën Janar – Qershori 2024 në kuadër të Kapitullit 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”;

- Dhënia e kontributit në hartimin e Planit Semestral të Integrimit Evropian për vitin 2025 referuar kapitullit 28 “Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndeti Publik”;
- Rishikimi i pozicionit negocies të Cluster 2 “Tregu i brendshëm” në kuadër të kapitullit 28 “Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndeti Publik”;
- Përgatitja e raportimit semestral periodik të AMA - s për periudhën Prill – Qershori 2024 në kuadër të Kapitullit 28 “Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndeti Publik”;
- Dhënia e kontributit të AMA - s në kuadër të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) për periudhën 2025 - 2027 referuar Kapitullit 23 “Gjyqësori dhe Të Drejtat Themelore”, sa i përket masave konkrete politike/ligjore apo institucionale/administrative, periudhës kohore që parashikohet për realizimin e tyre si dhe mënyrës së financimit;
- Dhënia e kontributit të AMA - s në lidhje planifikimin e Paketës së Semestrit të Integrimit Evropian (PSIE) për “Funksionimin e Institucioneve Demokratike” (FDI) për vitin 2025;
- Dhënia e kontributit të AMA - s në kuadër të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) për periudhën 2025 - 2027 referuar Kapitullit 10 “Transformimi digital dhe media”, sa i përket masave konkrete politike/ligjore apo institucionale/administrative, periudhës kohore që parashikohet për realizimin e tyre si dhe mënyrës së financimit;
- Shqyrtimi dhe dërgimi i dakordësisë në kuadër të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian për periudhën 2025 – 2027, referuar Kapitullit 3 “E drejta e vendosjes dhe liria e ofrimit të shërbimeve”;
- Dërgimin e informacionit për mjaftueshmërinë e kapaciteteve dhe strukturave lidhur me raportin e vlerësimit të kapaciteteve të Integrimit Evropain (CAF) në vijim të pikës 3 të Konkluzioneve Operacionale në kuadër të Kapitullit 10 dhe Kapitullit 28;
- Dhënia e kontributit të AMA - s në kuadër të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) për periudhën 2025 - 2027 referuar kapitullit 28 “Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndeti Publik”;
- Dhënia e kontributit të AMA - s në kuadër të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) për periudhën 2025 - 2027 referuar Kapitullit 31 “Politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes”, sa i përket masave konkrete politike/ligjore apo institucionale/administrative, periudhës kohore që parashikohet për realizimin e tyre si dhe mënyrës së financimit, Politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes;
- Përgatitja e Paketës së Raportit kombëtar të Veprimtarisë GNPIE & Vlerësimit të Indeksit të Kapaciteteve të Integrimit Evropian për 3 - mujorin e IV (Tetor - Dhjetor 2024) si dhe vijimin për përgatitjen dhe finalizimin e Planit Menaxherial të Integrimit Evropian për Forcimin e Kapaciteteve Administrative për vitin 2025 (PSIE 2025) për secilin nga kapitujt që AMA jep kontribut.

- Takime në kuadër të bashkëpunimit me homologët e vendeve të rajonit dhe më gjërë

AMA përgjatë vitit 2024, ka vijuar më tej bashkëpunimin me rregulatorët e vendeve të rajonit, si KPM, AVMU, AEM e Malit të Zi, etj. Mes AMA - s dhe homologëve të saj në rajon janë zhvilluar takime, ku fokusi kryesor ka qënë bashkëpunimi mes rregulatorëve për sa i përket çështjeve të rendësishme të fushës së medias audio dhe/ose audiovizive, me të cilat ato përballen apo që mund të përballen në të ardhmen. Thelbi i këtyre takimeve ka qënë shkëmbimi i eksperiençave mes rregulatorëve për çështje si metodat e monitorimit të programeve, trajtimi i ankesave, administrimi i spektrit të frekuencave audio - audiovizive, hartimi i akteve nënligjore në zbatim të përafrimtë të legjislacioneve të brendshme me *acquis* e BE - së, etj.

- Takime mes AMA – Komisioni i Pavarur i Mediave, Kosovë

Bashkëpunimi mes AMA - s dhe KPM - s ka vijuar përgjatë vitit 2024 me vizita të ndërsjella. Të dy rregulatorët kanë shkëmbyer eksperiencat e tyre për çështje të rendësishme, ku rolin më kryesor e kanë zënë diskutimet mbi procesin e harmonizimit të legjislacionit me *acquis* të BE - së, si dhe rendësia për bashkëpunim të vazhdueshëm mes dy rregulatorëve.

- Takime mes AMA – Agjencisë së Medias për Shërbimet Audiovizive, Maqedoni

Agjencia e Medias për Shërbimet Audiovizive, ka zhvilluar konferencën Vjetore Ndërkontinentale Rregullatore (IRC) për Ditën Ndërkontinentale të Telekomunikacionit, më 14 - 15 maj 2024.

IRC 2024 ishte një ngjarje e rëndësishme në fushën e teknologjisë së komunikimit. Ky event solli në fokus sfidat, mundësitë dhe inovacionet që shoqërojnë përdorimin e frekuencave në mbarë rajonin. Përmes këtij takimi u nënizua rëndësia e koordinimit mes vendeve fqinje për brezin III VHF, me synim për të implementuar teknologjinë DAB+ dhe u synua të krijohet një rrjet bashkëpunimi dhe të ndërgjegjësimit ndërkontinentar, që do të ndihmojë në vijim në zhvillimin dhe përdorimin e brezit të frekuencave në mënyrë të qëndrueshme dhe të avancuar teknologjikisht për përfitimin e të gjithëve.

- Takime mes AMA – Rregulatorëve Audioviziv të Ballkanit Perëndimor (KPM, IRC dhe AMU)

Krjimi i një Agjende Digitale për sigurinë e fëmijëve në Ballkanin Perëndimor ishte fokusi i konferencës së parë rajonale që u organizua në Tiranë nga Autoriteti i Mediave Audiovizive në bashkëpunim me Qendrën për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri (CRCA/ECPAT). Në tryezë merrnin pjesë drejtues të platformës TikTok, të rregulatorëve të Malit të Zi, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, ekspertë të fushës etj. AMA vendosi në muajin gusht një bashkëpunim me platformën TikTok, i cili deri tani ka rezultuar shumë i suksesshëm. Duke pasur si objektiv rregullimin e Platformave të Shpërndarjes së Videove, pjesë e detyrave që ligji i jep AMA - s, nga muaji gusht është krijuar një link i dedikuar në web - in zyrtar të AMA - s ku qytetarët mund të raportojnë përbajtjet e publikuara në platformën TikTok që ata i gjykojnë të dëmshme. Këto raportime, shqyrtohen nga ekipet e AMA - s dhe ato që gjenden në shkelje të ligjit raportohen në platformën TikTok. Kryetarja e AMA - s, Armela Krasniqi ka ftuar në tryezën e organizuar në Tiranë, me TikTok dhe CRCA/ECPAT Shqipëri, edhe homologët nga Mali i Zi, Kosova dhe Maqedonia e Veriut në mënyrë që kjo praktikë të mundësohej edhe në vende të tjera të Ballkanit. Drejtuesit e rregulatorëve të cilët ishin të pranishëm në takim, Branko Boskovic i rregulatorit malazez dhe Drejtoresha Ekzekutive e këtij rregulatori, Suncica Bakic, Jeton Mehmeti i KPM Kosovë dhe Selver Ajdini i rregulatorit të Maqedonisë së Veriut prezantuan situatën e përgjithshme në vendet respektive sa i takon Platformave të Shpërndarjes së Videove në përgjithësi dhe TikTok në veçanti. Të gjitha palët ranë dakord për nevojën e bashkëpunimit mes rregulatorëve dhe platformave dhe ngritjen e një skeme bashkëregullimi mes palëve, për një mjesid të sigurt digital për qytetarët. Objektivi i përgjithshëm i Agjendës Digitale për Ballkanin Perëndimor të TikTok ishte mbështetja e zhvillimit të aftësive digitale dhe të sigurisë në gjashtë vende: Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni e Veriut dhe Serbi.

- Bashkëpunime ndërinstitucionale

Bashkëpunimet ndërinstitucionale dhe ato me partnerët ndërkontinentarë, kanë qënë të shumta përgjatë 2024 dhe shumë pozitive. AMA ka marrë pjesë në një sërë tryezash bashkëpunimi me institucione të tjera të vendit, për çështje dhe/ose problematika të ndryshme, apo në kuadër të përafrimit të legjislacionit me acquis e BE-së. Këto takime janë zhvilluar me autoritete si AKEP, OSSH, ISHTI, RrTL, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Ministria e Kulturës, Ministria e Financës, Ministria e Drejtësisë, KQZ, Autoriteti i Konkurrencës, etj, si më poshtë vijon:

- Takime mbi proceset elektorale

Viti 2024 si në vit para elektoral ka ndikuar në bashkëpunimin e ngushtë dhe pozitiv të Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Janë zhvilluar disa takime ku AMA ka marrë pjesë me përfaqësuesit e saj, për përgatitjet përpara nisjes së fushatës zgjedhore, por edhe pas saj. Fokus i këtyre takimeve kanë qënë çështje si: digitalizimi i proceseve zgjedhore, standarde etike, rolin dhe përgjegjësinë e medias, si dhe përdorimi i gjuhës së urrejtjes gjatë fushatës zgjedhore, me qëllim shëmangien



dhe/ose zgjidhjen e problematikave që mund të lindin gjatë këtij procesi, për sa i takon fushës së mediave audio dhe audiovizive.

- **Takime me Ministrinë në kuadër të përafrimit të legjislacionit me acquis e BE - së**

Përgjatë gjithë vittit kalendarik 2024, AMA ka marrë pjesë në disa takime me Ministri të ndryshme, në kuadër të bashkëpunimit për përafrimin e legjislacionit të brendshëm për disa kapituj përafrimi, në të cilët AMA ka kontribut konkret. Konkretnisht, janë zhvilluar takime me Ministrinë e Kulturës dhe Inovacionit, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, në lidhje me kapituj si: Kapitulli 23 "Gjyqësori dhe liritë themelore", Kapitulli 28 "Mbrojtja e Konsumatorit", Kapitulli 7 "Pronësia Intelektuale", etj.

- **Takime me partnerët ndërkombëtar**

AMA ka kryer një sërë takimesh periodike me partnerë të ndryshëm ndërkombëtar, si OSBE/ODIHR, KiE, etj. Në fokusin e këtyre takimeve kanë qënë tema që kanë të bëjnë kryesisht me monitorimin e mediave përgjatë procesit zgjedhor, dezinformimi, liria e shprehjes dhe e medias, edukimi mediatik, etj.

- **Bashkëpunim mes AMA & OSBE/ODIHR**

AMA ka vijuar bashkëpunimin e ngushtë me partnerin ndërkombëtar OSBE/ODIHR edhe përgjatë vittit 2024, duke marrë pjesë në Konferenca dhe Tryeza të organzuara nga ky partner i rëndësishëm, por edhe duke pritur në mjediset e Autoritetit grupë përfaqësuesish të nivelit të lartë të OSBE/ODIHR. Fokus i këtyre takimeve kanë qënë çështje me të cilat AMA është angazhuar, si procesi i Matjes së Shikueshmërisë, ndryshimet ligjore në ligjin organik të AMA - s, përshtatja me Direktivat e BE - së, zhvillimi i teknologjisë, nevoja e rregullimit të Platformave të Shpërndarjes së Videove, ndikimi i Inteligjencës Artificiale etj. Fokus i këtyre takimeve të zhvilluara patjetër kanë qënë dhe përgatitjet nga AMA pér procesin e monitorimit të mbulimit të fushatës elektorale nga OSHMA - të, pér zgjedhjet qendrore të vittit 2025, si dhe bashkëpunimi i AMA - s me KQZ - në pér trajnimin e monitoruesve të pëfshirë në proces, pér njofitimet kujtesë që adresohen tek OSHMA - të pér nevojën e respektimit të standardeve dhe kërkesave të Kodit Zgjedhor etj.

- **Bashkëpunim mes AMA dhe Këshillit të Evropës**

AMA ka vijuar gjithashtu bashkëpunimin e ngushtë me Këshillin e Evropës edhe përgjatë vittit 2024, në Takime e Tryeza të zhvilluara në mjediset e AMA - s, por edhe jashtë Autoritetit. Fokus i këtyre takimeve kanë qënë sigurisht angazhimet e AMA - s në procese të ndryshme, si transparenca e pronësisë së medias audiovizive, si një proces i kryer tashmë, bashkërrregullimi i Platformave të Shpërndarjes së Videove, nisur si hap i parë me TikTok - un, lirinë e medias, edukimin mediatik dhe funksionimin e sektorëve kryesorë të AMA - s, monitorimi i ofruesve të shërbimit mediatik përgjatë periudhës së fushatave zgjedhore, në respektim të Kodit Zgjedhor dhe metodologjisë së miratuar nga KQZ pér monitorimin e medias audio dhe audiovizive.

Autoriteti i Medias Audiovizive (AMA) ka luajtur një rol të rëndësishëm si mbajtës i sekretariatit të Aleancës Kundër Gjuhës së Urrejtjes, duke kontribuar në përpjekjet pér të luftuar këtë fenomen dhe pér të promovuar një mjesi mediatik të përgjegjshëm dhe të respektueshëm.

Ky angazhim ka qenë pjesë e një bashkëpunimi të ngushtë me Zyrën e Këshillit të Evropës në Tiranë dhe përfaqësinë e Delegacionit të Bashkimit European, të cilët kanë mbështetur këtë iniciativë me qëllim përmirësimin e klimës mediatike në vend. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, AMA ka organizuar tryeza diskutimi me aktorë të ndryshëm të medias, Fakultetin e Gazetarisë, Shoqërinë Civile, Avokatin e Popullit dhe Komisionerin pér Mbrojtjen nga Diskriminimi. Këto tryeza kanë ofruar një mundësi pér shkëmbimin e

ideve dhe për të zhvilluar diskutime të thelluara mbi problematikat që lidhen me gjuhën e urrejtjes në media dhe mënyrat e mundshme për ta luftuar atë. Përmes këtyre tryezave, janë diskutuar tema të rëndësishme si edukata mediatike, përmirësimi i standardeve profesionale të gazetarëve dhe roli i mediave në promovimin e një shoqërie të hapur dhe demokratike, ku çdo individ mund të shprehet pa pasur frikë nga diskriminimi ose fyerja. Po ashtu, është nënvizuar rëndësia e një bashkëpunimi të fortë ndërmjet institucioneve publike dhe shoqërisë civile për të garantuar një mjeshtësi drejtë dhe të barabartë për të gjithë. Ky angazhim ne kuadër të bashkëpunimit me zyrën e Këshillit të Evropës ka kontribuar në ngritjen e ndërgjegjësimit publik pér pasojat e gjuhës së urrejtjes dhe ka mbështetur zhvillimin e një debati konstruktiv dhe të respektueshëm në media. Kjo ka shërbyer si një mundësi për të forcuar kulturën e dialogut dhe mirëkuptimit, si dhe për të siguruar që media të jetë një mjet që promovon vlerat e demokracisë, diversitetit dhe barazisë.

Zyra e Këshillit të Evropës në Shqipëri ka qënë gjithmonë një partner i rëndësishëm për AMA - n, duke asistuar dhe mbështetur AMA - n në aspekte shumë të rëndësishme për Autoritetin, me qëllim arritjen e standardeve të Bashkimit Evropian.

- Takime mes AMA - s dhe autoriteteteve rregullatore të vendeve anëtare të BE - së

Gjithashtu, në periudhën korrik - nëntor të vitit 2024, kryetarja e AMA - s ka kryer takime konsultuese dhe shkëmbim eksperiencash me përfaqësues të autoriteteteve rregullatore nga disa vendet anëtare të BE - së.

Ajo mori pjesë në Asamblenë e 21 - të dhe 22 - të Plenare e ERGA - s, (Grupi i Rregulatorëve Europianë për Shërbimet Mediatike Audiovizive) ku pjesëmarrësit, të cilët ishin drejtuesit e nivelit të lartë të organeve kombëtare rregullatore të pavarura në fushën e shërbimeve audiovizive, kishin në fokus rikonsiderimin e të gjithë kuadrit ligjor, në përshtatje me dinamikat e zhvillimit të tregut mediatik. Në këtë takim, Kryetarja e AMA - s theksoi se institucioni ka gjithë vullnetin dhe kapacitetet për të përdorur të njëjtët instrumente që aplikojnë rregulatorët e 27 vendeve anëtare të BE - së.

Gjithashtu, në të gjitha takimet me përfaqësues të lartë të autoriteteteve europiane rregullatore, tematikat e diskutimit kanë qenë praktikat më të mira europiane mbi transparencën në fushën e medias audiovizive dhe mundësitet e përafrimit me legjislacionin e brendshëm shqiptar, të cilat do të shërbejnë si shembull për hartimin e akteve përkatës nënligjore.

- Përfaqësimi i AMA - s në platformat ndërkombëtare të fushës së mediave audiovizive

Autoriteti i Mediave Audiovizive, përgjatë vitit 2024, ka zhvilluar një sërë takimesh dhe konferencash jashtë vendit, me institucione të BE - së dhe autoritete rregullatore homologe në rajon, Europë dhe përtej kontinentit evropian. Takimet e ndjekura nga AMA kanë qënë të një rëndësie të veçantë, si në kuadër të integrimit të BE - së dhe përafrimit të legjislacionit shqiptar me direktivat e BE - së, ashtu edhe në kuadër të shkëmbimit të eksperiencave më të mira mes Autoriteteteve rregullatore për çështje delikate me të cilat përballet mjeshti mediatik. Ndër to, mund të përmenden takimet me rëndësi të veçantë, si më poshtë vijon:

1. ERGA: Grupi i Rregulatorëve Europianë për Shërbimet Mediatike Audiovizive (ERGA), është një strukturë koordinuese, e cila mbledh së bashku përfaqësues të nivelit të lartë të organeve kombëtare rregullatore të pavarura në fushën e shërbimeve audiovizive nga vendet anëtare dhe kandidate të BE - së. Për këtë arsy, AMA ka ndjekur në mënyrë periodike takimet e zhvilluara nga kjo platformë. Përgjatë vitit 2024, AMA ka ndjekur 6 takime të zhvilluara nga ERGA, ndër të cilat përmendim dy takimet Plenare vjetore, në të cilat fokusi kryesor kanë qënë çështje si mbrojtja e fëmijëve nga ekspozimi ndaj përbajtjeve të papërshtatshme audiovizive, gjuha e urrejtjes, politikat mbi Aktin Europian për Lirinë e Medias (EMFA), Direktiva Europiane për Shërbimet Mediatike Audiovizive (AVMSD), rregullimi i Platformave të Shpërndarjes së Video - ve (VSP), etj. Takime të tjera janë realizuar edhe në formën e Workshop - eve, me fokus në temat e lartpërmendura, prej të cilave janë përfshirur njohuri dhe praktika përfundimtare me të cilat hasen rregulatorët, përmes simulimeve të ndryshme.



2. EPRA: Platforma Europiane e Autoriteteve Rregullatore (EPRA) është rrjeti më i vjetër dhe më i madh i rregulatorëve të transmetimit dhe është një mjedis ideal për shkëmbimin e informacionit, rasteve dhe praktikave më të mira ndërmjet rregulatorëve të transmetimit në Europë. Përgjatë vitit 2024, AMA ka ndjekur 3 takime të zhvilluara nga EPRA, ndër të cilat përmendim 2 Asambletë Plenare, të mbajtura përkatësisht në Rotterdam dhe në Limasol, si dhe konferanca shumëpalëshe, ku janë trajtuar tematika të rëndësishme për realitetin mediatik audioviziv, ndër të cilat përfshihen mbrojtja e gazetarëve dhe aksesi në informacion i personave që u përkasin pakicave kombëtare.

Gjithashtu, një rëndësi të veçantë merr fakti se në vitin 2024, Kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive, znj. Armela Krasniqi, mori besimin e anëtarëve të EPRA - s duke u zgjedhur Zv. Kryetare me shumicë votash. Ky shënoi një çast shumë të rëndësishëm për AMA - n në veçanti, por edhe për vendin në përgjithësi pasi ky është një pozicion që AMA e siguronte për herë të parë në platforma të rëndësishme për fushën e mediave audiovizive, duke kujtuar këtu edhe zgjedhjen e Kryetares së AMA - s si Presidente e Rrjetit Mesdhetar të Autoriteteve Rregullatore, MNRA, në shtatorin e vitit 2023. Kjo tregon dhe shtimin e prezencës së AMA - s në arenën ndërkombëtare të rregulatorëve të fushës së medias audiovizive.

3. Observatori European Audioviziv: Observatori është një organizatë nën varësinë e Këshillit të Evropës, i cili ofron një pasqyrë krahasuese europiane të industrisë audiovizive në 40 vende anëtare të KiE - së, si dhe analiza të hollësishme të industrive kombëtare dhe rajonale audiovizive. Gjatë vitit 2024, përfaqësues të AMA - s kanë marrë pjesë në 3 takime të kësaj organizate, ku AMA bën pjesë edhe si anëtare e saj, me synimin e rritjes së kapaciteteve profesionale mbi aspektet rregullatore të realitetit mediatik audioviziv evropian.

4. WorldDAB: WorldDAB është një tjetër platformë që shërben si një forum global i industrisë për radion digitale DAB+, ku AMA prej vitit 2023 është pjesë e saj si anëtare. Përgjatë vitit 2024, AMA ka qënë e përfaqësuar në 4 takime të WorldDAB të organizuara në vende të ndryshme, fokusi i të cilave ka qënë shkëmbimi i përvojave dhe njojurive mbi mundësitet e zhvillimit të rrjeteve të DAB+, rolin e teknologjive të reja si dhe të teknikave të inteligjencës artificiale në zhvillimin e tyre, etj.

5. MNRA: Në vitin 2024 AMA ka ndjekur takimet e Rrjetit Mesdhetar të Autoriteteve Rregullatore, duke nisur me takimin e Grupit Teknik ku diskutohen dhe vendoset ndërmjet anëtarëve mbi aspektet përgatitore në lidhje me mbajtjen e Asamblesë Plenare të kësaj platforme. Kjo e fundit, Asambleja Plenare e 23 - të, u mbajt në Jerevan, Armeni, vendi autoriteti rregulator i të cilit mbante dhe pozitën e Zv. Presidentit të MNRA - së. Në këtë Asamble, AMA përfaqësohej nga Kryetarja znj. Armela Krasniqi, nën cilësinë edhe të Presidentes së Rrjetit. Autoritetet pjesëmarrëse përgjatë punimeve të Asamblesë shkëmbjen eksperiencat e tyre dhe studime të kryera në vendet e tyre për çështje të rëndësishme të fushës së mediave audiovizive siç janë edukimi mediatik, administrimi i platformave digitale në kuadër të nxitjes së lirisë së shprehjes, të drejtat e njeriut, raportet gjinore në Media, etj.

6. UNESCO: Në vitin 2024 AMA ka marrë pjesë në një nga aktivitetet më të rëndësishme të organizuara nga UNESCO, siç ishte pikërisht dhe Konferencia Globale e quajtuar ndryshe "Forumi Global i Rrjeteve". Gjatë zhvillimit të punimeve të këtij Forumi, janë diskutuar fenomene aktuale që kërcënojnë shoqëritë demokratike, që mund të nxisin konflikte, që pengojnë proceset e ndërtimit të paqes dhe minojnë të drejtën e njerëzve për të pasur akses në informacion të verifikuar, që është i nevojshëm për cilësinë e debatit publik kolektiv. Ndaj dhe fokusi i këtyre punimeve ishte pikërisht edhe menaxhimi dhe administrimi i platformave online, duke pasur parasysh dhe numrin e lartë të përdoruesve të tyre, me qëllim që këta të fundit të janë të mbrojtur nga përbajtjet e dëmshme, keqinformuese, të dhunshme, etj. Në cilësinë e mbajtjes së Presidencës së Rrjetit Mesdhetar të Enteve Rregullatore, MNRA dhe si Rregulator Audioviziv ne Republikën e Shqipërisë, AMA ka marrë pjesë në "Forumin Global të Rrjeteve", organizuar për herë të parë nga UNESCO, mbi Qeverisjen e Platformave Online. Me më shumë se 200 pjesëmarrës nga vende të

ndryshme të Botës, në këtë 1. konferencë të zhvilluar në Dubrovnik të Kroacisë, ishin të pranishëm drejtues të lartë të UNESCO - s, kreu i rregulatorëve të BE - së, Giacomo Lasorella, Zv/Presidenti i rregulatorëve të Europës, Stanislav Matejka, Presidentja e rregulatorëve të Afrikës, Latifa Akhabach, Zv/Presidenti i rregulatorëve frankofonë, Denis Rapone, Sekretarja Ekzekutive e rregulatorëve Iberikë, Mònica Duran Ruiz, Drejtora e rregulatorëve të Sigurisë Online, Camilla Bustani etj. Pas miratimit të Udhëzimeve të UNESCO - s, kjo konferencë u zhvillua me objektiv krijimin e Forumit Global të Rrjeteve, si një komunitet që ka për qëllim të bashkojë entet ndërkombëtare të mediave audiovizive elektronike dhe rregulatorëve në luftën kundër dezinformimit, gjuhës së urrejtjes dhe edukimit mediatik. Gjatë takimit, kryetarja Krasniqi u ka prezantuar të pranishmëve hapat e hedhur nga AMA drejt përmirësimit të kuadrit ligor dhe nënligor, në harmonizim të plotë me Direktivat dhe Rekomandime të BE - së, për të garantuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut, lirinë e shprehjes, luftën ndaj dezinformimit dhe gjuhës së urrejtjes.

7. Gjatë vitit 2024, AMA është përfaqësuar në nivele të larta edhe në aktivitete të tjera jashtë vendit, në platforma të tjera gjithashtu edhe në ato të organizuara nga homologët e AMA - s, të cilat trajtojnë zhvillimet e fundit teknologjike të transmetimit, sfidat e menaxhimit dhe administrimit të platformave digitale në kuadër të mbrojtjes së publikut nga përbajtjet e dëmshme, denigruese, të dhunshme, dezinformimit, etj. Secili prej këtyre aktivitetave kanë patur rëndësinë e tyre, duke pasur parasysh që në këto arena diskutimesh mes rregulatorësh diskutohen çështjet dhe sfidat më delikate me të cilat përballen ata, të cilat janë thuajse të njëjtë për të gjithë.

11.4 AMA në bashkëpunim me partnerët

Prej vitit 2015 Autoriteti vijon bashkëpunimin me institucione dhe organizata të cilat punojnë dhe kontribuojnë në fushën e medias, duke zhvilluar projekte për përmirësimin e infrastrukturës mediatike, promovimin e standardeve të larta etike në fushën e mediave me fokus aspekte të ndryshme të tregut audio dhe audioviziv, hulumtime, studime dhe analiza të fenomeneve dhe zhvillimeve të kohës, publikime në shqip të literaturës së huaj mbi median, etj. Drejtoria e Botimeve dhe Ndërveprimit drejton dhe ndjek nga afër të gjithë procesin përmeshtetje me fonde për projektpropozime në fushën e medias. Projektet e realizuara nga Autoriteti i Mediave Audiovizive në bashkëpunim me subjektet që kryejnë veprimitari në fushën e medias kanë si qëllim realizimin e studimeve dhe kërkimeve sasiore dhe cilësore, aktivitetave kualifikuese dhe trajnuese, fushatave informuese dhe sensibilizuese, botimeve dhe përkthimeve në fushën e medias.

Për vitin 2024, Autoriteti i Mediave Audiovizive ka përcaktuar 9 drejtime kryesore për projekte ku janë finalizuar 2 (dy) prej tyre dhe vazhdojnë të janë në zbatim për tu finalizuar sipas afateve respektive që kanë projektet e tjera. Gjatë vitit 2024 janë zhvilluar projektet e mëposhtme:

- **“Roli dhe ndikimi i medias audiovizive në efektivitetin e zbatimit të rregullave të qarkullimit rrugor dhe reduktimi i aksidenteve”**

Ky projekt mundësoi botimin e një udhëzuesi, i cili shërben për një bashkëpunim në rritje ndërmjet autoritetetëve përkatëse, organizatave të medias dhe grupeve të komunitetit për të krijuar një qasje të unifikuar për promovimin e pajtueshmërisë me rregullat e trafikut. Në manual u përfshinë rekomandime dhe konkluzione, pasi siguria e trafikut rrugor mbetet një shqetësim kritik në mbarë botën, me zgjidhje inovative të nevojshme për të adresuar numrin e saktë të aksidenteve rrugore. Ndaj dhe shpërndarja e tyre në radhët e komunitetit të gazetarëve dhe menaxherëve në median audiovizive ishte një mbështetje konkrete për ta, në përmirësimin e raportimit dhe zgjerimin e hapësirave në informimin e tyre mbi efektivitetin e rregullave të qarkullimit rrugor dhe reduktimin e aksidenteve. Ky projekt u finalizua në datën 01/11/2024.



- “Roli dhe ndikimi i medias audiovizive në luftën kundër dhunës në familje”

Ky projekt mundësoi hartimin e raportit monitorues si një analizë mbi edukimin, ndërgjegjësimin dhe përgjegjësinë sociale që u vjen në ndihmë gazetarëve për të përmirësuar trajtimin e rasteve të grave të dhunuara në media dhe etikën e raportimit të dhunës. Takimet e planifikuara u realizuan në Elbasan, Durrës, Kavajë, Përmet/Gjirokastër, Shkodër/Lezhë dhe për tu përbyllur në Tiranë, me diskutimin mbi gjeljet e monitorimit dhe rasteve të trajtuara në të. Media, si fuqia e katërt duhet të jetë e ndërgjegjshme mbi rolin e rëndësishëm mbi formësimin e perceptimeve publike dhe rëndësinë e saj, për të nxitur një qasje më të përgjegjshme ndaj barazisë gjinore. Raportimi i saktë kontribuon në ndryshimin e qasjes kolektive ndaj dhunës dhe inkurajon ndërveprimin e të gjithëve për të qënë pjesë e zgjidhjes. Takimet e realizuara me gazetarët kanë qënë konkrete duke diskutuar mbi mënyrën e raportimit të rasteve të dhunës në media dhe roli që kanë gazetarët në raportim. Ky studim ofroi një bazë të rëndësishme për organizatat joqeveritare dhe aktorët e tjerë të shoqërisë civile, që të ndërmarrin masa për përmirësimin e qasjes mediatike ndaj rasteve të dhunës dhe për të rritur ndërgjegjësimin publik për këtë çështje kritike. Ky studim ju vjen në ndihmë gazetarëve të cilët raportojnë mbi rolin dhe ndikimin e medias në luftën kundër dhunës në familje. Në manual u përfshinë rekomandime dhe konkluzione, pasi dhuna në familje mbetet një shqetësim dhe për të përmirësuar trajtimin e rasteve të grave të dhunuara në media dhe për të shmangur stigmatizimin e tyre u rekomandua: trajnimi i gazetarëve për etikën e raportimit të dhunës, fokusimi në shkaqet rrënjosore të dhunës, përfshirja e historive të mbijetesës dhe bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile. Ky projekt u finalizua në dhjetor të vitit 2024.

Projektet në proces finalizimi

- “Transmetimet Audiovizive dhe Inteligjenca Artificiale”

Ky projekt ka si qëllim dhe lindi si nevojë e zhvillimeve të fundit ku Inteligjenca Artificiale (AI), edhe pse përcaktohet si lëmi i shkencave kompjuterike, gjithmonë e më tepër e hasim në të gjitha sferat e jetës. Zhvillimi teknologjik i Inteligjencës Artificiale, veç të tjerash mundëson gjetjen dhe përmirëson shpërndarjen e informacionit. Duke patur parasysh vakumin në literaturë për informacione e koncepte mbi këtë çështje, me rëndësi paraqitet produkti i realizuar në fazën e parë të projektit: Vlerësuesi i gatishmërisë dhe monitorimi i përdorimit të AI në dhomën e lajmeve për mediat audiovizive në Shqipëri. Gjatë kërkimit ekspertët u konsultuan me punime dhe kërkime shkencore në fushën e përdorimit të AI në media në Shqipëri dhe në vende të tjera. U krijua një literaturë e dobishme për të gjithë ata që konsiderojnë të trajtojnë apo të avancojnë në çështjet e etikës që lidhen me përdorimin e AI në mediat audiovizive. Ky studim cilësor, i cili është në fazë përgatitje e zbatimi, do të shërbejë si referencë dhe si manual në funksion të gazetarëve, redaktorëve, menaxherëve të medias, studentëve, pedagogëve e studiuesve të fushës së shkencave të komunikimit.

- “Ndiskimi i mjeteve të komunikimit masiv (masmedia - ve) te të rinjtë e Gen Z”

Ky projekt kishte si qellim hartimin e një studimi, ku të përfshihet rapporti metodologjik i fokus grupeve, rezultatet e kërkimit cilësor të përpunuara nga specialistët dhe paraqitjen e përbledhur të skanimit të situatës. Gjithashtu, në këtë projekt, i cili është në proces zbatimi parashikohet realizimi i tryezave të punës me të rinjtë, në të paktën 6 qytete të vendit, ku do të parashtronë gjetjet e studimit. Ky projekt paraqitet me rëndësi e për ndikimin që do ketë studimi dhe botimi i tij për Gjeneratën Z, për vetë ndikimin që paraqet kjo gjeneratë në lidhje me mjetet të komunikimit masiv.

- “Evitimi i gjuhës së urrejtjes në median audiovizive”

Gjuha e urrejtjes është një sfidë e vazhdueshme me të cilën përballet shoqëria dhe në veçanti media.

Qëllimi i këtij projekti ishte vëzhgimi i mediave audiovizive për të kuptuar sa e pranishme është gjuha e urrejtjes, faktorët që ndikojnë në shfaqjen e saj dhe njohja me praktika të suksesshme në vendet e tjera që kanë ndikuar në evitimin e gjuhës së urrejtjes pas zhvillimeve të vrullshme teknologjike. U parashikua realizimi një studimi me të dhëna mbi vëzhgimin e mediave në vend, intervista me gazetarë dhe drejtues të redaksive dhe praktika të suksesshme në vende të tjera në evitimin gjuhës së urrejtjes dhe aktivitete e tryesa pune me gazetarë, redaktorë, kryeredaktorë të mediave audiovizive në të paktën 6 qytete të vendit.

- **“Ligjërimi Mediatik”**

Qëllimi i këtij projekti ka qënë mënyra se si media komunikon dhe formon opinionin publik përmes raportimit, interpretimit dhe prezantimit të informacionit. Ligjërimi mediatik ndikon në formimin e opinionit publik dhe të pëceptimit të realitetit. U parashikua realizimi i një studimi mbi ligjërimin mediatik në mediat audiovizive. Ky projekt është në proces zbatimi.

- **“Profesioni i gazetarisë në epokën e ndryshimeve teknologjike dhe mediave të reja”**

Ky projekt erdhi si nevojë e faktit që profesioni i gazetarisë është në fazë të vazhdueshme ridimensionimi, kjo për shkak se ndryshimet e shumta të teknologjisë kane ndikuar në stilin, formatin dhe në shpërndarjen e informacionit. Në këto kushte lindi nevoja e një vëzhgimi të mjedisit mediatik në Shqipëri. Si produkt i këtij projekti do të realizohet një studim i thelluar mbi realitetin mediatik në Shqipëri të profesionit të gazetarit, duke u fokusuar tek lloji i profesioneve që një shoqëri mediatike ka më shumë nevojë me zhvillimin e teknologjisë dhe lindjen e rrjeteve sociale. Gjithashtu, me vlerë paraqitet dhe organizimi i një konference shkencore që do të ketë në fokus gjetjet e studimit, po edhe krijimin e një hapësire të lirë të shkëmbimit të pikëpamjeve të ekspertëve të fushës, por edhe grupeve të interesit. Ky projekt është në proces zbatimi.

- **“Evitimi i fjalëve të huaja në vend”**

Përdorimi i fjalëve të huaja në mediat audiovizive në vend është bërë më i shpeshtë, duke sjellë shqetësim tek shikuesit dhe dëgjuesit. Qëllimi i këtij projekti ishte vëzhgimi i mediave audiovizive për përdorim të fjalëve të huaja dhe faktorët pse ka përdorim të tyre. Një nga produktet që do të realizohet është studimi analistik mbi përdorimin e fjalëve të huaja në mediat audiovizive dhe evidentimin e tyre.

- **“Roli dhe ndikimi i medias audiovizive në mbrojtje të shëndetit mendor”**

Duke qënë të ekspozuar ndaj fenomenit gjithmonë e në rritje të gjuhës së urrejtjes, seksizmit, kronikave të zeza, ekspozimi i fëmijëve ndaj përbajtjeve të dëmshme mediatike audiovizive, shpesh shihen si të pandjeshme ndaj interesit publik dhe ndikimit të kësaj përbajtje tek konsumatori. Qëllimi i këtij projekti ishte publikimi i një studimi, me qëllim njohjen e rolit dhe ndikimit të medias audiovizive në mbrojtje të shëndetit mendor në Shqipëri.

11.5 Marrëveshjet e bashkëpunimit

Përgjatë vitit 2024 Autoriteti i Mediave Audiovizive e ka rritur bashkëpunimin në kuadër të marrëveshjeve dypalëshe. AMA ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me autoritete homologe evropiane përgjatë vitit 2024, si më poshtë vijon:

1. Marrëveshja dypalëshe AMA - RTÜK: Më datat 6, 7 dhe 8 shkurt 2024, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), Tiranë, u zhvillua vizita zyrtare e delegacionit të Këshillit të Lartë të Radios dhe Televizonit Turk (RTÜK), i kryesuar prej z. Ebubekir Şahin, President i RTÜK. Përgjatë kësaj vizite, si qëllimi kryesor, u nënshkrua Memorandumi i Bashkëpunimit mes AMA – RTÜK, i cili bazohet në katër shtylla të rëndësishme:

- Edukimi mediatik
- Matja e shikueshmërisë



- Hulumtimi i opinionit publik
- Metodologja e monitorimit të përmbajtjes audiovizive.

Përveç Memorandumit të Bashkëpunimit, mes AMA - s dhe RTÜK u nënshkrua edhe një Protokoll shoqërues për Programin e Shkëmbimit të Ekspertëve, i cili do të ketë për qëllim informimin e ekspertëve të secilit prej dy autoriteteve mbi metodat e punës, drejtoritë, projektet, institucionet e palëve të interesuara të dy autoriteteve homologe, në aspektin e veprimeve rregullatore, të tilla si edukimi mediatik, matja e shikueshmërisë, kërkimi i opinionit publik dhe monitorimi.

2. Marrëveshja dypalëshe AMA - KRRiT: Më datat 10 dhe 11 shtator 2024, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), Tiranë, u zhvillua vizita zyrtare e delegacionit të Këshillit të Lartë të Radios dhe Televizionit Polak (KRRiT), i kryesuar prej Z.Maciej Swirski - President/Kryetar i KRRiT. Qëllimi kryesor i vizitës së autoritetit rregullator homolog polak ishte nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit AMA – KRRiT, i cili gjithashtu bazohet në katër shtylla të rëndësishme:

- Edukimi mediatik
- Matja e shikueshmërisë
- Hulumtimi i opinionit publik
- Metodologja e monitorimit të përmbajtjes audiovizive.

Përveç Memorandumit të Bashkëpunimit, mes AMA - s dhe KRRiT u konkludua dhe për vazhdimësinë e bashkëpunimit i cili do të ketë për qëllim informimin e ekspertëve të secilit prej dy autoriteteve mbi metodat e punës, drejtoritë, projektet, institucionet e palëve të interesuara të dy autoriteteve homologe, në aspektin e veprimeve rregullatore, të tilla si edukimi mediatik, matja e shikueshmërisë, kërkimi i opinionit publik dhe monitorimi.

3. Marrëveshja dypalëshe AMA - ERC: Përgjatë punimeve të Asamblesë Plenare të 22 - të të ERGA-s, të realizuar në nëntor të vitit 2024 në Romë, Itali, dy krerët e autoriteteve rregullatore kanë nënshkruar një Memorandum Bashkëpuni, i cili bazohet në tre shtylla kryesore:

- Edukimi mediatik
- Metodologja e monitorimit të përmbajtjes audiovizive
- Programe të shkëmbimit të Ekspertëve.

Palët janë angazhuar që, sa i takon monitorimit të përmbajtjes së transmetuar, të dy autoritetet do të shkëmbjnë informacionin mbi teknologjinë e softuerit të përdorur të përmbajtjes audiovizive, duke përfshirë platformat digitale, transmetimin online dhe teknologjite e tjera inovative; do të zhvillohen metoda të përbashkëta për monitorimin e përmbajtjes së transmetuar, duke përfshirë analiza të përmbajtjes, vlerësimë të pavarura të përmbajtjes dhe auditime periodike, për të siguruar përputhshmërinë me standarde të autoriteteve, si dhe do të shkëmbehen njohuri dhe përvoja lidhur me pajisjet e avancuara për monitorimin e përmbajtjes së transmetuar.

11.6 Propozime për Akte Nënligjore

Kryetarja e AMA - s ka kryer takime konsultuese e shkëmbim eksperiencash me përfaqësues të autoriteteve rregullatore nga disa vende anëtare të BE. Tematikat e diskutimit ishin praktikat e mira evropiane mbi transparencën në fushën e medias audiovizive dhe mundësitet e përafrimit me legjislacionin e brendshëm shqiptar, të cilat do të shërbejnë si shembull për hartimin e aktit përkatës nënligjor. Konkretnisht, bazuar në modelet e legjislacionit gjerman, portugez dhe të Maqedonisë së Veriut, në nëntor 2023, DILN ka hartuar një projekt - rregullore që trajton në mënyrë të posaçme transparencën në strukturën pronësore dhe deklarimin

e të dhënavë të tjera të lidhura me licencën/autorizimin prej OSHMA - ve. Projekt – rregullorja përmban një propozim konkret për transparencën e strukturës pronësore të medias, në përafrim me Aktin Evropian të Lirisë së Medias (EMFA) dhe në fillim të muajit dhjetor 2023 i është përcjellë për këshillim publik OSHMA- ve.

Projekt - rregullorja për ndryshimet në strukturën pronësore propozon risi mbi:

- Shqyrtimin nga AMA të ndryshimeve të ndodhura në strukturën pronësore brenda të njëjtë person juridik OSHMA, mbajtës i licencës ose i autorizimit nga AMA, të cilat nuk passjellin cedimin ose kalimin e të drejtave që burojnë nga licenca ose autorizimi;
- Shqyrtimin e ndryshimeve në strukturën pronësore mes personave juridikë privatë OSHMA, në rastet e hyrjes në marrëdhënie juridike civile të cilat passjellin cedimin ose kalimin e të drejtave që burojnë nga licenca ose autorizimi;
- Deklarimin e informacionit mbi përbërjen e strukturës së pronësisë së personit juridik OSHMA mbajtës i licencës ose i autorizimit nga AMA, duke përfshirë pronarin përfitues;
- Transparencë e shtuar mbi origjinën e burimeve të financimit për kryerjen e transaksioneve tregtare të kapitalit të shoqërisë mediatike prej ortakut/aksiomerit;
- Deklarim të çdo lloj konflikti të mundshëm interes i që ndikon në veprimtarinë e OSHMA - së prej pronarëve;
- Procedurës së vlerësimit të aplikimit dhe vendimmarjes prej AMA - s;
- Bashkëpunimin e rregulatorit me institucionë ose agjenci të tjera shtetërore të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me zbatimin e rregullores në praktikë, rast pas rasti, etj.

Për të plotësuar një nga kërkesat e BE - së, ajo e Transparencës së Pronësisë së Medias duke shtuar se përtetj rregullimit ligjor, AMA ka përgatitur regjistrin dhe ka paraqitur grafikisht në faqen e vet zyrtare online, deklaratën dhe transparencën e strukturës së pronësisë së shoqërive apo individëve të pajisur me licencë/ autorizim nga AMA, si edhe deklaratën e pronarëve përfitues të këtyre subjekteve, që ushtrojnë aktivitetet audio dhe audioviziv në Shqipëri. "Progres - Raporti i vitit 2023 i Bashkimit Evropian për Shqipërinë, e konsideron përqendrimin e tregut dhe mungesën e transparencës së financimit të medias si një çështje shqetësuese për lirinë e medias në vend. Pas procesit screening të Tetorit, edhe Udhërrëfyesi i Shtetit të së Drejtës 2024 - 2030, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave në Dhjetor 2023, i la detyrë AMA - s adresimin e çështjes së përqendrimit të tregut mediatik dhe realizimin e transparencës mbi pronësinë së medias. Në këtë linjë, me vendimin nr. 40, të Prillit të këtij viti, Autoriteti i Mediave Audiovizive miratoi rregulloren, "Për kërkesat dhe procedurat e rishikimit të ndryshimeve në strukturën e pronësisë dhe transparencën e të dhënavë të pronësisë së OSHMA - ve". Kjo rregullore që u hartua pas transpozimit të Direktivës 2018 në ligjin e institucionit, ka sjellë risi në shumë drejtime.

2. Në kuadër të zbatimit të detyrimeve periodike të përafrimit të legjislacionit të brendshëm me Acquis e BE - së në fushën e medias audiovizive, në vijim të detyrimeve të ndërmarrja nga Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në kuadër të hartimit të Planit Kombëtar për Integrimit Evropian (PKIE) 2024 – 2026, lindi nevoja që gjatë vitit 2024, AMA të shprehet me vendimarje mbi një akt nënligjor që trajton në mënyrë të posaçme rregullimin ligjor mbi platformat e shpërndarjes së videove. Përbushja e këtyre detyrimeve ka qenë kërkesë e vazhdueshme e Komisionit Evropian, e paraqitur gjatë takimeve bilaterale të procesit "screening" për secilin nga kapitujt e legjislacionit ku kërkohet përafrim, ashtu si dhe në takimet e tjera të mbajtura me përfaqësues të Komisionit Evropian për këtë qëllim. Drejtoria e Legjislacionit Ndërkombëtar dhe Integrimit përcjell propozim të projekt - rregullores për parimet e përgjithshme dhe kërkesat e posaçme që duhet të përbushin ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove për krijimin dhe operimin e sistemeve transparente, efektive dhe miqësore në përdorim. Miratimi i saj synonte gjithashtu të rregullojë kushtet e përgjithshme të ofrimit të përbajtjeve audiovizive nga përdoruesit në platformat për shpërndarjen e videove dhe nuk prek shërbimet mbështetëse të transmetimeve audiovizive, me qëllim kryesor ofrimin e programeve për informim, argëtim ose edukim.



Autoritetit të Mediave Audiovizive, në kuadër të procesit të përafrimit të legjislacionit me legjislacionin e BE në fushën e medias audiovizive (si për shembull transpozimin e Direktivës 2018/1808 të BE), por dhe rritjes të volumit të punës tërësore të marrë në shqyrtim, i lind nevoja e përmirësimit të kuadrit nënligor në fuqi që rregullon veprimtarinë e saj. Me hyrjen në fuqi të ndryshimeve të fundit të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, më 25 maj 2023, ndryshime këto të cilat përafruan plotësisht me Direktivën 2010/13/EU “Audiovisual Media Services Directive” (AVMSD), të amenduar me Direktivën 2018/1808 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, përcaktimet ligjore në fushën e transmetimeve audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre, si dhe për shërbimet e platformave të shpërndarjes së videove, domosdoshmérinë e rregullimit ligjor lidhur me kompetencat e autoritetit për rregullimin procedural në rastet e përbajtjes së ofruesve të shërbimit të shpërndarjes së videove të vendosur nën juridikcionin e Republikës së Shqipërisë dhe rregullimin e procedurës së administrimit për përbajtjet që i drejtohen publikut shqiptar të ofruara nga platformat e shpërndarjes së videove të themeluara në një shtet tjeter. Në përfundim, në zbatim të detyrimeve të ndërmarra në PKIE 2024 - 2026, si dhe me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit rregulator të AMA-s, propozojmë nxjerrjen e një rregulloreje të re për parimet e përgjithshme dhe kërkesat e posaçme që duhet të përbushin platformat e shpërndarjes së videove për krijimin dhe operimin e sistemeve transparente, efektive dhe miqësore në përdorim.

Projekt - rregullorja është hartuar në mbështetje të nenit 19, pika 1, gërma “e” dhe nenin 32.4/1 të Ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe është përafruar me Direktivën 2010/13/EU “Audiovisual Media Services Directive” (AVMSD), të amenduar me Direktivën 2018/1808 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian”. Organizimi i dispozitave të kësaj rregulloreje është bërë sipas përcaktimeve të Ligjit 97/2013, i ndryshuar dhe mirregullimit procedural për platformat e shpërndarjes së videove, si dhe rolin e AMA-s në procesin e administrimit të raportimit të përbajtjeve të dëmshme të shfaqura në platforma, gjithashtu dhe për të parandaluar aksesin e publikut në komunikimet me natyrë tregtare, të cilat cënojnë të drejtat e transmetimit.

Pas prezantimit paraprak të projekt - rregullores ”Mbi parimet e përgjithshme dhe kërkesat e posaçme për platformat e shpërndarjes së videove” në Bordin e AMA-s dhe diskutimit nen përen, si dhe në përbajtje dhe përkufizime, administrata publikoi në faqen zyrtare të Autoritetit në datën 30.09.2024, në Rubrikën - Këshillim Publik dhe projekt - rregulloren. Në vijimësi nuk ka patur komente dhe rekomandime përtej projektit të prezantuar në faqen web https://ama.gov.al/ova_doc/keshillim-publik/.

Në zbatim të Ligjit Nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” ku në nenin 15 janë përcaktuar dhe afatet për dorëzimin e komenteve dhe rekomandimeve në rastet e miratimit të akteve ligjore dhe nënligjore me rëndësi administrative, administrata e Autoritetit të Mediave Audiovizive ka paraqitur për miratim projekt - rregulloren ”Për kërkesat e posaçme që ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove duhet të përbushin për krijimin e ofrimin e sistemeve transparente, efektive e miqësore në përdorim” dhe në vijim, nga ana e Bordit të AMA-s u procedua me miratimin e këtij akti nënligor me vendimin Nr.128, datë 23.12.2024.

11.7 Publikimi i Buletinit Periodik të AMA - s

AMA vijon traditën e raportimit periodik për të siguruar transparencë dhe informim mbi sektorin audioviziv, përmes Buletinit Periodik. Ashtu si çdo vit, edhe në edicionin e 10 - të përvitin 2023, analizohen tendencat ekonomike, struktura e pronësisë, aspektet teknike të transmetimeve, karakteristikat e personelit të angazhuar dhe përbajtjet e transmetuara nga operatorët audiovizivë në Shqipëri.

Përmes një metodologje të mirëpërcaktuar dhe bazuar në të dhëna të vetëdekluara nga OSHMA - të, buletini ofron një panoramë të qartë të dinamikave të tregut, sfidave dhe mundësive që kanë shoqëruar sektorin gjatë vitit të kaluar.

Në të përfshihen të dhëna mbi performancën financiare të televizioneve, radiove, platformave kabllore, etj. Një tjetër aspekt kyç i trajtuar në këtë botim është struktura e pronësisë në tregun audioviziv, si dhe diversifikimin e investimeve në industri të ndryshme.

Një pjesë tepër e rëndësishme është dhe analiza e detajuar mbi personelin e sektorit audioviziv, duke analizuar nivelin arsimor, përvojën, balancën gjinore dhe trajtimin ekonomik të punonjësve. Ndarja gjinore në sektorin audioviziv vijon të jetë e dominuar nga meshkujt, por në fushën e gazetarisë është vënë re një rritje e ndjeshme e përfaqësimit të grave.

Në drejtim të aspekteve teknike, Buletini 10 paraqet ecurinë e procesit mbi Lirimin e Dijital Divident Dy (DD2) dhe rialokimin e brezit III VHF.

Edhe në këtë edicion publikohet lista e programeve “free” në 12 qarqet e vendit.

Procesi i digitalizimit përfshin dy aspekte kryesore: arkivimin digital të dokumenteve dhe përmirësimin e aksesueshmërisë në faqet e internetit për personat me aftësi të kufizuara.

Në kuadër të digitalizimit të arkivës, vazhdon implementimi i një sistemi të posaçëm për menaxhimin dhe ruajtjen e dokumenteve në format digital, duke lehtesuar shkëmbimin e informacionit ndërmjet institucionit, qytetarëve dhe administratës publike, si dhe duke garantuar mbrojtjen e të dhënave nga humbja apo dëmtimi aksidental.

Paralelisht, AMA ka ndërmarrë masa për të përmirësuar aksesueshmërinë në faqet e internetit, në përputhje me Planin Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara. Masat lidhen me përmirësimin e kuadrit ligjor duke përfshirë zhvillimin e standardeve të sigurimit dhe aksesueshmërisë në internet, duke siguruar një qasje të barabartë në shërbimet dhe informacionin online për personat me aftësi të kufizuar.

AMA, përmes Buletinit Periodik, ruan angazhimin për transparencë dhe informim të vazhdueshëm mbi sektorin audioviziv, duke pasqyruar qartë zhvillimet kryesore dhe sfidat të tregut audioviziv.

11.8 Menaxhimi i performancës së burimeve njerëzore

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore është pjesë e rëndësishme e funksionit të procesit të menaxhimit, përzgjedhjes, trajnimit, vleresimit të burimeve njerezore dhe është një mjet i rëndësishëm strategjik që ndihmon në krijimin e një përparësie të qëndrueshme konkuruese të stafit dhe i shton vlerën atij.

Zhvillimi organizativ i institucionit është mbështetur në komunikimin dhe bashkëpunimin e njësive organizative ndërmjet tyre, në aktivitetin e nëpunësit me performancë të lartë, duke çuar përpëra si performancën individuale, ashtu edhe atë organizative. Nga ana tjetër vlerësimi i performancës ka qënë një funksion kyç në menaxhimin e burimeve njerëzore, i cili duke u realizuar në mënyrë efikase e transparente ka bërë të mundur krijimin e një mqedisi më profesional pune dhe mbështetës për stafin.

Vlerësimi i performancës gjithashtu, ka qënë një proces i cili ka dhënë kontributin e tij në menaxhimin e efektshëm të nëpunësve dhe njësive organizative në tërësi.

Referuar rekrutimeve në vijimësi të ndryshimeve strukturore të ndodhura, sa i përket edhe punonjësve më të rinj të stafit të Autoritetit, si dhe objektivit të njësise së burimeve njerëzore për ruajtjen e një administratë kompakte, dinamike e profesionale në punën e përditshme e në vazhdimësi, menaxhimi i burimeve njerëzore ka përbërë një kërkësë të qenësishme, me qëllim rritjen e rezultateve të performancës në punë. Politikat e trajnimit të vazhdueshëm, si pjesë e strategjisë së burimeve njerëzore janë zhvilluar gjithashtu në dinamikë e në përshtatje të rrethanave hap pas hapi, duke i mundësuar Autoritetit përbushjen e detyrimeve ligjore.



Zhvillimi i burimeve njerëzore dhe organizative është mbështetur jo vetëm në anën dokumentare bazë të proceseve dhe përshkrimeve të pozicioneve të punës, në manualet e miratuarë të politikave të burimeve njerëzore, me përfshirjen e të gjithë legjisacionit të nevojshëm për nëpunësin civil dhe jo vetëm (punonjësit me kontratë pune), por dhe në trajnimet e vazhdueshme të punonjësve të rinj të rekrutuar.

Këto trajnime të vazhdueshme të mbështetura në kalendarin vjetor të miratuar të analizës dhe nevojave për trajnim, janë realizuar si nga Shkolla Shqiptare e Aministratës Publike (ASPA), në të gjitha format e prezantuar duke përfshirë dhe ato online, por dhe nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore rast pas rasti sidomos për punonjësit e rinj. Specifisht është ndjekur sikurse përmendëm më lart, rigorozisht kalendarin vjetor i nevojave për trajnim, mbështetur në një plan trajnimi të detajuar në bazë të kërkesave specifike të çdo njësie organizative.

Roli informues dhe koordinues i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Arkivë - Protokollit duke ndihmuar në përbushjen e objektivave dhe zhvillimin e aftësive personale dhe profesionale të punonjësve, ka mundësuar pjesëmarrjen e nëpunësve civil në trajnimet specifike, të përgjithshme dhe sipas nevojave, por dhe ato online me qëllim thellimin e njohurive dhe përmirësimin e performancës së çdo nëpunësi civil.

Bashkëpunimi i ngushtë me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, ka vijuar edhe përgjatë vitit reportues. Llojet e trajnimeve që këta nëpunës kanë ndjekur pranë SPA - s kanë qënë:

Trajnimi i thelluar, ku janë trajnuar 11 nëpunës të nivelit ekzekutiv. Nëpërmjet këtij trajnimi nëpunësit janë njohur me parimet themelore, mënyrën e organizimit të administratës, kuadrin ligjor, menaxhimin sa më të mirë të burimeve për arritjen e objektivave.

Formë tjetër trajnimi kanë qënë trajnimet për zhvillimin profesional, ku nëpunës të pozicioneve të ndryshme kanë marrë pjesë në module trajnimi të veçanta të cilat kanë trajtuar jo vetëm tema që lidhen me detyrat funksionale por dhe më gjerë, duke përmendur integrimin europian, teknologjinë, çështjet ligjore, anikorrupsionin, sigurinë kibernetike, etj.

Vlen të theksohet dhe pjesëmarrja e nëpunësve të AMA - s në workshop - e të ndryshme, me qëllim fitimin e përvojës, krijimit dhe shkëmbimit të njohurive.

Në total përgjatë vitit 2024, nëpunës civilë të kategorive të ndryshme kanë marrë pjesë në 25 trajnime për zhvillim profesional.

Gjatë vitit 2024 mbledhjet e anëtarëve të AMA - s kanë vijuar normalisht. Në total, gjatë këtij viti reportues janë zhvilluar 37 mbledhje.

Autoriteti i Mediave Audiovizive si institucion pjesë e programit të praktikave kombëtare të punës, edhe gjatë vitit 2024 është bërë pjesë e Thirrjes IX të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës. Mbështetur në vendimin nr. 395, datë 29.04.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës në Administratën Shtetërore dhe Institucionet e tjera Publike", i ndryshuar, pikës 12/a të metodologjisë dhe planit të veprimit të miratuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, AMA, përfshiu në aktivitetin e saj praktikën mësimore të dy studentëve të cilët përfunduan me sukses praktikën pranë strukturave organizative të Autoritetit, duke përfituar një përvojë kualifikuese për zhvillimin e mëtejshëm të aftësive profesionale, akademike dhe personale duke u certifikuar edhe nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Gjithashtu, në mbështetje të planifikimit të kryer nga AMA mbi mundësinë e punësimit me kontratë pune për praktikantin më të spikatur, bazuar në vlerësimin përkatës të mbikëqyrësit, u realizua punësimi i një praktikanti me kontratë të përkohshme pune (njëvjeçare).



12. TREGUESIT FINANCIARË DHE MENAXHIMI I BURIMEVE

12.1 Menaxhimi i burimeve financiare

Menaxhimi i burimeve financiare është një aspekt kyç i veprimtarisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), i cili funksionon si një institucion me vetëfinancim. Qëllimi kryesor i AMA - s është sigurimi i burimeve të mjaftueshme financiare për të realizuar detyrat dhe funksionet e tij në mënyrë efikase. Në këtë kontekst, përmirësimi i treguesve financiarë është një prioritet i rëndësishëm për AMA - n dhe është implementuar në kuadër të Strategjisë dhe Planit të Veprimit të tij për periudhën 3 - vjeçare 2024 - 2026.

Ligji nr. 97/2013, në nenin 24, specifikon burimet kryesore të financimit të AMA - s si vijon:

- Të ardhurat nga licencat dhe/ose autorizimet: Përfshijnë pagesat për marrjen dhe rinovimin e licencave dhe/ose autorizimeve. Ky burim financimi siguron një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave për AMA - n;
- Të ardhurat vjetore nga licencat dhe/ose autorizimet: Kjo përfshin pagesat vjetore të licencave dhe/ose autorizimeve të subjekteve të mediave, që kontribuojnë në mbajtjen e burimeve financiare të AMA – s dhe zë pjesën më të madhe të të ardhurave;
- Të ardhurat nga përpunimi administrativ i aplikimeve: Përfshin të ardhurat nga pagesat për përpunimin administrativ të kërkesave për aplikime për licenca dhe/ose autorizime të ndryshme;
- Tarifat për shërbimet e transmetimeve: Përfshin tarifat për shërbimet e transmetimeve të caktuara në ligjet fiskale, ku AMA ka rolin e agjentit tatimor, duke siguruar një burim shtesë të të ardhurave.

12.2 Realizimi i burimeve të financimit në vitin 2024

Ecuria e arkëtueshmërisë së burimeve të vetëfinancimit për “Të ardhurat korente të periudhës” dhe “Të ardhura nga debitorët e vitit të kaluar”, Tabela nr.2



NR.	EMËRTIMI	PARASHI KIMI I TË ARDHUR AVE PËR VITIN 2024	DETYSRIM EVE FINANCI ARE TË LINDURA OSHMA- VE TË LICENCU ARA/AUT ORIZUAR A NË VITIN 2024. FATURIM E GJATË VITIT 2024)	TOTALI I TË ARDHURA VE TË REALIZUA RA VITI 2024	REALIZIM I NË % (SIPAS PROJEKT BUXHETIT)	REALIZIMI NË % (SIPAS FAKTIT)
			1	2	3	$4=(3*100/1)$
A	Të ardhurat korrente të periudhës (1+2+3+4+5+6)	338,745	259,062	231,659	68	89
1	Të ardhura nga licenca/autorizi m + pagesat për rinovimet	227,012	218,917	170,181	75	78
	a) Realizimi i pagesave nga subjektet televizivë privat vendorë	27,285	18,261	12,536	46	69
	b) Realizimi i pagesave nga rrjetet numerike kombëtare tokësore, satelitore dhe lokale	56,592	56,592	27,673	49	49
	c) Realizimi i pagesave nga subjektet marrë autorizim nga AMA për OTT, IPTV, Internet TV	56,560	60,047	52,225	92	87
	d) Realizimi i pagesave nga subjektet radiofonikë privat vendorë analog	23,440	19,923	17,721	76	89

	e) Realizimi i pagesave nga subjektet marrë autorizim nga AMA (kabllorë)	63,135	64,094	60,026	95	94
2	Të ardhura si agjent tatimore	659	661	1,041	158	157
	- Nga subjektet e licencuar/autorizuar					
	- Nga subjektet hequr licenca/autorizimi					
3	Të ardhura nga përpunimi administrativ	1,780	4,394	4,395	247	100
4	Të ardhura nga interesat bankare	46	437	378	822	86
5	Të ardhura të tjera (lëshim DVD, fotokopje materialesh)	50	33	34		103
6	Të ardhura të tjera:	109,198	34,620	55,630	51	161
	-Nga kamatëvonesat	33,888	31,078	11,706	35	38
	-Nga gjobat	960	3,542		0	0
	-Nga debitorët e viteve të kaluara (licenca/autorizime +5% tarife RTV)	74,350		43,924	59	
	-Të ardhura nga debitorët hequr licenca/autorizimi					
B	Të ardhura nga paga të kthyera nga ish-punonjës të AMA - s					
	Totali i të ardhurave (A+B)	338,745	259,062	231,659	68	89



- Të ardhurat korrente të periudhës (planifikuar): Të ardhurat e parashikuara për periudhën janë në shumën prej 338,745 mijë lekëve, i cili është një parashikim bazuar në pritet e planifikimit financiar për të ardhurat potenciale në buxhetin e vitit 2024, ku u realizuan 259,062 mijë lekë ose 68% ndaj planit;
- Të ardhurat nga detyrimet vjetore 2024 (arkëtuar): Nga shuma totale, 259,062 mijë lekë që u janë faturuar subjekteve të medias, është arkëtuar një shumë prej 231,659 mijë lekë, me një përqindje prej rreth 89% të faturimeve gjithsej gjatë viteve të mëparshme.

Këto janë tregues të efikasitetit të procesit të mbledhjes së detyrimeve dhe është një shenjë pozitive për financat e Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Të ardhurat nga licencat/autorizimet dhe pagesat për rinovimet ishin parashikuar 227,012 mijë lekë. Ky parashikim është bërë bazuar në analizën e nevojave të mundshme të subjekteve që kërkojnë licenca ose autorizime nga institucioni.


Nga faturimet reale gjatë vitit, ka rezultuar faktikisht një shumë prej 218,917 mijë lekë. Kjo tregon një rënje të vogël krahasuar me parashikimin, si pasojë e pakësimit të subjekteve audiovizive.

U arkëtua një shumë prej 231,659 mijë lekë, nga e cila 170,181 mijë lekë janë nga faturimet e vitit, ndërsa 61,478 lekë janë detyrime nga viti i mëparshëm. Kjo shënon një përqindje arkëtimi prej rreth 68% të të ardhurave faktike nga këto burime krahasuar me planin.

Burimi kryesor i vetëfinancimit të AMA - s janë "Të ardhura nga detyrimet për pagesën vjetore për licencë/autorizim". AMA, gjatë vitit 2024, ka ndjekur arkëtueshmërinë e burimeve të saj të financimit, ku zëri "Të ardhura nga detyrimet për pagesën vjetore për licencë/autorizim", për periudhën 2018 - 2024 paraqitet si më poshtë vijon:Tabela nr.3

000 lekë

VITET	TË ARDHURA VJETORE TË PRITSHME	TË ARDHURA VJETORE TË REALIZUARA	REALIZIMI NË %
2018	190,052	177,352	93%
2019	188,192	183,229	95%
2020	201,973	190,573	94%
2021	216,717	202,107	94%
2022	217,756	181,936	84%
2023	225,321	208,624	92%
2024	229,550	231,659	101%



12.3 Detyrimet financiare të OSHMA - ve

Analiza e Detyrimeve Financiare për subjektet audiovizive me licencë/autorizim aktive (në fuqi) në 2024. Tabela nr.4

Tabela e të dhënave tregon detyrimet financiare të subjekteve sipas kategorive të ndryshme të medias audiovizive për vitet 2023 dhe 2024 (Televizione, Rrjete dhe kategorisë së detyrimeve (gjoba, kamata, taksa). Këto detyrime përfshijnë borxhet e mbetur nga viti 2023, detyrimet e reja të faturuara gjatë vitit 2024, borxhet e papaguara përgjatë vitit, si dhe ristrukturimet e mundshme që kanë ndodhur për të lehtësuar barrën financiare. Në fund të analizës, shihet një përqindje e rritjes ose uljes së detyrimeve për secilën kategori.

KATEGORIZIMI I SUBJEKTEVE	DETYSIME TË TRASHËGUARA LICENCË/AUTORIZIME TË FATURUA ME 2023	DETYSIM E PA LICENCË/AUTORIZIME TË FATURUA ME 2024	DETYSIM E TË PAPAGUARA/AUTORIZIME GJATË 2024	DETYSIRIMI I MBETUR NË FUND TË 2024	RISTRUKTURUAR 2024	DETYSIRMI I PAS RISTRUKTURIMIT NË FUND TË 2024	000 lekë	PËRQINDJA E RRITJES SË DETYRIMEVE NË FUND TË 2024
Televizione analoge	11,469	19,192	-1,422	10,047		10,047		-12
Rrjetet numerike kombëtare tokësore, satelitore dhe lokale	28,297	57,180	4,250	32,547	31,631	942		-97
Ofrues programi/ripërsëritës programi mbështetur në internet (IPTV/OTT)	12,131	60,906	1,615	13,746		13,746		13
Radio analoge	2,605	21,432	-252	2,353	0	2,353		-10
Ripërsëritës programi mbështetur në rrjet kabllor	7,145	66,519	-2,763	4,382		4,382		-39
Kamatvonesa	9,306	30,906	18,060	27,366	14,471	12,894		39
Gjoba	42,260	19,730	16,790	59,050		59,050		40
Taksa RTV	8,373	13,245	-7,593	780		780		-91
Shuma totale	121,586	289,110	28,685	150,271	46,102	104,194		-14



1. Televizione

- Në vitin 2023, këto televizione trashëguan një detyrim ndaj AMA – s prej 11,469 mijë lekë;
- Në vitin 2024, u faturuan 19,192 mijë lekë detyrime të reja;
- Gjatë vitit, ndodhi një reduktim i detyrimeve të papaguara me -1,422 mijë lekë, duke ulur totalin e mbetur në 10,047 mijë lekë në fund të vitit;
- Përqindja e ndryshimit tregon një ulje prej -12%, çka sugjeron se një pjesë e mirë e këtyre borxheve janë shlyer ose menaxhuar më mirë.

Kjo kategori po ecën drejt stabilizimit financiar. Me një ulje të detyrimeve në fund të vitit, mund të supozojmë se televizioni analog po përmirëson aftësinë e tij për të përballuar kostot operacionale dhe taksat.

2. Rrjetet numerike Kombëtare, Tokësore, Satelitore dhe Lokale

- Në 2023, detyrimi i trashëguar ndaj AMA – s ishte 28,297 mijë lekë;
- Në vitin 2024, u faturuan 57,180 mijë lekë detyrime të reja;
- Gjatë vitit, detyrimet e papaguara u rritën me 4,250 mijë lekë;
- Në fund të vitit, borxhi total arriti në 32,547 mijë lekë;
- Një ristrukturim i madh ndodhi në këtë sektor, duke reduktuar borxhin në 942 mijë lekë në fund të vitit;
- Përqindja e ndryshimit tregon një rënje drastike prej -97%.

Kjo është një nga kategoritë që ka përfituar më shumë nga ristrukturimi dhe shlyerja me këste e detyrimeve të prapambetura për një periudhë një vjeçare. Një reduktim i borxhit nëpërmjet këtij instrumenti nënkupton se janë zbatuar masa të forta financiare për vitin 2025 për disa subjekte të kësaj kategorie.

3. Ofruesit të Programeve IPTV/OTT

- Këto subjekte trashëguan një borxh ndaj AMA - s prej 12,131 mijë lekë nga 2023;
- Në vitin 2024, u faturuan 60,906 mijë lekë detyrime të reja, një rritje e madhe;
- Detyrimet e papaguara arritën në 1,615 mijë lekë gjatë vitit;
- Borxhi final në fund të vitit u rrit në 13,746 mijë lekë, duke reflektouar një rritje prej 13%.

Rritja e detyrimeve për këtë sektor tregon një zgjerim të shërbimeve IPTV dhe OTT, por gjithashtu tregon se këto subjekte kanë pasur vështirësi financiare në mbulimin e detyrimeve të tyre. Ndërsa teknologjia e streaming IPTV është në rritje, kostot e operimit dhe taksat janë një barrë e konsiderueshme për ofruesit.

4. Radio Analogë

- Në vitin 2023, borxhi i tyre ndaj AMA - s ishte 2,605 mijë lekë;
- Në vitin 2024, u faturuan 21,432 mijë lekë detyrime të reja;
- Një pjesë e detyrimeve u shlyen gjatë vitit (-252 mijë lekë);
- Në fund të vitit, borxhi ishte 2,353 mijë lekë, me një ulje prej -10%.

Edhe pse kjo kategori ka pasur një sasi të konsiderueshme detyrimesh të reja, një menaxhim më i mirë i financave ka sjellë një ulje të detyrimeve të mbetur. Kjo tregon një përmirësim të stabilitetit financiar për radiot analoge.

1. Kamatvonesa për të gjitha kategoritë:

- Borxhi i trashëguar ndaj AMA – s në vitin 2023 ishte 9,306 mijë lekë;
- Në vitin 2024, u faturuan 30,906 mijë lekë;
- Detyrimet e papaguara u rritën me 18,060 mijë lekë, duke e çuar totalin e mbetur në 27,366 mijë lekë;
- Një pjesë e këtij borxhi u ristrukturua (14,471 mijë lekë), duke lënë një borxh përfundimtar prej 12,894 mijë lekë;
- Përqindja e rritjes është +39%.

Ky zë ka pësuar një rritje të ndjeshme të borxheve, si pasojë e vonesave në pagesave dhe mosllogaritjes nga administrata e financës së mëparshme të kamatvonesave të vitit 2023, të cilat u llogariten në vitin 2024. Rritja e madhe sugeron për një vemendje dhe masa më të rrepta të mbledhjes së detyrimeve në të ardhmen.

1. Gjoba

- Në vitin 2023, ishin 42,260 mijë lekë gjoba të papaguara ndaj AMA - s;
- Në vitin 2024, u faturuan 19,730 mijë lekë gjoba të reja;
- Detyrimet e papaguara u shtuan me 16,790 mijë lekë, duke sjellë një total të ri prej 59,050 mijë lekë;
- Përqindja e rritjes është +40%.

Kjo rritje tregon një shtim të gjobave dhe një rënje të pagesave të tyre.

7. Taksa RTV

- Detyrimet e trashëguara ndaj AMA – s në vitin 2023 ishin 8,373 mijë lekë;
- Në vitin 2024, u faturuan 13,245 mijë lekë detyrime të reja;
- Gjatë vitit, pati një zbritje të madhe prej -7,593 mijë lekë, duke e çuar borxhin në vetëm 780 mijë lekë;
- Përqindja e rënies është -91%.

Ky është një nga sektorët me përmirësimin më të madh dhe është rezultat i ristrukturimeve dhe pagesave të detyrimeve te prapambetura nga rrjetet televizive, si dhe përparësia e arkëtimit të detyrimeve për buxhetin e shtetit në fillim, nga subjektet e ristrukturuara siç ishin rrjetet televizive.

Përfundimisht, vitin 2024 e karakterizoi një ndryshim i ndjeshëm në peizazhin finansiar të subjekteve të mediave audiovizive që operojnë nën juridikcionin e AMA - s. Ndërsa disa segmente, për gjobat dhe kamatvonesat, përballuan rritje të konsiderueshme të detyrimeve, të tjera, si detyrimet e rrjeteve numerike për tarifën vjetore dhe taksa RTV, shënuan përmirësimë të rëndësishme përmes ristrukturimeve dhe pagesave që çuan në uljen e detyrimeve. Këto tendenca pasqyrojnë jo vetëm sfidat specifike të secilit segment, por gjithashtu tregojnë për dinamikat e ndryshme që formësojnë industrinë audiovizive në një mjedis të ndryshueshëm ekonomik dhe rregullator. Adresimi i këtyre sfidave do të kërkojë një qasje të matur dhe të qëndrueshme, duke balancuar mbështetjen për sektorët në vështirësi me masa efektive për mbledhjen e detyrimeve, me qëllim sigurimin e stabilitetit finansiar të AMA - s dhe rritjes së qëndrueshme të industrisë audiovizive.

Në përgjithësi, të dhënat tregojnë një përpjekje për të stabilizuar detyrimet e sektorëve mediatikë dhe të komunikimit, me disa kategori që kanë përshtuar nga ristrukturimi, ndërsa të tjera përballen me rritje të borxheve ndaj AMA - s. Kjo tregon nevojën për masa më të rrepta të menaxhimit finansiar për disa sektore dhe rritjen e pagesave në kohë për të shhangur përshkallëzimin e borxheve.

12.4 Përdorimi i burimeve financiare në vitin 2024

Gjatë vitit raportues, AMA ka menaxhuar burimet financiare bazuar në projekt - buxhetin për vitin 2024, si dhe në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike.

12.4.1 Shpenzimet dhe investimet në vitin 2024

Analiza e Shpenzimeve dhe Investimeve për Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA) për vitin 2024.
Tabela nr.5:



000 lekë

Nr.	Shpenzime/Investime	Plani	Shtesa/pakësi me gjatë vitit 2024	Fakti	% e realizimit
		1	2	3	3/(1+2)*100
I	Shpenzime korente (a+b)	241,126	0	198,439	82
	a) Paga, kontribute për sig. shoq. dhe shend., shpërblime	149,584	0	135,868	91
	b) Shpenzime për mallra dhe shërbime	91,542	0	62,571	68
II	Shpenzime për investime (a+b+c)	169,550	0	90,156	53
	a) Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	15,200	0	7,366	48
	- Studime dhe kërkime (2024)	12,000	0	7,366	61
	- Studime, kërkime, anketime (të filluara në vitin 2023, për tupa përfunduar në vitin 2024)	0	0	0	
	-Programe/aplikacione	3,200	0	0	0
	b) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	152,350	0	81,800	54
	- Instalime, mjete dhe paisje të tjera, teknike	70,595	0	838	1
	Instalime dhe sisteme të filluara në vitin 2024	81,025	0	80,553	99
	- Mobilje dhe paisje të tjera zyre	730	0	367	50
	Paisje kompjuterike elektronike	0	0	0	0
	Paisje të tjera mbështetëse teknike	0	0	0	0
	Paisje të tjera të filluara në vitin 2024	0	0	0	0
	Mobilje zyre	0	0	0	0
	- Mjete transporti	0	0	42	
	c) Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme	2,000	0	990	50

Kjo analizë ofron një pasqyrë të detajuar të shpenzimeve dhe investimeve të Autoritetit të Mediave Audiovizive për vitin 2024, krahasuar me planifikimin fillestar. Të dhënrat e paraqitura në tabelë tregojnë realizimin e shpenzimeve dhe investimeve sipas kategorive përkatëse, duke reflektuar performancën financiare të institucionit.

1. Shpenzime Korrente:

Shpenzimet korrente të planifikuara për vitin 2024 ishin 241,126 mijë lekë, ndërsa shpenzimet faktike arritën në 198,439 mijë lekë, duke rezultuar në një realizim prej 82%.

Paga, kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, shpërblime: U planifikuan 149,584 mijë lekë, ndërsa u realizuan 135,868 mijë lekë, me një normë realizimi prej 91%. Kjo tregon një përdorim efikas të fondeve për pagat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Shpenzime për mallra dhe shërbime: Nga 91,542 mijë lekë të planifikuara, u shpenzuan 62,571 mijë lekë, duke shënuar një realizim prej 68%.

Është kryer një rishpërndarje fondesh brenda për brenda shpenzimeve operative, duke shtuar zërin shpenzimet për kompésime ligjore dhe shpenzime transporti, duke pakësuar zërin shpenzimet për të tretë, për një vlerë prej 3,084 mijë lekë.

2. Shpenzimet për Investime

Shpenzimet për investime për vitin 2024 ishin planifikuar në vlerën 169,550 mijë lekë, ndërsa shpenzimet faktike ishin 90,156 mijë lekë, me një realizim të përgjithshëm prej 53%.

12.4.2 Aktive të Qëndrueshme të Patrupëzuara

Studime dhe kërkime (2024): U planifikuan 12,000 mijë lekë, ndërsa u realizuan 7,366 mijë lekë, me një nivel realizimi prej 61%.

12.4.3 Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara

U planifikuan 152,350 mijë lekë, ndërsa u realizuan 81,800 mijë lekë, me një nivel realizimi prej 54%.

Instalime dhe sisteme të filluara në vitin 2023: Nga 81,025 mijë lekë të planifikuara, u realizuan 80,553 mijë lekë, me një nivel realizimi të lartë prej 99%.

Instalime, mjete dhe paisje të tjera, teknike: nga 70,595 mijë lekë, u realizuan 838 mijë lekë ose 1%.

Mobilje dhe pajisje të tjera zyre: Kjo kategori nga 730 mijë lekë të planifikuara, u shpenzuan 367 mijë lekë, duke rezultuar në një realizim prej 50%.

Mjete transporti: U shpenzuan 42 mijë lekë për blerjen e baterive për automjetet e AMA - s.

12.4.4 Shpenzime për Rritjen e Aktiveve të Qëndrueshme

Për këtë kategori ishin planifikuar 2,000 mijë lekë, ndërsa shpenzimet faktike ishin 990 mijë lekë, me një realizim prej 50%.

Përfundime:

Nga analiza e mësipërme, vërehen disa tendenca të rëndësishme:

- Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore kanë një nivel të lartë realizimi, duke treguar një administrim të mirë të burimeve njerëzore;
- Shpenzimet për mallra dhe shërbime kanë një realizim më të ulët, që mund të reflektojë kursime ose planifikime më shumë se nevojat;
- Investimet në programe dhe aplikacione janë të pa realizuara, që reflekton investimin per krijimin e një studio monitorimi dhe matje të shikueshmërisë së mediave audiovizive;
- Investimet në instalime digjitalizimi nga viti i kaluar, kontrata të filluara në 2023 janë realizuar me sukses, duke treguar një menaxhim të mirë të projekteve në proces.

12.5 Pasqyrat financiare

Në fund të vitit 2024, Autoriteti i Mediave Audiovizive realizoi një fitim prej 58,338,505 lekë, me një rënie në krahasim me vitin 2023, kur fitimi ishte 75,434,143 lekë. Kjo ka ardhur si rezultat i rritjes së kostove operative të AMA - s, si efekti i rritjes së pagave dhe shpenzimeve operative etj.

Gjendja e likuiditetit gjithashtu ka pësuar rënie, duke zbritur nga 284,677,819 lekë në fillim të vitit 2024 në 225,022,153 lekë në fund të vitit 2024. Ky ndryshim tregon një përdorim të rezervave monetare, që është pasojë e realizimit të investimeve, rritjes së shpenzimeve etj.



Pasqyra e aktiveve dhe pasiveve për vitet 2023 - 2024

Referenca e llogarive	Emërtimi	Viti 2024	Viti 2023
A	AKTIVET	985,753,178	959,563,056
	I. Aktivet afatshkurtra	785,524,033	816,819,159
	1. Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre	225,022,153	284,677,819
531	Mjete monetare në arkë	67	188,743
512, 56	Mjete monetare në bankë	225,021,549	284,488,539
520	Disponibilitete në thesar	537	537
50	Letra me vlerë		
532	Vlera të tjera		
54	Akreditiva dhe paradhënie		
59	Provigionje zhvlerësimi letra me vlerë (-)		
	2. Gjendje inventari qarkullues	4,402,983	4,393,666
31	Materiale	4,402,983	4,393,666
32	Inventar i imët		
33	Prodhim në proces		
34	Produkte		
35	Mallra		
36	Kafshë në rritje e majmëri		
37	Gjendje të pambërritura, ose pranë të tretëve		
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit		
39	Provigionje për zhvlerësimin e inventarit (-)		
	3. Llogari të arkëtueshme	553,425,883	525,074,661
411	Klientë e llogari të ngjashme	451,256,646	422,330,002
423.429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba	97,200	200,000
431	Tatim e taksa		
432	Tatime, të mbledhura për llogari të pushtetit lokal		
433	Fatkeqësi natyrore që mbulohen nga shteti		
435	Sigurime shoqërore		

436	Sigurime shëndetësore		
437,438,	Organizma të tjera shtetërore	6,283	6,283
44	Institucione të tjera publike		
465	Efekte për tu arkëtuar nga shitja e letrave me vlerë		
468	Debitorë të ndryshëm	102,065,754	102,538,376
4342	Operacione me shtetin (të drejta)		
45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njësive ekonomike		
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)		
4. Të tjera aktive afatshkurtra		2,673,013	2,673,013
409	Parapagime	2,673,013	2,673,013
473	Llogari e prites të marrëdhënieve me thesarin		
477	Diferenca konvertimi aktive		
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime		
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme		
II. Aktivet Afatgjata		200,229,145	142,743,897
20	1. Aktive Afatgjata jo materiale	38,632,014	37,685,874
201	Prime të emisionit dhe rimbursimit të huave		
202	Studime dhe kërkime	38,632,014	37,685,874
203	Koncesione, patenta, licenca e të ngjashme		
21	2. Aktive afatgjata materiale	161,597,131	105,058,023
210	Toka, troje, terrene		
211	Pyje, plantacione		
212	Ndërtesa e konstruksione	71,578,291	74,523,306
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore		
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	78,965,636	18,312,226
215	Mjete transporti	8,776,450	9,246,263
216	Rezerva shtetërore		
217	Kafshë pune e prodhimi		
218	Inventar ekonomik	2,276,755	2,976,229
24	Aktive afatgjata të dëmtuara		



28	Caktime të aktiveve afatgjata		
25-26	3. Aktive Afatgjata Financiare	0	0
25	Huadhënie e nënhuadhënie		
26	Pjesëmarrje në kapitalin e vet		
	4. Investime	0	0
230	Për aktive afatgjata jo materiale		
231	Për aktive afatgjata materiale		
B	PASIVET (DETYSRIMET)	396,137,749	391,719,968
	I. Pasivet afatshkurtra	396,137,749	391,719,968
	1. Llogari të pagueshme	396,137,749	391,719,968
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	204,312	312,161
42	Detyrime ndaj personelit	0	0
16,17,18	Hua afatshkurtra		
460	Huadhënës		
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	2,155,697	1,551,062
432	Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal		
433	Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore		
435	Sigurime shoqërore	585,323	875,051
436	Sigurime shëndetësore	170,637	131,492
437,438,	Organizma të tjerë shtetërore		
44	Institucionë të tjera publike		
45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njësive ekonomike		
464	Detyrime për t'u paguar për blerje letra me vlerë		
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	51,765,588	51,765,588
467	Kreditorë të ndryshëm	0	334,558
4341	Operacione me shtetin (detyrime)	341,256,192	336,750,057
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)		
	1. Të tjera pasive afatshkurtra	0	0
419	Kreditore, parapagime		
475	Të ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse		
478	Diferenca konvertimi pasive		



480	Të ardhura për t'u klasifikuar ose rregulluar		
487	Të ardhura të arkëtuara para nxjerrjes së titullit		
	II. Pasivet afatgjata	0	0
Klase 4	Llogari të pagueshme		
16.17,18	Huatë afatgjata		
	Provigionet afatgjata		
Klasa 4	Të tjera		
C	AKTIVET NETO/FONDET (A-B)	589,615,429	567,843,088
D	FONDI I KONSOLIDUAR:	589,615,429	567,843,088
101	Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	426,276,923	387,408,945
12	Rezultatet e mbartura		
85	Rezultati i veprimitarisë ushtrimore	58,338,505	75,434,143
111	Rezerva		
115	Nga fondet e veta të investimeve		
15	Shuma të parashikuara përrreziqe e zhvlerësimë		
105	Teprica e granteve kapitale të brendshme	105,000,000	105,000,000
106	Teprica e granteve kapitale të huaja		
107	Vlera e mjeteve të caktuara në përdorim		
109	Rezerva nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata		
	Të tjera		
E	TOTALI I PASIVEVE (B+C)	985,753,178	959,563,056

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitet 2023 - 2024

Nr. llogarie	Përshkrimi i operacioneve	Viti 2024	Viti 2023
A	TË ARDHURAT		
70	I. TË ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET	259,062,188	230,577,695
700	1.Tatimi mbi të ardhurat	31,739,128	1,397,390
7000	Tatim mbi të ardhurat personale	0	0
7001	Tatim mbi fitimin		
7002	Tatim mbi biznesin e vogël		
7009	Të tjera tatime mbi të ardhurat		
702	2.Tatimi mbi pasurinë	0	0
7020	Tatim mbi pasurinë e paluajtshme		

7021	Tatim mbi shitjen e pasurisë të paluajtshme		
7029	Të tjera tatime mbi pasurinë		
703	3.Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit	660,598	650,130
7030	Tatim mbi vlerën e shtuar (TVSH)		
7031	Akciza		
7032	Taksë mbi shërbimet specifike		
7033	Taksë mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie	660,598	650,130
7035	Taksë vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie		
704	4.Taksë mbi tregtinë dhe transaksionet ndërkombëtare	0	0
7040	Taksë doganore për mallrat e importit		
7041	Taksë doganore për mallrat e eksportit		
7042	Tarifë shërbimi doganor e kolipostë		
7049	Të tjera taksa mbi tregtinë e transaksionet ndërkombëtare		
705	5.Taksë e rrugës		
708	6.Të tjera tatime e taksa kombëtare		
709	7.Gjoba e kamatëvonesa	31,078,530	747,260
75	II. Kontribute sigurime shoqërore e shëndetësore	0	0
750	Nga të punësuarit		
751	Nga punëdhënësi		
752	Nga të vetëpunësuarit		
753	Nga fermerët		
754	Nga sigurimet vullnetare		
755	Kontribute nga buxheti për sigurime shoqërore		
756	Kontribute nga buxheti për sigurime shëndetësore		
71	III.TË ARDHURA JO TATIMORE	226,885,204	229,115,677
710	1. Nga ndërmarrjet dhe pronësia	0	0
7100	Nga ndërmarrjet publike jo financiare		
7101	Nga ndërmarrjet publike financiare		
7109	Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia		
711	2.Shërbimet administrative dhe të ardhura sekondare	226,885,204	229,115,677
